



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me asamblетë e fakulteteve të Universitetit të Tiranës për situatën e krijuar në universitete gjatë dhe pas protestës studentore; menaxhimi i situatës rast pas rasti; qëndrimet e pedagogëve ndaj VKM-ve; çështje të funksionimit të universiteteve; situata pas implementimit të ligjit të arsimit të lartë dhe pozita financiare e pedagogut.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Mirela Kombaro, Luçiano Boçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Floida Kërpaçi (zëvendësuese).

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Luan Baçi dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Dhori Kule- kryetar i Asamblesë së Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës,

Shyqyri Llaci- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës,

Sulo Hadëri- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës,

Artur Sula - kryetar i Asamblesë së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës,

Alban Foçi- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës,

Spiro Drushku - dekan i universitetit, Asambleja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës,

Artur Baxhaku- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës,

Eglantina Kalluci- përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës,

Agron Gjekmarkaj- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës,

Erka Çaro- përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës,

Jonila Godole- përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës,

Andi Pinari- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës,

Artan Hoxha- përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës,

Kestrin Katro - përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës,

Zhaklina Peto - përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës,

Edmond Rapti – përfaqësues i Asamblesë së Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës,

Marinela Sota - përfaqësuese e Asamblesë së Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Vazhdojmë serinë e dëgjësave në lidhje me situatën e arsimit të lartë. Sot janë të ftuar në seancë dëgjimore përfaqësues të asambleve të fakulteteve për situatën e krijuar në universitete pas protestës studentore, menaxhimin e situatës rast pas rasti, qëndrimet e pedagogëve ndaj VKM-ve, sidomos atyre të fundit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Në këtë seancë dëgjimore duam të trajtojmë edhe çështjet e funksionimit të universiteteve, situatën pas implementimit të ligjit të arsimit të lartë, pozitën financiare të pedagogëve, si dhe çështje të tjera. Këto janë disa nga shqetësimet, të cilat i kemi trajtuar edhe në dëgjësat e tjera. Na kanë ardhur shkresa nga fakultete të ndryshme. Përfaqësues nga Fakulteti i Histori-Filologjisë kemi Agron Gjekëmarkaj, Erka Caro, Jonila Godole dhe zotin Andi Pinari; nga Fakulteti i Shkencave Sociale kemi profesor Edmond Raptin dhe profesoren e asociuar Marinela Sota; nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja profesor doktor Artur Sula dhe doktor Alban Toçi; nga Fakulteti i Ekonomisë profesor doktor Dhori Kule, kryetar i Asamblesë, profesor doktor Shyqyri Llaci, profesor doktor Sulo Hadëri; nga Fakulteti i Drejtësisë, profesor doktor Artan Hoxha, kryetar i Asamblesë, profesor doktor Kestrin Kastro dhe profesor doktor Zhaklina Peto. Besoj se të gjithë të ftuarit janë prezentë, kështu që mund të nisim dëgjuesën.

Kemi menduar që, së pari, të dëgjojmë një përfaqësues nga çdo fakultet dhe, nëse ka diçka për të shtuar, mund t'ua japim fjalën edhe të ftuarve të tjerë, por do ta fillojmë me përfaqësuesit e fakulteteve.

Nga Asambleja e Fakultetit të Ekonomisë, zoti Dhori Kule, kryetar i Asamblesë.

Dhori Kule – Ju falënderoj!

Të nderuar deputetë të komisionit, pedagogë, përfaqësues të medieve, dua t'ju falënderoj që problemet e arsimit të lartë janë bërë pjesë e interesimit të Kuvendit të Shqipërisë.

Duke qenë se personalisht dhe ndërinstucionalisht me Universitetin e Tiranës jam i lidhur që nga viti 1977, si student, dhe sot pas 42 vjetësh në këtë universitet pa u shkëputur asnjëherë si pedagog, shef departamenti, dekan, rektor e të tjera me radhë, së pari, dua të sjell në vëmendjen tuaj dhe të publikut faktin që tashmë është harruar dhe nuk po flitet se cili është Universiteti i Tiranës.

Të nderuar kolegë, dua t'ju them se Universiteti i Tiranës është nderi i kombit dhe më i miri në Shqipëri. Në një rankim ndërkombëtar të bërë nga një agjenci serioze ndërkombëtare,

Universiteti i Tiranës është i pari në 35 universitetet shqiptare, me diferencë të madhe me vendin e dytë dhe të tretë. Universiteti i dytë është 800 vende pas nesh. Domethënë, në 29000 universitete, ku është bërë rankimi, ne jemi në vendin e 4300, por nga universitetet publike dhe jopublike shqiptare ne jemi të parët me diferencë të madhe nga i dyti dhe i treti, të cilët kanë qenë pjesë jona.

Universiteti i Tiranës është copëtuar dy herë. Ndarja e parë ishte në vitin 1991, kur u nda nga Politekniku, u hoq emri i Enver Hoxhës, dhe pas 5-6 vjetësh menduam të bashkohen dhe t'i hiqej ai emër e t'i vihej Isamil Qemali, që të mos ndryshonte si universitet, dhe ndarja e dytë është bërë në vitin 2018, kur u shkëput në mënyrë të paligjshme Fakulteti i Mjekësisë dhe i Infermierisë dhe u krijua Universiteti i Mjekësisë. Kjo ndarje është bërë në mënyrë të paligjshme, sepse senati i Universitetit të Tiranës, në atë kohë, nuk ka konfirmuar ndarjen e Universitetit të Mjekësisë. Po të ishin sot bashkë këto universitete, do të ecnim më përpara. Po të shohim universitetet e rajonit, do të shohim se ata nuk janë cenuar në strukturë dhe janë të gjithë bashkë. Kjo ishte një goditje për ne, por përsëri jemi të parët.

Të nderuar deputetë, ju e dini shumë mirë që ky universitet ka ndihmuar Universitetin e Prishtinës në vitet '70. Profesorët e Universitetit të Tiranës, duke filluar nga profesor Çabej dhe të gjithë profesorët e tjerë të Universitetit të Tiranës, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për konsolidimin e Universitetit të Prishtinës, po kështu edhe për Universitetin e Tetovës, i cili konsolidimin e tanishëm e ka falë kontributeve të profesoratit të Universitetit të Tiranës.

Unë dua t'u përcjell falënderime të gjithë atyre që kanë punuar atëherë, punojnë sot dhe që bashkëpunojnë me universitetet shqipfolëse. Në vitin 2008 kemi krijuar një rrjet të universiteteve shqipfolëse dhe bashkëpunojmë me njëri-tjetrin.

E përmenda çështjen e ndarjes, sepse Shqipëria kërkon të bëhet pjesë e BE-së dhe integrimi, si pjesë e globalizimit, është trendi botëror. Vetëm te ne ka ndodhur e kundërta, kur të gjithë bashkohen, Universiteti i Tiranës është i ndarë. Ky është një mesazh, që kam bindjen se do të jetë edhe në vëmendjen e komisionit, që më pas të bëhet edhe një reformë strukturore.

Në sistemin bankar ne bëjmë teste të caktuara për të parë se sa mbajnë institucionet dhe unë, si drejtues i vjetër, këtë e kam parë edhe nga ky këndvështrim, që është një situatë e bukur nga pikëpamja e drejtimit për të parë nëse institucionet e arsimit të lartë e përballojnë këtë ngarkesë, e cila ishte një ngarkesë e gjithëformëshme, ku u shfaqën të gjitha situatat e bukura dhe më e bukura ishte protesta e studentëve. Brenda protestës së studentëve kam parë me bukuri të madhe shumë lëvizje të brendshme, interesa të vogla, interesa të jashtme, nga ata të jashtmit që nuk ishin bërë dot pedagogë dhe shanin universitetin, por nuk kam folur këto

ditë, sepse ka pasur të tjerë para nesh dhe ne, më kryesorët, më vjen mirë, flasim për herë të parë këtu.

Këtu ka historianë dhe dua të sjell një element të historisë, që na vjen në ndihmë për të folur për atë se çfarë dhe si duhet ta mbrojmë nderin e kombit, Universitetin e Tiranës. Këto ditë më ka ardhur në mendje, e kam përmendur edhe në senat, një fjalë e profesor Kristo Frashërit, që na tregonte një histori të lordit Xhorxh Goshen, i cili ka qenë ambasador në Portën e Lartë në fund të shekullit XIX dhe kishte trupojë një shqiptar me emrin Riza (jam përpjekur ta gjej se nga cili vend ishte, sepse, sipas kërkimeve, më del nga Kosova, Tropoja, Berati, Dibra, Saranda dhe Maqedonia) dhe një ditë, kur ambasadori britanik lëvizte në Stamboll, një iranien donte ta vriste, por shqiptari i shpëton jetën lordit. Pas kësaj ngjarjeje mbledhen të gjithë tek ambasada britanike dhe e pyesin shqiptarin, me veshje kombëtare, se çfarë donte në këmbim të kësaj që bëri, dhe përgjigjja që i ktheu shqiptari Riza ishte: “I nderuar ambasador, të nderuar të gjithë që keni ardhur këtu për të më nderuar mua për atë që kam bërë, unë kërkoj vetëm një gjë: di që nëpër tavolinat e mëdha, ku vendosen fatet e kombeve, ju britanikët keni një rol të madh, prandaj, ju lutem, thoni një fjalë të mirë për shqiptarët!”. Në historinë e lordit Xhorxh Goshen kam lexuar se në 15-20 vjet ai ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për çështjet shqiptare dhe kjo falë shqiptarit Riza, i cili i kërkoi pikërisht atë gjë lordit. Lordi ka kontribuar në Shqipëri edhe me bibliotekë.

E përmenda këtë dhe kam bindjen se pas kësaj situatë të gjithë ne që jemi të lidhur me universitetin, por edhe ju, të nderuar deputetë, që pjesa më e madhe prej jush është e lidhur me Universitetin e Tiranës, kam bindjen se do të kontribuoni për të ruajtur nderin, dinjitetin dhe fuqinë e këtij universiteti.

Kushdo që mendon se pas kësaj situatë Universiteti i Tiranës do të rrënohet, të jetë i bindur se rezultati është i kundërt. Universiteti i Tiranës tregoi që është i fortë, maxhoranca është progresive, pozitive, e mbron dhe do ta mbrojë Universitetin e Tiranës, sepse ky është institucioni që ka stafin më të mirë, studentët më të mirë dhe ka gjithçka tjetër më të mirë krahasuar me të tjerët, jo të bërë nga ne, por rankuar nga institucione ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë diskutime për aktet, për ligjin dhe autonominë e universitetit. Unë dua të shpreh opinionin tim lidhur me këtë lloj diskutimi. Në vitin 2015 përfaqësuesit e Universitetit të Tiranës kanë qenë të pranishëm në Komisionin e Edukimit për t’u shprehur për projektligjin e arsimit të lartë, që më pas u kthye në ligj. Ai projektligj ka bërë një rrugëtim të gjatë dhe po ju them, të dokumentuar, se kontributi i strukturave të Universitetit të Tiranës, të fakulteteve, të këshillave të fakulteteve dhe të senatit ka qenë i jashtëzakonshëm dhe kanë kontribuar për ta bërë atë ligj në formatin e fundit që erdhi. Në atë kohë ju kemi

përcjellë një raport të Shoqatës për Arsim dhe Edukim me kryetar, një profesor të shquar Ian de Gruf, me një raport 24 faqe, që ia kemi çuar Kuvendit, të cilën e kemi nxjerrë edhe te faqja jonë e fakultetit, i cili i bënte analizë ligjit të mëparshëm “Për arsimin e lartë”. Ky ishte një skaner i bukur për të futur në shina se si duhet të bëhej ligji i ri dhe kanë ndryshuar nga varianti fillestar jashtëzakonisht shumë pika, nene dhe konceptime të projektligjit, që u kthye në ligj. I kam të gjitha qëndrimet e fakulteteve, ku të gjithë kemi qenë dakord në një pikë të projektligjit të atëhershëm, që u kthye në ligj, ka qenë kapitulli XII. Kapitulli XII parashikonte krijimin e institucioneve publike të pavarura, e kemi bërë interpretimin dhe na është pranuar, sepse Kushtetuta universiteteve u jep autonomi, jo pavarësi. Po e ktheve në institucion publik të pavarur, pavarësia e kthen të mirën publike në të mirë private, pra diskutimet që i kemi bërë në mënyrë të detajuar në atë periudhë, na u morën parasysht dhe u kthyen në këtë format të ligjit “Për arsimin e lartë”, i cili u miratua. Pra, po diskutojmë dy gjëra: aktet dhe ligjin. Ka nga ata që thonë se aktet janë të paligjshme dhe ligji është jokohorent. Po the akti, ose do të mbrosh aktin, ose ligjin, sepse nuk ke me kë ta krahasosh. Në qoftë se është akti i paligjshëm, është i paligjshëm në raport me ligjin. Për sa u përket komenteve që bëhen, ndarjeve të mëdha, ato nuk bëhen për hir të ligjit, por për hir të situatës së krijuar, sepse ligji është korrekt. Problemet akademike ndahen në administrativo-financiare në të gjithë botën, pra janë me institucione të veçuara. Nuk kanë punë drejtuesit akademikë me problemet financiare. Këtë e gjejmë tek të gjitha universitetet ku kemi qenë, në vendet nordike, në të gjithë Europën, pra kudo ku kemi shkuar problemet administrativo-financiare i menaxhon tjetër strukturë, kurse problemet akademike i ka struktura akademike.

Ka pasur një problem të raporti Ian de Gruf, që merrte parasysht autonominë që kanë universitetet.

Të nderuar deputetë, ju e dini që autonominë nuk na e jep qeveria, autonominë na e ka dhënë sistemi, na e ka dhënë Kushtetuta dhe, për fat të mirë, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2008, i cila e konfirmon, në mënyrë eksplicite autonominë e universitetit për atë që na duhet sot dhe na është dashur në çdo kohë. Në ligjin e mëparshëm, në nenin 64/1, thuhej: “Ministri i Arsimit ka të drejtë të vlerësojë dhe të shfuqizojë aktet e universiteteve kur ai e vlerëson që këto bien në kundërshtim me ligjin”. Çfarë tha Gjykata Kushtetuese? Kjo sjelljeje është antikushtetuese. Ministri i Arsimit nuk mund të shfuqizojë aktet e universiteteve, kur këto akte janë në përputhje me kompetencat e tyre, jo çdo akt. Në qoftë se universitetet marrin vendime nga ato që nuk i kanë të linjës së tyre, patjetër që ato janë nul në përmbajtje. Autonomia jonë me këto diskutime që bëhen sot është më e thjeshtë dhe më e qartë nga pikëpamja kushtetuese. Universitetet autonominë e tyre e shprehin nëpërmjet strukturës dhe

organit që ligji ka parashikuar. Jo çdo strukturë mund të marrë përsipër të shprehet dhe të mbrojë autonominë e universitetit; nga pikëpamja ligjore ligji ka parashikuar senatin.

Të nderuar deputetë, senati në ligj është parashikuar që të garantojë autonominë, lirinë akademike dhe të drejtat e studentëve. Kjo është struktura që garanton ato që kemi merak dhe që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe, asnjë strukturë tjetër nuk e ka këtë të drejtë. Janë bërë diskutime për asamblenë. Asambleja është parashikuar në ligjin “Për arsimin e lartë”, me kompetencat dhe me statut. Asambleja ka katër kompetenca; çdo kompetencë tjetër përveç këtyre e bën të paligjshëm qëndrimin e asamblesë. Në ligj kompetencat e asamblesë janë: “Zgjedh rektorin, zgjedh anëtarët e senatit akademikë, zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore dhe krijon komisionet e përhershme të njësive kryesore”. Jo më kot Fakulteti Ekonomik nuk e mblodhi asamblenë, sepse e di që asambleja do të bëjë këto veprime, nuk mund ta zëvendësojë asambleja senatin. Çdolloj veprimi dhe vendimi i asambleve të fakulteteve të mbledhura, nuk e paragjykoj dëshirën e mirë për t’i mbledhur, por nga pikëpamja e vendimmartjes fundore ligji ka parashikuar se cilat janë institucionet që mbrojnë autonominë dhe të drejtat e studentëve. Senati i Universitetit të Tiranës këtë e ka bërë në mënyrë optimale dhe efektive: është shprehur edhe për protestën e studentëve, edhe për aktet. Në mënyrë institucionale grupi i ekspertëve juridikë dhe të fakulteteve të tjera ka përgatitur për aktet që dolën në kuadrin e paktit të universitetin, një raport që ia ka përcjellë qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit për t’u riparë këto akte, sepse ka ndër to që cenojnë autonominë, ka ndër to që duhen rishikuar. Pra, është shprehur institucioni që ka këtë përgjegjësi. Duke u shprehur ky institucion, patjetër që strukturat do të kthejnë përgjigje.

Të nderuar deputetë, kur merr vendim senati, vetëm gjykata i anulon vendimet e senatit, pra kjo është ajo që ka vendosur Gjykata Kushtetuese. Ne, në Fakultetin Ekonomik, nuk e mblodhëm asamblenë, sepse asambleja nuk mund të futet në një fushë që ligji nuk e ka parashikuar, sepse mund të mblidhet një asamble dhe, për shembull, të thotë: “Vendim, të shkrihet parlamenti i Shqipërisë”. Pra, asambleja nuk mund të marrë vendime për ato që ligji nuk e ka autorizuar. Ne jemi institucione që edukojmë dhe mësojmë të tjerët si të sillen, prandaj sjelljen e parë ligjore dhe institucionale kemi detyrë ta realizojmë vetë dhe unë kam bindjen se kjo është shfaqur në strukturat e Universitetit të Tiranës.

Shpesh diskutohet problemi i kërkimit. Këto ditë kam dëgjuar se nuk ka ardhur fondi për kërkimet e të tjera me radhë.

Të nderuar deputetë, ne kemi pasur një problem të madh, sepse statusi i Universitetit të Tiranës, me grupin e ngritur që në janar të vitit 2017, është miratuar vetëm para një muaj dhe kjo falë protestës së studentëve, të cilët duhet t’i falënderojmë. Pra, efekti i parë pozitiv i

protestës ishte që statuti u miratua. Ndërkohë që Ian de Gruf thoshte se nuk ka punë ministria të miratojë statusin kur ai votohet me 2/3-at. Kur votohet me 2/3-at nga senati, është vendim i senatit. Kështu që kontrolli i ligjshmërisë dhe vonesa e statutit ka krijuar një problem në cenimin e të drejtave të studentëve. Studentët tanë akoma nuk kanë organet e zgjedhura, por pa statut nuk ngrihen këshillat studentorë. Tashmë kemi një muaj që kemi krijuar statutin; do të fillojë funksionimi në raport me atë çfarë statuti parashikon në respekt dhe në zbatim të ligjit.

Për sa i përket situatës së protestës, e parë nga këndvështrimi i drejtuesit, por nisur edhe nga profesioni, në situata normale shfaqen karakteret normale të individit, në situata anormale, shfaqet anormalitet dhe anormaliteti mund të jetë pozitiv ose negativ, dhe u shfaqen të gjithëve. Këtu janë shfaqur jashtëzakonisht, shumë studentë me një situatë “dhuratë”, të cilët në situata normale nuk do të lëviznin, por kanë lëvizur. Unë kam parë te Fakulteti Ekonomik një grup të jashtëzakonshëm, që u impenjuan për problematikat e fakultetit, duke e ditur që është fakulteti më i mirë në Shqipëri, ku kanë ardhur studentët më të mirë, që ka stafin më të mirë dhe, si i tillë, kjo e mirë, kjo situatë e anormalitetit pozitiv i bën mirë situatës sonë. Por normalisht shfaqet edhe anormaliteti negativ dhe këto janë shfaqur, me kategori të ndryshme, gjë që nuk është shqetësim për trendin e Universitetit të Tiranës.

Për sa i përket kërkimit, pas miratimit të statutit në Universitetin e Tiranës, ngrihen komisionet përkatës të titujve, të gradave dhe të kërkimit. Pra, nuk ka më pengesa për sa u përket doktoraturave. Për shembull, në qoftë se më parë kuotat i miratonte ministria, tani me ligjin e ri i kemi të miratuara vetë, sepse çdo “Profesor” ka 7 kandidatë, kurse “Profesori i asociuar” ka 5 kandidatë, pra kuota është e lidhur me kategorinë e profesorëve që ka çdo fakultet.

Të nderuar deputetë, logjika është shumë e thjeshtë, kërkesa bëhet kur bën ofertën. Çfarë kërkimi do të bësh? Pra, në momentin që departamentet tona ofrojnë fushat e kërkimit, për të cilat ligji i ka parashikuar, ka nevojë shoqëria dhe ekonomia, atëherë troket dhe kërkon fonde. Nuk mund të kërkosh fonde apriori, më jep lekë ti mua, se unë i dua, pastaj unë do të zgjidh dhe zgjedh. Ky është një problem ynë i brendshëm. Nga brenda ne kemi detyrimin të përcaktojmë se cilat janë fushat. Në Fakultetin Ekonomik ne kemi filluar, çdo departament ka përcaktuar fushat e studimit dhe do t’u bëjmë ofertë institucioneve që lidhen me ekonominë, sipërmarrjes private, pra ne mund të kërkojmë dhe mund të bëjmë studim për këtë fushë. Ke interes? Gjenden paratë më pas.

Të nderuar deputetë, një fushë e madhe për të siguruar fonde kërkimi është Brukseli. Shqipëria është ndër vendet e fundit që siguron financim nga Brukseli. Këtu kemi një defekt në krijimin e një strukture që di të bëjë projekte. Ne, si Universitet i Tiranës, kemi fituar, kemi

qenë dhe partner kryesor, por në rang vendi kemi nevojë dhe është e domosdoshme të krijohet një strukturë, e cila të dijë të bëjë projekte në lidhje me të tjerët. Ka fonde të jashtëzakonshme për të bërë kërkim. Por atje bëhet konkurrenca reale. Se sa dhe si konkurron në fushën e kërkimit, gara bëhet atje ku janë të gjithë operatorët konkurrenciale të barabartë europianë. Universitetet europiane marrin fonde kërkimi jashtëzakonisht. Buxhetet e universitetit të Selanikut 60% e kanë nga Brukseli; marrin fonde për projekte dhe në projekte ka burime financiare për stafet, për ata që merren me kërkim dhe për universitetin në vetvete.

Të nderuar deputetë, situatën aktuale e shikoj me shumë optimizëm. Efekti i parë pozitiv, pas protestës, është se në Fakultetin Ekonomik, kur filloi mësimi, në qoftë se para protestës në çdo orë mësimi mungonin 2-3 pedagogë, tani mungesat janë zero, pra bëhet 100% mësim. Ky është efekti i protestës. Pse? Pedagogët që ishin indiferentë dhe mund të mungonin, tani nuk mungojnë më, nuk i lënë studentët të mungojnë.

Së dyti, u miratua statuti, edhe kjo është për efekt të protestës, do të ketë disa efekte jashtëzakonisht të mira në të drejtat e studentëve. Flasim shpesh dhe dëgjojmë “korrupsioni i pedagogëve, ky mori lekë, ai mori lekë”. Individët si karaktere janë njësoj kudo në botë. Pedagogë abuzivë mund të gjesh në Harvard dhe në Oksford; karakteret nuk i ndryshojmë dot. Çfarë kanë bërë ata? Kanë bërë sistem. Sistemi nuk të lë të jesh abuziv. Kanë bërë sistem në universitetet europiane. Pasi mbaron procesi i mësimi, ka procedura të tilla të marrjes së provimit, që ti nuk e ushtron dot abuzivizmin e notës. Këtë ne e bëjmë me procedura, mekanizma që kanë propozuar studentët. Për shembull, në Fakultetin Ekonomik, kur kam shkuar dekan, kam nxjerrë një urdhër: “Pedagogët, kur hartojnë tezën e provimit, duhet ta shpallin se studenti nivelin e tezës për të gjitha kategoritë e notave”, pra 33% e pyetjeve të jenë për notat 5-6, 33% për notat 7-8 dhe për notat 9-10. Ky është një mekanizëm i thjeshtë pedagogjik, sepse studentët nuk janë të gjithë të notës 10. Në qoftë se ti do që t’i ngelësh, bën pyetje për notën 10 dhe ngelin të gjithë ata të tjerët. Ky lloj mekanizmi e detyron pedagogun që të japë pyetje edhe për ata që duan notat 5-6 dhe pyetje për ata që duan notat 7-8, pra një mekanizëm vlerësimi për të eliminuar abuzivizmin negativ ose pozitiv, sepse ka edhe nga ata që kalojnë kot.

Së dyti, ka një mekanizëm tjetër për rastet kur pedagogët abuzojnë me notën, si pjesë e dëshirës dhe karakterit të tyre, një linjë tjetër që e propozuan tani studentët. Në qoftë se në një lëndë kam mbetur dy-tri herë në një departament, më lind e drejta ta zëvendësoj këtë lëndë me një tjetër. Është aq i thjeshtë e i bukur si mekanizëm dhe i eliminon të gjitha ato raste kur ndonjë pedagog ka dëshirë t’i mbajë peng studentët me abuzivizmin e notës. Protesta do të na bëjë realitet shumë shpejt një mekanizëm tjetër, që ne të vendosim, dhe do ta vendosim edhe

në rregullore, që studentët të zgjedhin, në qoftë se janë 3-4 lektorë, me cilin lektor do ta bëjnë mësimin. Pra, është parazgjedhja dhe seleksionimi që bën studenti se kush është lektori më i mirë. Kuptohet nuk do t'i marrë të gjithë ai, do të ndahen, por kështu bëhet një vlerësim i parë. Unë dua t'i bëj leksionet me filanin. Pra, protesta e studentëve, të nderuar deputetë, na krijoji avantazhe pozitive, si një faktor i domosdoshëm, sidomos në drejtim të pranisë së tyre, se na kanë munguar.

Ka një problem buxheti...

Albana Vokshi – Ju lutem, për efekt të kohës, sepse kemi disa fakultete...

Dhori Kule – Ja mbarova. Faleminderit!

Një problem, dhe më vjen mirë që problemet e arsimit të lartë janë me shumë interes për ju, është ai i buxhetimit. Komisioni i Edukimit në momentin kur bëhet projektbuxheti, kam bindjen se këtë e tutje do të jetë më aktiv. Ne i bëjmë propozimet, projektet, por ka shumë rëndësi që ju, që jeni miratuesit për këtë pjesë të prioritetit që ka shoqëria në arsim, të keni më shumë argumente që buxheti të jetë më i madh. E keni shumë kollaj të bëni krahasime me rajonin. Universiteti i Lubjanës e ka buxhetin 310 milionë euro, i cili ka numrin e studentëve afërsisht sa yni, por edhe pak më shumë. Prandaj, normalisht situata e tanishme edhe këtu ndikoi pozitivisht. U shtua pjesa e financimit buxhetor. Të gjitha ato tarifa të rimbursuara tani u shtuan nga buxheti. Kam bindjen se me presionin pozitiv që do të bëni ju, edhe te ky element i domosdoshëm dhe i nevojshëm që kemi ne, do të kemi sukses. Më falni nëse u zgjata!

Ju falënderoj shumë që më dëgjuat!

Albana Vokshi – Faleminderit shumë, profesor!

Do t'ju lutem shumë edhe të tjerëve që ta mbajnë diskutimin brenda një minutazhi të caktuar 5-7 minuta, nëse është e mundur, sepse janë disa fakultete dhe jam e sigurt se ka edhe shumë pyetje e shqetësime që do të ngrihen nga deputetët.

Dua thjesht të sqaroj diçka, sepse ju në fjalën tuaj e përsëritët disa herë që ju qëllimisht nuk e keni mbledhur asamblenë e fakultetit tuaj. Pra, qëndrimi juaj si dekan është personal, pra nuk është si përfaqësues i asamblesë, thjesht për ta saktësuar, sepse shkresa që kemi dërguar nëpër fakultete është përfaqësimi nga asambletë. Dje kemi pasur një përfaqësim të një asambleje tjetër të disa fakulteteve, të cilët kishin edhe qëndrimet si përfaqësues...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë do që të jetë, vinin si përfaqësues të një grupimi të asamblesë dhe kishin marrë mandatin për të ardhur. Thjesht për të diferencuar qëndrimet: nëse ju, profesorë të nderuar, flisni në emrin tuaj, si dekanë, apo si përfaqësues të asambleve. Ndaj unë do t'ju kërkoj edhe profesorëve të tjerë, nëse kanë mbledhur asamblenë... Pse e them këtë? Ju përmendët katër pika

në fjalën tuaj për sa u përket funksioneve, kam përshtypjen se po i referohem statutit të universitetit, meqenëse edhe profesori e përmendi, por ka edhe një pikë të pestë, e cila thotë: “Asambleja e personelit akademik merr në analizë aktivitetin e fakultetit dhe autoriteteve të tij”. Mbase ne, si deputetë, kur kemi bërë kërkesën, i jemi referuar edhe kësaj pike që kemi kërkuar përfaqësi nga asambletë. Thjesht ta diferencojmë. Unë ju falënderoj për prezantimin, por ishte goxha i kompletuar!

Dhori Kule – Ju thashë që ne jemi në shtëpinë e hartimit të ligjit. Në qoftë se ka një vend, ku do të duhet të kërkohet maksimalisht sjellje ligjore, është pikërisht këtu. Unë në të gjithë karrierën time jam përpjekur dhe asnjëherë nuk kam çeduar te vendimmarrja në raport me ligjin. Ato funksione që kërkohen tani, i ka senati. Asambleja kryetar ka dekanin, pra në statut dekani është kryetar i asamblesë. Statuti ka një muaj që është miratuar. Kemi vënë një pikë në statut që merr në analizë edhe veprimtarinë e autoriteteve. Pra, do të bëhet ai aktivitet më pas. Të gjitha problemet e tjera të asamblesë janë ato funksione që ka. Kam marrë të gjitha analizat që kemi bërë kur është miratuar projektligji. Fakulteti i Histori-Filologjisë, meqë kemi profesor Shezai Rrokajn...

Albana Vokshi – Profesor, nuk ka problem, thjesht donim ta dinim, sepse kjo mbase nxiste edhe mbledhjen e asambleve. Ne e kemi diskutuar gjatë këtë pjesë. Nuk ka problem. Donim të dinim nëse vinit me mandat...

Dhori Kule – Unë jam kryetari i asamblesë. Me statut jam dekan, sepse përfaqësues me ligj nuk bëhet kushdo. Përfaqësues i departamentit me ligj është shefi i departamentit; i fakultetit është dekani; i universitetit për anën akademike është rektori. Prandaj është vendi që ato që kemi miratuar... Unë solla në vëmendjen tuaj që kemi respektuar ligjin në maksimum dhe do ta respektojmë. Vetëm duke respektuar ligjin, punët shkojnë mirë. Problemet që kemi ne janë pengesat ligjore dhe sjellja antiligjore. Edhe kjo është e bukur, është një test për të parë se si funksion ligji. Ndonjëherë e bën vetë testin, sepse krijon një strukturë që ta pengojë ligjin, për të parë se çfarë rregullimesh duhen bërë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, profesor!

Po ia kaloj fjalën menjëherë profesor Artur Sulës nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Ju lutem shumë, 5-7 minuta!

Artur Sula – Mirëdita të gjithëve! Dua të them se në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kemi pasur një situatë normale. Një pjesë e studentëve gjatë dy javëve të dhjetorit u bashkuan me pjesën e protestës. Gjatë dy vjetëve të mandatit dua të them se kemi pasur një kontakt të vazhdueshëm me studentët, të cilët e kanë parë veten shumë pranë dhe kanë qenë edhe

protagonistë të jetës aty. Bisedat kanë qenë gjithmonë të hapura. Dua të them se perceptimi im gjatë kësaj periudhe, meqenëse ishte një pyetje e tillë, është ky: në qoftë se ne do të kemi mundësi për kushte të plota për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë, dua të them se do të kemi mundësi të mëdha pas këtij zbatimi. E para, të shohim se ku çalojnë gjërat te ligji i arsimit të lartë, me qëllim që të kemi mundësi të propozojmë dhe të përmirësojmë. Nga ana tjetër, të shohim sa funksional dhe sa i mbarë do të jetë ai për nxitjen e punës.

Megjithatë, do të flas për një fakultet që ka një numër studentësh të motivuar, të paktën ashtu siç i shoh unë. Duke qenë të kujdesshëm për sa i përket zbatimit të ligjit, gjërat aty them se kanë ecur mjaft mirë, nuk mund të them në mënyrë të shkëlqyer, se nuk mund të lë pa përmendur këtu një lloj stresi që kemi pasur në menaxhimin vertikal nga rektori në dekanat. Në qoftë se do t'i mbledhim letrat që na vijnë nga rektorati, nuk i vëmë ende në peshë, por besoj se do të jetë një sasi e konsiderueshme, e cila nuk e justifikon shpenzimin.

Megjithatë, në mbështetje të veprimtarisë sonë, ka pasur edhe një raport nga Ministria e Arsimit, i cili u komunikua diku në shtator, ku nënvizoheshin disa elemente në lidhje me qëndrimin që rektori ka mbajtur ndaj drejtuesve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, ndaj meje personalisht dhe ndaj pjesës tjetër të menaxhimit financiar, ku nënvizonte shkellje. Njëkohësisht, u lanë edhe disa detyra, të cilat nuk u monitoruan më pas, për rregullimin e këtyre qëndrimeve. Gjatë gjithë kohës, me thënë të drejtën, kemi presione me disa fantazi, të cilat, të them të drejtën, nuk është se nuk i njohim, sepse nuk është se kemi diferencë të madhe në moshë. Ndoshta në paraqitje po, por jemi aty-aty me moshë me rektorin. Megjithatë, dua të them se, në qoftë se na lënë të punojmë dhe të zbatojmë ligjin, them se do të jemi edhe më shumë kontribuues për të parë se ku vërtet mund të ketë ndonjë gjë për të përmirësuar te ligji në fjalë. Kemi një numër studentësh, të cilët i gjejnë dyert e hapura të fakultetit tonë. Njëkohësisht, kemi ndjekur edhe politika të tilla, si të Erasmus-it.

Kemi edhe një avantazh, sepse Fakulteti i Gjuhëve të Huaja njihet për gjuhët e huaj dhe ka mundësi e akses në universitetet perëndimore, gjë që ka bërë të mundur që studentët tanë të shkojnë e të vijnë sa herë që është mundësia dhe sa herë e shikojnë me interes për formimin e tyre.

Në datën 7 janar kemi bërë mësim rregullisht. Një pjesë të fakultetit e kemi pasur të bllokuar nga Fakulteti i Histori- Filologjisë për vetë mënyrën se si është bërë ndarja. Një problem të tillë unë kisha kohë që e kisha vënë në dukje, me qëllim që fakulteti të ishte më funksional në ndarjen logjistike të vetë ndërtesës, por pashë që një pjesë e studentëve nuk ishin të informuar. Ata që u paraqitën si përfaqësues, nuk ishin të informuar që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është i mbuluar plotësisht me internet apo ka dy salla shumë të mira biblioteke, pra

elemente të tilla , të cilat studentët i morën vesh pikërisht gjatë protestës, ndoshta për arsye të caktuara që vetë ata që i përfaqësuan këta studentë ishin më shumë të angazhuar në punë sesa në jetën e universitetit. Megjithatë, fjala ime përmbyllëse është kjo: jam ende i prirur ta vazhdoj punën me këtë lloj tempizmi edhe për sa i përket realizimit të gjitha atyre që parashikon statuti i Universitetit të Tiranës. Po ju them se rezultatet do të jenë edhe më të konsoliduara, në qoftë se vërtet do të na lenë që të punojmë rehat.

Faleminderit shumë!

Albana Vokshi – Faleminderit shumë!

Po ia kaloj fjalën zëvendësdekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Agron Gjekmarkaj.

Agron Gjekmarkaj – Mirëdita të gjithëve!

Faleminderit për ftesën!

E çmojmë shumë këtë mundësi që po na jepni për të na dëgjuar dhe për të dialoguar së bashku. Unë bashkëndaj një pjesë të mirë të konsideratave që profesor Kule tha këtu për Universitetin e Tiranës. Është një pasuri e madhe kombëtare, për të cilën mbase duhet të investojmë të gjithë, që ta ruajmë dhe ta çojmë përpara. Nuk jam dakord me pjesën tjetër të gjërave. Unë mendoj se kjo ka qenë një situatë e jashtëzakonshme. Nëse nuk do të mbledhen asamblatë në këtë situatë, nuk ka kuptim ta mbledhim asamblenë më në Universitetin e Tiranës. Ju e dini të gjithë, sepse jeni njerëz të shkolluar, të kulturuar, që edhe diktaturat fillojnë me ligj si vullnet i shumicës kundër pakicës, pastaj përfundojnë si vullnet i pakicës kundër shumicës. Unë jam pjesë e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe ne e kemi mbledhur dy herë asamblenë. Jam krenar që jam pjesë e këtij fakulteti, i cili është një hapësirë lirie dhe për asnjë çast nuk është shndërruar në xhandar të interesave politike. Në asnjë çast nuk është bërë presion mbi studentët, por është respektuar vullneti i tyre i lirë për të menduar dhe për të protestuar. Në asnjë çast nuk është bërë presion dhe shantazh mbi pedagogët, por është respektuar vullneti i tyre i lirë për të menduar dhe për të protestuar, duke dhënë një shembull për botën akademike dhe intelektuale shqiptare. Kemi qenë nën agresion. Mendoj se dikush duhet të na kërkojë falje. Mund ta bëni edhe ju këtu. E pranojmë. Ne edhe sikur të ishim një trupë kriminelësh, jo akademikësh, kemi të drejtën të quhemi të pafajshëm derisa të provohet fajësia jonë. Ka qenë e padenjë gjuha që është përdorur ndaj botës akademike gjatë këtyre dy muajve. Kush është i kënaqur me të... Unë preferoj të jem Sokrat i vuajtur dhe jo derr i kënaqur.

Për sa i përket asaj që u quajt grup interesi, dua të siguroj zonjën Ekonomi se 230 pedagogë, që u mbledhën në sallën “Liria” si përfaqësues të asambleve, nuk janë thjesht grupe interesi, por është një grup i strukturuar intelektualisht, i cili e do Universitetin e Tiranës, e

njuh mirë atë dhe ka pasur një qasje pozitive për të prekur të gjitha problemet që janë shfaqur gjatë kësaj kohe. Kjo protestë nuk është një ngjarje e zakonshme, por është një ngjarje e jashtëzakonshme, e cila nuk mund të menaxhohet dot në mënyrën tipike, siç janë menaxhuar kryesisht krizat në Shqipëri. Nëse silleni në këtë mënyrë, e cila duhet të ishte një mënyrë hipokrite, i bie që po prodhojmë disa mina me plasje të vonuar, që do t'u shpërthejnë kësaj qeverie dhe qeverive të tjera më pas. Arsimi është një problem i madh kombëtar.

Për sa i përket ligjit të arsimit të lartë, ne, si fakultet, në katër vjet kemi çuar 2200 faqe oponencë, do të ishte mirë të paktën të na kthenit letrën, sepse jemi keq edhe për letër!

Përballë kam dy kolegë të nderuar, dy dekanë, të cilët, për hir të së vërtetës, janë sjellë në sintoni me trupën akademike gjatë kohës që kanë qeverisur Fakultetin e Histori-Filologjisë.

Duhet të themi se ligji i arsimit të lartë është përjetuar nga Universiteti publik i Tiranës si një dhunë, si një akt i paprecedent interesash klienteliste ndaj publikut në Shqipëri. Është e kotë të fshihemi pas fjalëve. Ky ligj është kundërshtuar masivisht dhe shumica e trupës akademike dhe e studentëve nuk e pranojnë.

Ne nuk kemi kërkuar të krijojmë vakum ligjor, sepse thuhet shpesh që nuk janë shkronja të shkruara në gur, por, në fakt, ato ngjajnë krejt si pllakat e Moisiut, si urdhëresat e pandryshueshme. Ne kemi kërkuar të hapet një proces dhe të shfaqet një vullnet për ta ndryshuar ligjin e arsimit të lartë, pra jo për ta lënë Shqipërinë pa ligj. Janë shprehur shumë persona për këtë ligj, është shprehur profesor De Grof, siç tha profesor Kule, një autoritet i njohur, që e rrëzon në thelb ligjin. Megjithatë, nuk u mor parasysh dhe pas dy vjetëve debat, ligji u miratua me shumicën e kartonëve, duke prodhuar pikërisht këtë krizë në të cilën gjenden sot universitetet.

E fundit, por mendoj se është një gjë që duhet të na nxisë të gjithëve të reflektojmë, ka ndodhur një gjë e rëndë, një gjë e paprecedent: policia është futur në ambientet e Universitetit të Tiranës. Kjo ka ndodhur një herë, nuk e di sa e ligjshme është, mund të jetë edhe e ligjshme, por është e pamoralshme, është joetike, me kërkesë të administratorit të Universitetit të Tiranës. Ka ndodhur dy herë, pasi është shfajësuar vetë ministri i Brendshëm në Fakultetin e Histori-Filologjisë.

Unë jam këtu si përfaqësues i asamblesë dhe si zëri i kolegëve, ndaj jua them troç të gjithëve: nuk kam frikë! Nuk kemi frikë! Nuk impresionohemi! Mos kini fare frikë, pra i ftoj edhe të tjerët të mos kenë frikë, sepse frika e ul shumë cilësinë e jetës!

Shpresoj që rasti i Filologjikut të jetë diçka jo me vullnetin e ministrit, por vetë ministri duhet të dalë të na kërkojë falje. Nëse është në vullnetin e ministrit, ai duhet të japë dorëheqjen, për të qetësuar botën akademike për këtë fyerje që i ka bërë!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Në fakt, ju kërkuat falje prej nesh, por nuk mendoj se ne kemi bërë diçka për t'ju kërkuar falje juve, përkundrazi, jam e sigurt që edhe kolegët e maxhorancës kanë qenë në mbrojtje, deri diku, të protestës së studentëve, protestës tuaj. Ndaj, do ta ftoja ministrin e Brendshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam ftuar kur ishte prezent në këtë komision, kemi bërë një dëgjese , që ka zgjatur tri-katër orë në lidhje me ngjarjen e pare, kur policia ndërhyri me dhunë, e kemi ftuar përsëri dje në lidhje me ngjarjen e dytë, atë brenda ambienteve të Filologjikut.

Në fakt, i ftuam të dy ministrat, edhe ministren e Arsimit, edhe ministrin e Brendshëm, për të raportuar në lidhje me ngjarjen e rëndë, atë të dytën, por përsëri refuzuan të vinin në komision, duke shpërfillur komisionin, duke shpërfillur parlamentin.

Në fund të fundit, duke qenë se ne jemi përfaqësues të interesave të qytetarëve, unë do ta ftoja jo vetëm që t'ju kërkonte falje, por të ndërmernte hapa konkretë në lidhje me analizimin e ngjarjeve dhe ndëshkimin e fajtorëve. Ai që ka dhënë urdhër në hierarkinë e policisë, të marrë atë çka ai meriton. Nëse ka shkelur ligjin, pra çdo shkelës i ligjit duhet të shkojë para ligjit dhe të ndëshkohet.

Agron Gjekmarkaj – Më falni, por unë isha mjaft i qartë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – E kam unë radhën për procedurë, pastaj zoti Gjekmarkaj.

Për procedurë, dua të theksoj edhe një herë: ministrat nuk kanë refuzuar të marrin pjesë, përkundrazi, kanë kthyer përgjigje se në një moment të përshtatshëm do të vijnë të bëjnë dëgjuesën, kjo për arsye se shkresa u shkoi dje në mëngjes, që është e rëndësishme për t'u përmendur.

E dyta gjë e rëndësishme, që na bën të kuptojmë sot, është që dje ne dëgjuam nga kolegët tuaj, zoti Gjekmarkaj, se ata kishin hyrë vetëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ata komunikuan se policia kishte hyrë një herë, dy policë kishin hyrë në oborr, kishin hyrë në korridor, ndërkohë ju sapo thatë se kanë hyrë dy herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Agron Gjekmarkaj – Kanë hyrë brenda dhe kjo është e regjistruar me video.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, kjo gjë tregon...

(Zoti Gjekmarkaj dhe deputetja Ekonomi flasin njëkohësisht.)

Më falni, më lini të mbaroj!

Agron Gjekmarkaj – Mjafton të klikoni në *Google* dhe mund ta gjeni menjëherë.

Milva Ekonomi – Më lini të mbaroj!

Kjo është pikërisht një nga arsyet pse kërkohet që çështja të trajtohet me shumë kujdes dhe jo duke i thirrur ministrat me shpejtësi në dëgjese para komisionit. Kështu që, për këtë arsye, unë besoj se komisioni i ka marrë të gjitha masat për të bërë takimet kur të jenë oportune.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për ministren e Arsimit a keni marrë ju, zonja Ekonomi, ndonjë përgjigje, se nuk ka ardhur në komision fare? Ka ardhur vetëm Ministria e Brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka asnjë problem.

Por qoftë një herë, qoftë dy herë, me aq sa e njoh unë ligjin, në qoftë se hyn edhe brenda rrethimit të jashtëm të një fakulteti, është shkelje e ligjit, aq më tepër që të pyesësh nëse ka filluar ose jo mësimi, sikurse profesor Marku e shpjegoi krejt qartë. Pra, policia duhet të kishte reaguar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë këtë thashë, që e ftoj ministrin të ndërmarrë hapat e nevojshëm, në qoftë se është shkelur ligji.

Jo vetëm falje, por edhe të veprojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Për procedurë.

Në fakt, e kam për policinë, është e pafalshme që një ditë pasi ne kishim në dëgjese ministrin e Brendshëm për ndërhyrjen e policisë në ambientet e Universitetit të Tiranës, të nesërmen ata të ishin përsëri në ambientet e disa fakulteteve.

Ne që e kemi drejtuar atë fakultet, qoftë edhe të tjerët, kemi parë shpeshherë policë në ambientet tona, që vijnë interesohen për fëmijët e tyre dhe është normale. Por të vijnë policë, të pyesin, të dëgjojnë nga studentët se çfarë po ndodh, po bëjnë mësim ose jo, dhe nëpërmjet radios të njoftojnë eprorët e tyre se në këtë fakultet disa klasa bëjnë mësim, disa të tjera nuk bëjnë mësim, ky është një kontroll që e bën Ministria e Arsimit. Pra, mund të pyesë Ministria e Arsimit nëse bëhet ose jo mësim, ç'punë ka policia të dijë se çfarë ndodh në ambientet e brendshme të Fakultetit të Histori-Filologjisë?! Kjo nuk ka ndodhur as në diktaturë!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Kishit diçka për të shtuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kërkoi fjalën...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Agron Gjekmarkaj – Lidhur me faljen, nuk e kisha që të na kërkoni ju falje për sjelljen e policisë, por për gjuhën denigruese, që është përdorur ndaj trupës akademike. Ne i zbërthejmë mjaft mirë, jemi profesionistë metaforash dhe dimë t'i lexojmë ato. Pra, gjuha e përdorur, ka qenë e papranueshme.

Nëse dikujt i duket e pranueshme, le ta mbajë, ndërsa unë e refuzoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën tani dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, profesor Artan Hoxhës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Hoxha – Mirëdita!

Ju falënderojmë për ftesën që na keni bërë!

Unë do ta nis me një falënderim më të madh se ky, në fakt, për studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të cilët sot kanë rifilluar studimet në ambientet e tyre në Fakultetin e Drejtësisë, i cili mbrëmë u lirua nga studentët, dhe jo nga studentë që e mbanin atë të bllokuar për shumicën absolute të studentëve të këtij fakulteti, që kanë dashur të bëjnë mësim dhe të cilëve iu dha mundësia të vazhdonin procesin mësimor të ndërprerë, duke shkuar në ambiente të tjera, jo të përshtatshme sa duhet për një njësi universitare!

Sot jemi rikthyer në universitetin tonë. Kemi studentë të gëzuar dhe të lumtur që u rikthyen në ambientet e tyre. Ajo që tha edhe profesor Kule, nëse kemi pasur mungesa, këto mungesa sot janë më të pakta. Shikojmë studentë më të përgjegjshëm, me më shumë dëshirë për të zhvilluar procesin mësimor, qoftë edhe për një arsye të thjeshtë, sepse viti akademik po vjen drejt mbylljes në semestrin e parë dhe nevoja për të plotësuar programin bëhet një nevojë akute.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me këtë rast, do t'i uroja personelit akademik dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë vazhdimin normal të studimeve dhe të programit mësimor, për ta përmbyllur atë me sukses.

Kjo protestë e studentëve, në fakt, na ka lëvizur të gjithëve. Nga njëra anë, ajo tregoi se arsimi i lartë në Shqipëri nuk është atje ku duhet si për sa i përket cilësisë së tij në mësimdhënie, ashtu edhe për sa i përket cilësisë së tij në kërkimin shkencor, ndërsa, nga ana tjetër, tregoi se këto janë defektet tona, të vetë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe gjëra që

diheshin, por që u evidentuan në mënyrë të dukshme nga një grup, që është shumë i rëndësishëm, që janë studentët. Gjithashtu, u evidentua fakti që buxheti ose mbështetja financiare për arsimin e lartë në Shqipëri nuk është fare në nivelin që kërkohet. Nuk është sot. Unë kam dhjetë vjet që jam pedagog i brendshëm në Universitetin e Tiranës, pasi kam lënë detyrat e mëparshme. Në këta dhjetë vjet apo edhe më pare, ajo që ne kemi diskutuar vazhdimisht është fakti se buxheti i përcaktuar nga qeveritë për arsimin e lartë ka qenë minimalist, aq sa nuk realizonte në të gjitha këto vite, në këta dhjetë vjet, pagesën e plotë të pagave të personelit akademik, jo më të bëhej fjalë për kërkim shkencor apo për nevoja të tjera që arsimi i lartë ka.

Thënë këto, protesta e studentëve ka qenë e mbështetur nga personeli akademik dhe këtë lloj mbështetjeje ne nuk e kemi bërë nëpërmjet protestave ose grevave, por me vendimmarrjen e organeve që drejtojnë Universitetin e Tiranës ne kemi treguar se studentët duhet t'i realizojnë të drejtat që ata kanë dhe se ne e kemi detyrimin t'u përgjigjemi si atyre, ashtu edhe vetë veprimtarisë së institucioneve që drejojmë.

Unë këtu jam përfaqësues i asamblesë së personelit akademik, drejtues i asamblesë ligjërish, jam bashkë me dy nga drejtuesit e tjerë të Fakultetit të Drejtësisë. Përfaqësimin e kemi ligjor, pra nuk e kemi subjektiv dhe të vetëpërfaqësuar. Me këtë rast dua të them se ligji për arsimin e lartë e ka përcaktuar saktësisht se cilat janë autoritetet dhe organet drejtuese në nivel njësie, në nivel njësie kryesore dhe në nivel universiteti. Kështu që, ne këtu vijmë me atribut ligjor dhe përfaqësimi, pa qenë nevoja të mbledhim asamblenë dhe as t'i kërkojmë dikujt që të na e japë këtë atribut.

Unë dua të them diçka, që, në fakt, është një veçanti e Universitetit të Tiranës. Këtu kemi edhe dy ish-drejtues, që tashmë janë deputetë, të cilët janë edhe dëshmitarë të kësaj situate: Universiteti i Tiranës ka kaluar një situatë jo të mirë, me gjithë konsideratat që profesor Kule përmendi dhe që ne i ndajmë, pra ne jemi ai institucion që u tha, por ajo që dua të them është se Universiteti i Tiranës ka pasur një problem të rëndë të administrimit dhe të drejtimit të tij, i cili ka krijuar problematika tejet të veçanta, që nuk janë as çështje të ligjit, as çështje të akteve nënligjore dhe as çështje që lidhen me nevoja financimi apo me ide akademike, të cilat duhet të ndryshojnë për shkak të rrethanave të caktuara. Kanë qenë thjesht çështje e një drejtimi të gabuar të universitetit, nga rektori i Universitetit të Tiranës, i cili nuk arriti të kuptojë dhe besoj se vazhdon të mos kuptojë se çfarë do të thotë autonomi dhe liri akademike.

Ne kemi pasur probleme, të cilat kanë çuar deri në bllokimin e veprimtarive të caktuara apo të shërbimeve minimale për studentët. Prej gati dy vjetësh në fakultetin tonë nuk punon sistemi informatik i brendshëm, ndaj ne sot punojmë në mënyrë mekanike. Ne nuk

nxjerrim dot informacion elektronik. Kemi një sistem të tërë që duhet të funksionojë. Ne e kemi shumë të vështirë të nxjerrim një listë notash të studentëve apo vërtetime për studentë, të cilët kanë përfunduar shkollën apo që kanë nevojë sot të aplikojnë për të përfituar ato të drejta që Këshilli i Ministrave u ka dhënë për sa i përket uljes së tarifës, përgjysmimit të tarifës për studentët ekselentë, atyre që përfitojnë mospagimin e tarifave shkollore apo që përfitojnë bursë. Pra, duke mos funksionuar sistemi, ne duhet të punojmë në mënyrë mekanike.

E dyta, ne kemi pasur problem kuptimin e autonomisë së brendshme universitare, me tendencën e drejtimit të centralizuar të institucionit. Kemi pasur problem të kuptuarit e ndarjes së veprimtarive administrative nga veprimtaritë akademike dhe të kërkimit shkencor dhe që kanë bërë dualizëm apo ndërhyrje në kompetencat e administratorit prej rektorit të Universitetit të Tiranës, duke sjellë anomali deri në realizimin e kontratave financiare nga përfaqësues akademikë, në një kohë që e kanë të ndaluar me ligj për ta bërë një gjë të tillë.

Kjo situatë anormale në Universitetin e Tiranës, duke pasur parasysh peshën specifike që ka Universiteti i Tiranës në arsimin e lartë në Shqipëri, mendoj se ka qenë një incentivë për protestën e studentëve.

Si fakultet dhe si universitet ne kemi numrin më të madh fizik të studentëve, por edhe të cilësisë së tyre, të cilët ndikohen gradualisht. Me të gjitha problematikat që ne kemi pasur ndër vite, duke shtuar disa problematika artificiale që kanë të bëjnë me mosfunksionimin e strukturave ashtu siç duhet, unë mendoj se ka qenë një situatë që ka ndikuar edhe në protestën e studentëve.

Përveç komunikimeve të brendshme institucionale nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, të cilat janë evidentuar të gjitha, për këtë ka pasur edhe auditime të jashtme, të cilat nuk arritën dot të ndikojnë në përmirësimin e veprimtarisë së vetë institucionit. E arsyeshme është që këtë duhet ta bëjmë vetë, por, gjithsesi, kur ne pengojmë njëri-tjetrin është pak e vështirë që të funksionojë normalisht.

Në strukturën që unë drejtoj, i zgjedhur nga asambleja e përgjithshme dhe nga studentët, ne patëm një situatë normale pas kthimit të studentëve nga pushimet e dimrit. Në janar ne filluam mësimin normalisht për tri ditë. Kur në fakultetet e tjera nuk kishte filluar programi mësimor, këtë program ne e nisëm pa shqetësime, me një numër të kufizuar studentësh në ciklin e parë dhe me numër të plotë studentësh në ciklin e dytë të studimeve. Ditën e katërt të realizimit të programit në Fakultetin e Drejtësisë u bllokuan ambientet e auditoreve dhe sekretarisë mësimore nga studentë të fakultetit, të cilët vlerësuan që vazhdimi i protestës të bëhej në një mënyrë tjetër, për shkaqe që i dinë ata. Më pas, u zhvillua një komunikim i vazhdueshëm me studentët, deri në zvogëlimin e numrit të tyre në mënyrë të

ndjeshme. Në momentin kur mbetën 10-15 studentë të Fakultetit të Drejtësisë, në ndihmë të tyre erdhën student të fakulteteve dhe universiteteve të tjera, si dhe persona, të cilët nuk kishin lidhje fare me universitetin dhe me Fakultetin e Drejtësisë. Kjo bëri që situata në Fakultetin e Drejtësisë të rëndohej për disa arsye:

E para, të rëndohej, sepse nuk u jepej mundësia studentëve që donin të bënin mësim të zhvillonin programin mësimor.

E dyta, përveç studentëve tanë, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë kishte persona të paautorizuar.

E treta, në këto ambiente u bllokua i gjithë dokumentacioni i Fakultetit të Drejtësisë dhe u rrezikua sekretaria mësimore, si për sa i përket ruajtjes së dokumenteve, ashtu edhe për sa i përket nevojës që kjo sekretari t'u shërbente vetë studentëve dhe atyre që kanë nevojë për shërbimin e sekretarisë mësimore. Ne u bllokuam në të gjitha shërbimet ndaj të tretëve për një periudhë kohe. Sot i kemi në dispozicion këto ambiente dhe kemi filluar t'u përgjigjemi kërkesave të studentëve, ish-studentëve, si edhe peronave të tjerë që kërkojnë dokumentacion nga Fakulteti i Drejtësisë.

Mund të them që ne kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm si me studentët që donin të bënin mësim, ashtu edhe me studentët që kishin bllokuar ambientet. Meqenëse u rrit presioni i studentëve që donin të bënin mësim dhe ne kishim vetëm një mekanizëm për të kuptuar raportin midis studentëve që bojkotonin mësimin dhe atyre që donin të bënim mësim, si dhe në kushtet kur nuk donim të nxirrnim askënd forcërisht nga ambientet e fakultetit të drejtësisë, alternativa jonë ishte të spostoheshim në ambiente të tjera. Iu drejtua Ministrisë së Arsimit, e cila bëri të mundur që ambientet e shkollës së mesme të përgjithshme "Petro Nini Luarasi", që ndodhet afër fakultetit tonë, të vihehin në shërbim të Fakultetit të Drejtësisë pasi të mbaronte mësimi paradite i nxënësve, por edhe në ditët e fundjavës, të shtunën dhe të dielën.

Çfarë tregoi ky spostim i realizimit të programit mësimor? Tregoi që shumica absolute e studentëve të fakultetit të drejtësisë donin të bënin mësim. Ata ishin protestues, ashtu sikurse studentët që ishin ngjuar në fakultet. Ishin protestues që kërkonin realizimin e tetë pikave dhe më shumë se ato, por, nga ana tjetër, ishin të përgjegjshëm dhe kuptonin në mënyrë të drejtë që detyra e tyre dhe arsyeja pse ata janë në universitet është që të studiojnë dhe të realizojnë programet mësimore. Ne kuptuam që shumica absolute e studentëve donte të realizonte programin mësimor. Me kushte jo të përshtatshme, me klasa të vogla, sikurse është një shkollë e mesme, por me një shpërndarje më të mirë të pedagogëve, duke plotësuar nevojat e studentëve, ne arritëm që t'i rikthehemi procesit mësimor prej dy javësh në një ambient tjetër dhe sot t'i kthehemi procesit në ambientet tona.

Gjej rastin të falenderoj drejtuesit e shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi” për të gjithë mbështetjen që na dhanë për shqetësimin që ne kishim!

Ajo që unë dua të them si drejtues i Fakultetit të Drejtësisë është që aspiratat e studentëve dhe aspiratat e personelit akademik nuk përfunduan me mbylljen e protestës masive apo me largimin nga bojkoti në disa ambiente të institucioneve të arsimit të lartë. Unë mendoj se ne jemi në fillimin e zhvillimit të të gjitha kërkesave të studentëve dhe të nevojave që ka arsimit i lartë në Shqipëri që të jetë kompetitiv, i tillë që ajo që studentët tanë mësojnë dhe ajo që ne prodhojmë si kërkim shkencor të jetë në raport me nevojat dhe me aspiratat që ka Shqipëria në kuadrin e integritit në Bashkimin Europian.

Studentët na kanë vënë në lëvizje, por si fakultet ne kemi gati dy vjet që në mënyrë intensive aplikojmë në projektet e Bashkimit Europian dhe në projekte të tjera. Për herë të parë ne jemi partnerë me konsorciume perëndimore në programe të ndryshme.

Ligji për arsimin e lartë na jep mundësinë të gjenerojmë të ardhura, të cilat nuk kemi pse t’i marrim vetëm nga buxheti i shtetit apo nga studentët. Ka miliona euro të Bashkimit Europian dhe të strukturave të tjera që asistojnë arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Ne kemi filluar ta eksplorojmë këtë fushë dhe sot jemi fitues në tri projekte të Bashkimit Europian. Interesi për Fakultetin e Drejtësisë po shtohet edhe për shkakun se është fakulteti kryesor që edukon juristët në Shqipëri, por që një lloj letargjie jona e mëparshme nuk na ka bërë atraktivë, ashtu siç duhet të ishim. Mendoj se kemi hyrë në një rrugë që përmirësojmë vetveten dhe u ofrojmë studentëve më shumë mundësi për ta.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Të mbarojmë njëherë me të ftuarit dhe, më pas, do të bëjmë pyetje të gjithë.

Fjalën e ka profesor Edmond Rapti nga Fakulteti i Shkencave Sociale.

Edmond Rapti – Faleminderit!

Do të më falni për zërin, por jam me grip.

Dua të falenderoj komisionin për organizimin e kësaj dëgjese me drejtuesit e asambleve të fakulteteve të Universitetit të Tiranës!

Asambleja e Fakultetit të Shkencave Sociale përbëhet nga unë, si drejtues i asamblesë, dhe nga profesoret Marinela Sota, e cila ka qenë e pranishme edhe në ekipin që ka takuar ministrin e Arsimit dhe të Sportit para një jave për t’i dorëzuar vendimet e marra në asamblenë e mbledhur në godinën “Liria”.

Fakulteti i Shkencave Sociale është një fakultet i ri, 25-vjeçar, ndryshe nga fakultetet që drejtojnë kolegët, i cili ka sot 6 programe *bachelor* dhe 22 programe master shkencor dhe master profesional me rreth 3 mijë studentë.

Dua të theksoj se Fakulteti i Shkencave Sociale ka një grup studentësh, të cilët që në vitin 2015, kur u miratua ligji i arsimit të lartë, kanë kërkuar gjithmonë arsim publik falas. Bashkë me një pjesë tjetër të studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale, ky grup iu bashkua protestave studentore të nisura në datën 6 dhjetor. Gjatë muajit janar në Fakultetin e Shkencave Sociale nuk është zhvilluar mësim. Një grup studentësh, rreth 100 studentë, kanë ndenjur në ambientet e fakultetit, ku, siç e keni parë edhe në media, kanë zhvilluar biseda të ndryshme, shfaqur filma, dëgjuar muzikë, pra, kanë protestuar sipas mënyrës së tyre.

Pjesa tjetër, në mënyrë sporadike i është afruar mësimi, por nuk ka zhvilluar mësim për pjesën më të madhe të kohës gjatë muajit janar. Me kërkesën e 1/3-s së stafit të Fakultetit të Shkencave Sociale është mbledhur 2 herë asambleja.

Asambleja e parë ka kërkuar abrogimin e ligjit për arsimin e lartë, një numër pedagogësh që ishin në asamble, siç thotë edhe profesor Gjekmarkaj, duke mos shkuar në absurditetin që ne ta heqim ligjin dhe të punojmë pa një ligj për arsimin e lartë. Përsëri pas takimit që u bë në godinën “Iliria” është rimbledhur përsëri asambleja e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe ka kërkuar që stafi prej 36 anëtarësh, të kalojë në një grevë 3-ditore që, siç e dini, u realizua në Fakultetin e Shkencave Sociale, që në datën 6 shkurt përfundoi dhe që nga kjo datë në Fakultetin e Shkencave Sociale u rikthye dhe vazhdon normalisht mësimi.

Gjatë gjithë kësaj periudhe drejtuesit e fakultetit dhe grupet e ndryshme të pedagogëve kanë qenë në kontakte të vazhdueshme, si me grupin e studentëve që ka protestuar, ashtu edhe me grupin e studentëve që kërkojnë të bëjnë mësim. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se pas datës 20 janar një pjesë e madhe e studentëve duan të bëjnë mësim dhe ne, më në fund, arritëm të sigurojmë që në datën 4 shkurt të fillojmë procesin mësimor.

Kjo protestë studentore ishte një protestë, e cila inicioi premisat për të hapur një debat midis stafeve akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale, për të parë ecurinë e tyre në 2 shtyllat kryesore të zhvillimit të universitetit, që është procesi i mësimdhënies dhe procesi i kërkimit shkencor, për të realizuar shumë gjëra që na thanë studentët, të cilat mund të ishin neglizhuar për ca kohë, por që ky diskutim besoj se do të sjellë një rivitalizim, një energji pozitive në zhvillimin e arsimit shqiptar në Fakultetin e Shkencave Sociale.

Unë dua të theksoj se buxheti i fakulteteve të universiteteve është një buxhet që bazohet mbi dy momente. Është një grant që jepet nga universiteti, sipas ligjit të vitit 2007 dhe atij të vitit 2015, është edhe një pjesë tjetër, që vjen nga pagesat e studentëve, sipas ligjit

të vitit 2007 dhe atij të vitit 2015. Unë dua të theksoj se ky buxhet është një buxhet i universitetit dhe për sa i përket kërkimit shkencor, ky buxhet është i pamjaftueshëm.

Në këtë periudhë flitet shumë në lidhje me shërbime për të tretët. Unë do t'ju shprehja idenë time që këto shërbime për të tretët duhet të mbështesin fuqimisht fakultetet dhe universitetet. Edhe dje në një takim që kishim me disa përfaqësues të OSBE-së, u fol që shumë fondacione kërkojnë ekspertiza, studime mbi politikat e ndryshme sociale dhe mbi zhvillimet sociale në vend. Të gjitha këto bazohen mbi disa OJF, të cilat i marrin këto dhe nuk përfshihet universiteti, sepse universiteti apo fakulteti kanë disa veprime burokratike, të cilat nuk e lejojnë fakultetin të futet me zhdërvjelltësi në një projekt, ashtu si disa aktorë të tjerë.

Unë mendoj që duhet të ndryshojë kjo gjë për të mundësuar që fakultetet, universiteti shqiptar të mund të gjenerojnë edhe të ardhura të tjera, të cilat do të rrisin buxhetin, sepse për hir të së vërtetës, buxheti aktual e bën të pamundur zhvillimin e kërkimit shkencor në ato nivele dhe standarde si të universiteteve europiane.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, profesor!

Të fundit në radhë kam dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof. Dr. Spiro Dushku.

Spiro Dushku - Faleminderit!

Ndoshta ishte faji im që nuk arritëm ta sillnim shkresën, por unë kam biseduar me sekretarinë e komisionit për ta sjellë më vonë. Jam së bashku me përgjegjësin e Departamentit të Matematikës, profesor Artur Baxhaku, me të cilin përfaqësojmë asamblenë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Sigurisht, të gjithë kemi qenë aktivë dhe të impenjuar me situatën e protestës studentore, kemi dëgjuar pedagogët, opozitën dhe kësaj radhe dëgjuam studentët, që të shkundeshim nga pjesa e qetësisë edhe ne, edhe ju deputetët, apo edhe më gjerë.

Situata në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ndryshe nga fakultetet e tjera me kontributin e të gjitha departamenteve, në këshillin studentor, ka qenë relativisht më komode. Fakulteti ynë ka qenë një nga fakultetet më aktive dhe në ballë të protestës studentore, e cila është përkrahur në të gjitha deklaratat zyrtare që bëri Fakulteti i Shkencave, gjithmonë duke gjetur, në një farë mënyre, dakordësinë me studentët, të zhvillojnë protestën dhe të bëjnë kërkesat e tyre të drejta, pa cenuar procesin mësimor.

Sigurisht, situata e dhjetorit, në kohën kur fakultetet përgatiteshin për të bërë takimin e radhës të iniciuar nga Kryeministri, që një nga mundësitë që ne, në mënyrë urgjente,

mblodhëm departamentet për të pozicionuar veten tonë në lidhje me problematikat që kemi dhe për t'i prezantuar, duke gjetur rastin në takimet e radhës.

Unë kam këtu përpara një raport të gjerë, të ardhur nga departamentet, të datës 21 dhjetor, të cilin e kam shkurtuar dhe mund t'ia vë në dispozicion komisionit, i cili nuk ka të bëjë me protestat e janarit, ku konkluzioni për zbatueshmërinë dhe efektivitetin e ligjit për arsimin e lartë, i cili ka 3,5 vjet që është në fuqi, me VKM-të apo paketën në tërësi të akteve nënligjore, që shkojnë në 3,5 vjet kohë, mendimi është për rishikimin tërësor të këtij ligji. E njëjta situatë ka ardhur mbas protestave të janarit, kur janë bërë takime individuale me studentët, me këshillin studentor, mes departamenteve dhe studenteve, takime të asamblesë me personelin akademik, të cilin gjej rastin ta falënderoj, që ne na autorizoi për të bërë një deklaratë, për të cilën kam marrë shumë përgëzime dhe që ka qenë më e kopsitura dhe më komodja, që ka nxjerrë ndonjëherë Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Një nga pikat e kësaj deklarate, të cilën do ta perfrazoj pa lënë asgjë mangët, është: “Të kërkojë hartimin e ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor sipas standardeve dhe parimeve europiane, i cili do të ketë mbështetjen dhe konsensusin e gjerë e të gjitha forcave politike dhe të grupeve të interesit, për të siguruar qëndrueshmërinë e tij në kuadrin e reformimit të arsimit të lartë në Shqipëri”.

Desha të them, se në rast se ne duam të kemi një zhvillim të qëndrueshëm në arsim, duhet të kemi një ligj të qëndrueshëm. Për sa kohë ky ligj nuk e ka konsensusin e gjerë të të gjitha forcave politike dhe të grupeve të interesit, për sa kohë unë kam dëgjuar pozitën, e cila ngul këmbë që nuk e ndryshon këtë ligj, ndërkohë që dëgjoj opozitën që kur u miratua ligji për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor, bën deklaratën publike se vendimi i parë i opozitës kur të marrë pushtetin, do të jetë shfuqizimi i këtij ligji, në këtë moment, unë nuk besoj se është komode për çdo akademik që me këtë ligj, të cilin unë do ta quaja si kushtetutën tonë të arsimit, të bëhej një situatë apo një lojë e pandershme.

Unë mendoj se jemi në një situatë të paprecedent, kur ky ligj, që ka funksionuar për 3,5 vjet me të gjithë problematikën e tij, dhe nuk është aspak jodinjitoze, por është në dinjitetin e të gjithë deputetëve, pedagogëve dhe studentëve, dhe nuk ka asgjë të keqe që ligji të rishikohet, se cilat janë pikat e dobëta dhe të forta të tij, dhe të nxjerrim se çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë na ka lënë prapa, dhe nuk ka asgjë të keqe, nëse edhe ndryshimet sasiore çojnë në ndryshime cilësore. Unë nuk jam kundër kësaj pune.

Pra, po të themi problematikat që kemi, s'do të ndalojmë asnjëherë. Megjithatë, unë do të thosha se nisur nga problematikat, bëhet fjalë për të diskutuar për një rishikim të ligjit; këtu nuk flitet për abrogim, se nuk mund të funksionojmë pa ligj. Normalisht mund të ngrihet ideja që në Fakultetin e Shkencave të ngrihet një structure, një grup me deputetë të pozitës

dhe të opozitës, me pedagogë dhe me studentë, të jetë një komision gjithëpërfshirës, që do të japë ide dhe sugjerime në lidhje me këtë ligj . U ngritën vetë pedagogët në asamble për t'u atashuar në këtë grup pune.

Unë do të citoja shkarazi disa nga pikat që janë problematike në lidhje me ligjin. Mjafton të shikosh nenin 5. Që në hyrje të detyrimeve që ka shteti ndaj arsimit të lartë, shohim se shteti vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor, në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjikë të vendit.

Unë nuk e shoh këtë. Unë i takoj brezit të para vitit 1990 dhe kam qenë pjesë e temave studimore, nomenklaturë e Këshillit të Ministrave, por sot nuk shoh të kemi një strategji për kërkimin shkencor. Në këtë pikë jam kundër profesor Dhorit. Nuk mund të shkojmë t'u themi se çfarë dimë, por mund t'u themi se çfarë duan dhe pastaj t'u ofrojmë atë që dimë. Pra, ne nuk mund të shkojmë në çdo ministri, në çdo biznes dhe në çdo institucion, dhe t'u themi se ne dimë kimi, matematikë apo fizikë. Unë do të doja të më thuhet se çfarë kërkon kjo qeveri dhe se çfarë kërkon ministria, çfarë strategjie ka, që unë t'i ofroj të gjitha kapacitetet tona intelektuale, për të marrë pjesë në to.

Sigurisht, ne jemi në një pikë ku diskutohet shumë në lidhje me disa agjenci që janë pjesë e varësisë së ministrisë.

E para, vetë AKSH-i që në pikën e parë ka si detyrim ligjor të tij të sigurojë fondet për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve për doktoraturat.

Viti 2012-2013 është viti i fundit për aplikimin e doktoraturave. Po i heq 2 vjet, por në periudhën 2014-2018 nuk kemi asnjë doktoraturë.

Kemi rekrutuar staf të ri akademik, i cili pret të vazhdojë doktoraturat. Nuk është vetëm ngritja e komisioneve të përhershme për titujt e gradave, që kanë qenë pengesë nga statuti dhe nga problemet e veta në afate, por në momentin që ti nuk ke asnjë institucion për projekte të tilla, sigurisht edhe drita jeshile do të mbyllet.

Shpeshherë, dëgjojmë deklarata mediesh etj., kaq para për këtë dhe kaq para për atë, por për kërkimin shkencor ka pasur zero para. Kjo është e pamundur. I kam kërkuar edhe zyrtarisht administratorit të fakultetit vetëm në vitin 2018 se sa është fondi që kemi paguar nga të ardhurat tona për programet e kërkimit shkencor. Kjo shifër është rreth 16%. Në qoftë se ne japim 16 % për programet e kërkimit shkencor nga të ardhurat tona dhe po kaq të japë edhe qeveria, unë besoj se kërkimi shkencor nuk do të jetë në këto nivele, por do të ketë edhe ai pjesën e kontributit të tij.

Sigurisht, në doktoratura është një situatë alarmante, jo dinjitoze, me asistentët që kemi përballë dhe me atë që ligji na bën presion për të regjistruar. Sigurisht, është një pjesë e ligjit, ku mund të reduktohen, mund të cenohen deri diku kriteret e regjistrimit të doktoraturës. Pra, një gjë që nuk funksionon, që nuk realizohet, i ka edhe ajo problemet e veta. Nuk është mëkat nëse rishikohen qoftë pjesa e VKM-ve në lidhje me kualifikimin pedagogjik, qoftë edhe në ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, aty ku shprehet për doktoraturat, nuk ka asnjë gjë të keqe të ndryshohet për t'u hapur dritën jeshile të gjithë atyre që duan të ndjekin një doktoraturë, sidomos pjesën e stafit, të cilën unë e kam më merak nga të gjithë.

Kërkimi shkencor nga administratorët, është i pamundur, nëse ne do të menaxhojmë fonde për kërkimin shkencor me ligjin e menaxhimit financiar apo me prokurime publike. Sot të gjitha pajisjet me karakter teknik të fakultetit prokurohen në rektorat. Nëse ne kërkojmë autonomi financiare, të zbresin njësinë kryesore dhe a ka mundësi të zbresin edhe njësinë bazë? Jo për çdo gjë, por për fondet për kërkimin shkencor.

Një çështje që më ka bërë përshtypje dhe dua të ndaj me ju, është një ditë më pas. Ne themi se qeveria me fondet ka akses për arsimin e lartë pavarësisht ... disa individëve. Kjo është shumë e rëndësishme. Unë kam 2 vjet si shef departamenti dhe 2 vjet si dekan. Ne zbatojmë me përpikëri maksimale të gjitha VKM-të që nxjerr qeveria për rimbursimin dhe mbështetjen financiare të të gjitha kategorive të veçanta.

Ju jeni ligjvënës, ne jemi ligjzbatues dhe po ta shikoni, çdo VKM mbaron me fjalët: efekti financiar i kësaj VKM-je përballohet nga buxheti i shtetit. Nëse keni përfaqësues nga ministritë, ata e dinë se ne kemi vite që nuk marrim asnjë rimbursim nga buxheti i shtetit. Kështu, edhe kjo pikë nëse nuk zbatohet, ose të ndryshohet, ose të hiqet, se nuk është ndonjë gjë shumë e madhe.

Po flitet shumë për strukturën akademike dhe strukturën administrative, për kompetencat e rektorit dhe për kompetencat e dekanit. Unë nuk e shoh. Dy vija paralele që nuk priten gjëkund, nuk besoj se janë kulmi i suksesit.

Ndoshta, unë mund ta perfrazoj si një lindje me dy mami apo si një vapor me dy kapitenë. Besoj se e dini vetë fatin e këtij rasti, por sido që të jetë, mjafton ta shohim situatën jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethet e tjera, del se nuk ka një harmonizim ndërmjet këtyre dy strukturave, ndërkohë që unë e kam me ligj. Unë jap urdhra me karakter administrativ-financiar, propozoj shkarkimin e administratorit, që unë nuk e di nëse janë të realizueshme, apo jo.

Kështu, këto çështje janë pjesë e një diskutimi të mëtejshëm, pse jo, fare të hapur dhe konstruktiv, pa cenuar absolutisht detyrën që kanë. Pjesa administrative bën detyrën administrative, ndërsa pjesa akademike, bën detyrën akademike.

Diskutimet për asamblenë. Shohim se asambleja ka 5 pika në lidhje me statutin, propozimet e departamenteve janë të rikthimi drejt këshillave të fakulteteve. Trupat akademike me 180 vetë që kam unë, të jeni të bindur se nuk mund të nxjerrin një produkt shumë të pjekur. Ndërkohë, këshillat e fakulteteve i kishin përfaqësuesit më të gjerë nga çdo grup kërkimor-shkencor, i cili ishte gati-gati barabar me kapacitetin e një senati akademik. Pra, edhe kjo pikë nuk ka shanse, pse të mos ndryshohet. Do të ishte shumë mirë.

Neni 88 për mësuesinë është shumë problematik. E kemi ne problem, po i heqim VKM-të. Nuk po i hyj kësaj bisede, kam dërguar shkresat, por nuk kam marrë asnjë përgjigje, por po i kthehem faktit të mësuesisë. Ne kemi një pikë të përcaktuar, që të drejtën për provimin e shtetit e kanë vetëm ata që mbarojnë arsimin e mesëm, të lartë. Ka kërkesa të pafundme nga departamentet, në mënyrë që të bëjmë fleksibël studimet në fushën e mjekësisë për degë të përafërta, që edhe ata që janë me master shkencor, të kenë shansin për të aplikuar për në AML. Na është premtuar nga ministria e Arsimit, në një takim në Universitetin Politeknik, për të ndryshuar, amenduar pikërisht këtë nen, ku mjafton që studentëve, të cilët mbarojnë master shkencor në degë të përafërta dhe plotësojnë kreditet e duhura për profilin psikopedagogjik, t'u jepet e drejta për të vazhduar ose për të bërë stazhin dhe për të hyrë në provim në studimet e thelluara. Për këtë ka një VKM të vitit 2018, nuk e mbaj mend numrin, ju kërkoj ndjesë, e cila shprehet se për degë të përafërta, studentët që plotësojnë të gjithë modulën psikopedagogjik në qendra të licencuara për studimet e thelluara, kanë të drejtë të futen në këtë lloj provimi.

Ju lutem, më thoni: ku janë këto qendra? Unë jam dekan, më vijnë studentët, nuk e di nëse ka një qendër që ofron këto studime. Me ligj duhet të jetë. Për mendimin tim, i takon Fakultetit të Shkencave Sociale. Për mua ai që plotëson detyrimin ligjor, psikopedagogjik për AML-në zyrtare, të ofrojë edhe këto kurse, në mënyrë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo kreditë që jepen në universitet, për degë që janë jashtë, mendoj unë.

Edmond Rapti - Unë jap kredite për mësues, formim psikopedagogjik për mësues, jap 30 kredite. Për mendimin tim, është një gjë shumë e thjeshtë. Ai që mbaron matematikë speciale, biologji speciale apo master 2-vjeçar shkencor, gjuhësi apo nuk e di se çfarë, shumë kollaj mund të vijë në Fakultetin e Shkencave Sociale; me një urdhër të ministrit mund të marrë 30 kreditet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Spiro Drushku - Më fal! Nuk është aspak ashtu.

Mund ta sqaroj vetë këtë situatë. Studentët që mbarojnë masterin shkencor, nuk e kanë mundësinë për të bërë këtë lloj profili. Ne duhet ta zyrtarizojmë që studimet e thelluara në fushën e mësuesisë të kenë qendra të licencuara, sidomos duhet ta kishte Fakulteti i Shkencave Sociale, që t'i bënin dhe jo t'i blinin ato lloj kreditesh.

Dua të them diçka të fundit, pagesa që kërkohet, një kërkesë e studentëve, një kërkesë legjitime. Studentët, pasi mbarojnë AML-në, bëjnë stazhin, një stazh që nuk paguhet. Unë nuk e kuptoj të bësh një vit mësim dhe nuk të paguhet, bie në kundërshtim me Kodin e Punës, pasi një punë e bërë paguhet. Kam dëgjuar se këtyre personave u paguhen vetëm sigurimet shoqërore; më duket se as ato nuk janë paguar, jo më puna e një viti! Nga të gjithë studentët e AML-së është kërkuar me forcë që kjo pikë t'u adresohet deputetëve, që ta vendosin me ligj se stazhi i studentëve të AML-së, para se të hyjnë në provimin e shtetit, të jetë i pagueshëm, sikurse është kudo.

Meqenëse u nisa nga një emision i studentëve të Fakultetit të Shkencave lidhur me kartën e studentit, dëgjuam shumë se karta e studentit është përgjegjësi e institucioneve të arsimit të lartë. Nuk e kisha parë me shumë kujdes. Kam parë nenin 100, nuk e gjej se ku është pozicioni i arsimit të lartë në hartimin e kartës së studentit. Nëse kjo do të bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshohet me ligj, adresojani fakulteteve, universiteteve që ta bëjmë. Ajo është përgjegjësi e ministrisë, e Kryeministrit dhe e bashkisë. Deri tani nuk e kisha lexuar me shumë vëmendje, e keni pasur detyrim ligjor për ta bërë, nuk e keni bërë. Pse nuk e bëni? Po e bëjmë ne. Kush nënkupton të kundërtën, nuk e paskeni pasur detyrim ligjor dhe nëse duhet, të na e jepni që ta bëjmë.

Albana Vokshi - Faleminderit profesor!

Në fakt, kemi bërë shumë dëgjesa me rektorë, dje me profesorë dhe me juve, por kanë qenë vetëm burra. Duke ju kërkuar ndjesë profesorëve që janë në rreshtin e dytë, do të doja ndonjë zonjë. A ka ndonjë mendim? Po bëj një diskriminim pozitiv. Ju keni diçka?

Ngaqë e morën kohën burrat, ju lutem shumë shkurt.

Ju lutem prezantohuni, për efekt regjistrimi!

Jonila Godole - Quhem Jonida Godole, Fakulteti i Gazetarisë, Fakulteti Histori-Filologji. Kam një koment të shkurtër, si pjesëtare e kryeasamblesë, bashkë me dy kolegë të tjerë që po presin, edhe ata, për të dhënë mendimin e tyre. Më bëri përshtypje që në fillim diçka që profesor Kule tha në fjalën e tij: "Universiteti i Tiranës është nder i kombit". Për një moment, profesor, po mendoja nëse po flasim të dy për të njëjtin universitet apo jo. Universiteti

i Tiranës, i kishte të gjitha mundësitë që nga viti '90 dhe deri sot që të ishte nderi i kombit dhe të bëhej nderi i kombit, duke u bazuar tek elitat që do të prodhonte dhe tek elitat që ndikojnë tek ne, te stafi universitar, që ndikon për prodhimin e këtyre elitave. Për arsye të shumta, ndër të tjera është edhe mosndryshimi i elitave të vjetra nga viti '90 deri sot, por nuk do t'i futem kësaj gjëje. Ajo që shikojmë sot, ky universitet dhe këto elita, ne që jemi këtu, është se jemi duke punuar në kushte minimale, jo në kushte të tilla që të mund të bëjmë edhe punë shkencore dhe të arrijmë të kthehemi me të vërtetë në elita të respektuara të këtij vendi dhe pastaj të kemi edhe tagrin moral, profesional për të prodhuar elita të tjera, që do të vijnë dhe që janë shumë të nevojshme për këtë vend. Kushtet janë minimale jo vetëm për sa u përket kushteve në të cilat bëjmë mësim, një pjesë e madhe jeni në komision, kanë qenë ose në funksione të larta të universitetit, ose kanë qenë pedagogë dhe i njohin këto kushte për të cilat po flas shumë mirë, por mbi të gjitha janë kushtet e tjera, se si janë bërë deri tani rekrutimet në universitet, duke ruajtur, për mendimin tim, një lloj statuskuoje nga viti '90 deri tani, që ka qenë e fokusuar më tepër në moszhvillimin shkencor dhe në shtypjen e integritetit të pedagogëve, sidomos për ata pedagogë që kanë studiuar jashtë, kanë pasur mundësi të studiojnë jashtë, kur janë kthyer këtu, kanë vënë re një dallim si dita me natën.

Sado ne të përpiqemi të vazhdojmë kërkimin shkencor në mënyrë vullnetare, sikurse kemi bërë dhe të mbështetur nga institucione të huaja arsimore, asnjëherë, të paktën në rastin tim, nga Universiteti i Tiranës, mendoj se kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më kështu. Për fat të keq ligji për arsimin e lartë nuk është se ishte problemi. Nuk është problemi. Problemet e arsimit të lartë kanë qenë më përpara, vetëm se ligji i vitit 2015 nxori në pah se këto probleme janë akumuluar prej kohësh. Ky ligj nuk u jep zgjidhje, por mbi të gjitha mua, personalisht, dhe pjesëtarëve të fakultetit, kolegëve tanë na tregoi edhe diçka tjetër që është paksa më e rëndë, duke menduar në dy dekada e ca demokraci: vendimin autoritar të pushtetit mbi çdo qelizë dhe mbi gjithçka që funksion në këtë vend, duke u futur deri aty që të injorohen grupet e interesit të shprehen për ligjin. Për ligjin e vitit 2015, sikurse e tha edhe kolegu Gjekmarkaj, vetëm ne si fakultet kemi pasur mbi 2000 faqe oponencë, ndërkohë po të bashkohet kjo me qindra dhe mijëra faqe të të tjerëve, do të ishte, të paktën, në shenjë respekti të kësaj trupe universitare dhe akademike që të ishte gjetur një konsensus, të ishte gjetur një moment, ku të gjitha palët të uleshin së bashku, qoftë palët politike, ashtu edhe grupet e interesit, duke përfshirë edhe studentët, dhe të kishim biseduar për ligjin. Ligji “Për arsimin e lartë” nuk është pronë e asnjë pushteti politik, as i qeverisë që është sot, as i qeverive të tjera që mund të vijnë nesër. Ai na përket të gjithëve. Të gjithë duhet ta zgjidhim atë.

Jam dakord me kolegun e Shkencave të Natyrës, që thotë se një ligji, i cili nuk ka mbështetje nga të gjitha grupet e interesit, qoftë politike, qoftë ato akademike e të tjerë, nuk do të funksionojë dhe do të jetë gjithmonë kështu, do të na sjellë një ngërç më vonë. Këtë doja të thosha.

Ju lutem ta shikoni me përparësi një ridiskutim, një rishikim të ligjit, në ato pika të cilat e bëjnë të pamundur funksionimin normal të universitetit tonë!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Godole!

Është e fundit në radhë nga ana e të ftuarave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'jua kaloj fjalën juve.

Marinela Sota – Quhem Marinela Sota nga Fakulteti i Shkencave Sociale. E shikoj si një mundësi shumë të çmuar këtë diskutim sot, sepse shqetësimi për sistemin e arsimit të lartë publik dhe për problematikat që ligji dhe disa VKM kanë sjellë, dihen tashmë në Universitetin e Tiranës, të paktën, janë evidente. Ne gjithmonë kemi dashur dhe kemi krijuar mundësinë që t'i themi këto gjëra.

Së pari, dua të falënderoj profesoratin që ishte korrekt me gjithçka tregoi në historikun e mbledhjeve të asambleve dhe të vendimeve që këto të fundit kanë marrë në nivelin e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe për rolin që ka mbajtur në kuadrin e legjislacionit.

Dua të sqaroj një gjë në lidhje me asamblenë, e shikoj si detyrim që kam ndaj kolegëve në asamble, sepse ndryshe do të ishte e panevojshme përfaqësia ime këtu. Jam pedagog e thjeshtë, nuk jam as shefe departamentit, as zëvendësdekane. Asambleja ka një rol shumë të rëndësishëm, që fatmirësisht ligji ia ka njohur, që do të thotë se jo vetëm ka përgjegjësitë për të zgjedhur, por, nga ana tjetër, ka një hapësirë brenda ligjit që thotë se ka dhe çdo rol, funksion tjetër që mund t'ia njohë statuti i universitetit. Ky i fundit ka bërë shumë mirë që ia ka njohur asamblesë edhe të drejtën për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie në nivel fakulteti, merr në analizë aktivitetin e fakultetit dhe dinamikat e fakultetit, që do të thotë se asambleja duhet të mblidhet, të paktën një herë në vit. Nga eksperiencia ime akademike, kam dhënë mësim në fakultete në Suedi, mblidheshin një herë në muaj asambletë dhe këto të fundit luanin rolin e kërkesës së llogarisë, kryesisht ndaj organeve që merrnin vendimmarrje, që do të thotë dekani, shefat e departamenteve, zëvendësdekanët dhe kanë një rol shumë të madh për jetën brenda fakultetit. Nuk duhet reduktuar roli i asamblesë në një trupë akademike që vetëm zgjedh dhe nuk kërkon asnjë gjë, sepse ndryshe nuk do të ishte e vlefshme fare që ta kishim atë asamble.

Nuk dua të them shumë gjëra, sepse u thanë nga kolegët. Nga ato që u thane, rezultoi se ka 2 pika që janë shumë problematike: problemi i financimit, që nuk ua mbulon buxhetin

e nevojshëm universiteteve publike, nuk na mbulon as pagat si trupë akademike, lëri pastaj të tjerat.

Nga ana tjetër, ne kërkojmë të ngremë fonde në nivel departamenti. Kemi 2 projekte Erasmus tani që jemi duke folur, po ato nuk janë për të mbuluar buxhetin e munguar, që vjen nga qeveria, ato janë për zhvillim profesional, janë për mobilitet, janë për të njohur realitete të tjera dhe për t'i afruar me ne. Pra, nuk mund të përdoren si buxhet për arsimin e lartë.

Nga ana tjetër, modeli menaxherial, modeli financiar që propozon ligji, që është në ligj për momentin, është problematik. Modeli menaxherial, e thanë edhe kolegët, janë dy paralele që nuk afrohen askund. Duhet të ketë patjetër një vendimmarrje, sepse ne, Universiteti i Tiranës, jemi në kushte që nuk kemi vendimmarrje dhe jemi të bllokuar për një periudhë kaq të gjatë kohe, gjë që e sjell sistemi menaxherial i propozuar në ligj. Në një moment duhet të ketë një vendimmarrje dhe do të duhet të jetë fundi i kësaj gjeje.

Në lidhje me Universitetin e Tiranës, ka disa problematika. Profesor Kule i përmendi, që do të thotë se ne nuk kemi financim për të përmirësuar mësimdhënien dhe as për kërkim shkencor. Mua, deri tani, nuk më është financuar asnjë pjesëmarrje në asnjë konferencë, mua që bëj artikuj shkencor dhe duhet të kem një kërkim shkencor, që të çoj të dhëna dhe rezultate në një konferencë. Kjo nuk financohet.

Nga ana tjetër, sistemi për studentët ka një periudhë të gjatë kohe që nuk funksionon dhe ka një mbivendosje të jashtëzakonshme të roleve të sekretarive mësimore. Pedagogët vetë japin informacion për studentet, gjë që nuk e kanë detyrë fare ta bëjnë.

Nga ana tjetër, nuk ka asnjë përpjekje për të pasur një sistem informatik mësimdhënieje, se nuk janë vetëm studentët që kanë nevojë për informacion. Ne kemi nevojë për një sistem mësimdhënie që të jetë informativ, që unë të hedh leksionet, *pauerpont*-et, të kem komunikim me studentët e të tjera.

Asnjë nga këto nuk ekziston dhe dua ta theksoj që, gjithsesi, ne e shohim, kemi dy vendime të asambleve të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe që të dyja adresojnë problematikën që ne kemi në nivel fakulteti dhe të ligji “Për arsimin e lartë”.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Urdhëroni, Kesi!

Kestrin Kastro – Nga eksperiencia si juriste them se nuk ka ligj që të jetë absolutisht i mirë apo absolutisht i keq. Po kështu, besoj se nuk duhet të ketë ligj që të jetë absolutisht tabu. Kur ka problematika që sjellin pengesën e zbatimit të ligjit, edhe mund të ndërhyhet dhe të rregullohen këto problematika.

Nga ana tjetër, kam bindjen absolute se aktet nënligjore janë ato që e bëjnë një ligj më të mirë apo më të keq.

Në fakt, ne sot po hasim më tepër problematika me aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e ligjit “Për arsimin e lartë”. Gjithashtu, ky problem është evidentuar jo vetëm nga asambltetë, por është evidentuar edhe nga senati, i cili ka kërkuar edhe rishikimin e shumë prej akteve që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit aktual “Për arsimin e lartë”.

Prandaj do të them që duhet të bëhet një punë shumë e madhe, pikërisht për këtë rivlerësim të kuadrit rregullator për arsimin e lartë dhe të shikohet ku mund të ndërhyhet, çfarë mund të përmirësohet, që të jetë më cilësor dhe më pranë nevojave të universiteteve.

Ministria e Arsimit duhet të bëjë një punë paraprake në nxjerrjen e të gjitha akteve në konsultim, gjë që ka filluar, në fakt, me konsultimin e të gjitha akteve që prekin arsimin e lartë dhe në këtë rast ka një oponencë gratis, po themi, që e ofron profesori i universitetit, që është i pari grup interesi lidhur me këto akte, prandaj të përfitojë ta marrë këtë.

Jemi të gjithë shumë të interesuar për të bërë oponencë të këtyre akteve, për të dhënë mendimet tona se si këto akte të jenë më të mira, të jenë në një linjë dhe të shkojnë drejt përmirësimit edhe të atyre problematikave që mund të ketë ligji, brenda hapësirave që parashikon vetë ligji.

Ky është mendimi im, edhe si kryetare e grupit që ka bërë rivlerësimin e akteve për senatin, të cilat i janë përcjellë tashmë edhe qeverisë, edhe Ministrisë së Arsimit; do të kërkoja një rivlerësim apo edhe ngritjen e një grupi pune të mirëfilltë për rishikimin e akteve që rregullojnë arsimin e lartë.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Oponencën e keni bërë për të gjitha aktet nënligjore apo vetëm të fundit?

Kestrin Kastro – Jo. Është bërë për aktet e fundit që kanë dalë. Është kërkuar një rivlerësim i gjithë kuadrit ligjor.

Albana Vokshi – Ia keni adresuar ministrisë dhe KM-së? A mund të kemi edhe ne një kopjo të oponencës?

Zhaklina Peto – Jo vetëm aktet aktuale, të dala me shpejtësi tani në janar, por edhe aktet e tjera që lidhen ngushtësisht me normat e pedagogëve, disa udhëzime të Ministrisë së Arsimit janë në paketën e oponencave të bëra nga ne, edhe statusin e pedagogut e të gjitha me radhë. Unë do të thosha se problematikat, në fakt, këtu u fokusuan shumë te ligji “Për arsimin e lartë”, por në fakt ne të gjithë kemi qenë dakord që ligji ka problematika që në fillim.

Më shqetësoi pak komenti i koleges për elitat universitare. Unë bashkëjetoj me kolegët në universitet, punoj prej 23 vjetësh dhe, të them të drejtën edhe elita drejtuese, edhe elita universitare universiteti ynë ka nxjerrë plot.

Nuk është e vërtetë që të gjithë këta që na përfaqësojnë ne sot, pra deputetët, me gjithë respektin e madh që kam për ju, kanë ardhur nga postet drejtuese të fakulteteve. Unë mendoj se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë qenë pjesë jona, por do të vlerësoja shumë punën e çdo pedagogu dhe nuk do të pranoj në mënyrë absolute të gjitha përpjekjet që janë bërë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kësaj periudhe, për denigrimin e figurës së pedagogut, duke mos i hequr asnjë fjalë asaj çka tha profesor Dhori Kule në lidhje me këtë.

Gjithashtu, do të doja të thosha se ne jemi pro ligjeve të mira, ne jemi pro ligjeve që bëhen për pronësinë intelektuale, për të drejtat e autorit, për statusin e pedagogut e të gjitha me radhë, por, së pari, kërkojmë vëmendje nga politika, nga qeveria dhe nga parlamenti që të gjitha këto projektligje mos të bien ndesh me Kushtetutën, ashtu sikurse aktualisht ka ndodhur me gjithë grupimin e VKM-ve të dala nga qeveria.

Ndaj, vëmendja për mendimin e profesoratit për këtë gjë, do të ishte një faktor shumë i rëndësishëm për përmirësimin e këtyre VKM-ve dhe gjithë kuadrit ligjor.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Andi Pinari – Vij nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë. Kam 14 vjet që punoj atje dhe jam marrë kryesisht me çështjet e studentëve. Kam pasur disa pozicione administrative, ku kam pasur të bëj me ta shpesh, kam diskutuar me ta dhe, sigurisht, edhe gjatë këtyre dy muajve të protestës kam diskutuar rregullisht me studentët.

Desha të ngre disa probleme që lidhen me çështje që kanë të bëjnë me ta, sepse ne i përdorim si kundrinor, por asnjëherë si emërues dhe duhet ta tërheqim vëmendjen e këtij komisioni të nderuar drejt tyre.

Unë mendoj se ideja se si mund të funksiononte me mirë universiteti është pjesëmarrja gjithmonë e më e madhe e studentëve në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me ta. Kjo mund të realizohet duke bërë, së pari, zgjerimin e të drejtës së votës studentore, e cila për momentin është 10%, ka qenë 20%. Janë marrë disa modele në paktin për universitetin dhe maksimumin e ka Rumania me 25%. Do të ishte një akt shumë i mirëpritur, sepse demokracia në universitet është një demokraci e pjesshme. Në qoftë se ne zgjedhim dekan, rektor dhe shefat e departamentit, ne si pedagogë, studentët janë të përjashtuar, por hajde t'i përfshijmë sa më shumë, sepse në këtë mënyrë edhe të gjithë kolegët këtu e dinë se çfarë ndodh realisht nëpër zgjedhje, ku kandidatët polarizojnë procesin dhe kjo ndodh vetëm sepse studentët nuk janë pjesë e këtij procesi.

Në qoftë se ata do të bëhen pjesë të këtij procesi, unë nuk jam për 50%, se më duket shumë, por diku mes 25-30% besoj se do të ishte një nga ilaçet shumë të mira për demokracinë e brendshme, se ne kemi nevojë demokraci. Ne vijmë nga një vend që kemi ligje demokratike, por ne nuk kemi kulturë demokratike, kështu që hajdeni ta krijojmë këtë kulturë demokratike që në bankat e shkollës, që në bankat e universiteteve, sepse studentët votojnë për ju.

Në këtë linjë mund t'i përfshijmë gjithnjë e më tepër ata dhe t'i bëjmë edhe drejtuesit tanë, edhe veten tonë shumë më të përgjegjshëm në atë çfarë kemi.

Këtu po marr përsipër edhe një pjesë të përgjegjësisë.

Një çështje tjetër është ajo që ka të bëjë me mungesën e financimit, duke filluar që te pagat e pedagogëve. Ne kemi paga shumë të ulëta, por nuk dua ta ngre këtë si çështje, por duke pasur paga të ulëta, të cilat garantojnë vetëm për 8 muaj, 4 muajt e tjerë universiteti ka qenë i detyruar, jo të rrisë tarifat, por të rrisë numrin e studentëve. Duke rritur numrin e studentëve, pa pasur kapacitetet e nevojshme, ne jemi futur në një lojë tregu. Po mirë, mund të futem në një lojë tregu në fakultetin Ekonomik se ka tjetër ritëm, por në fakultetin Histori- Filologji çfarë loje tregu mund të bëjmë? Me kë të bëjmë tregti? Me gjuhën shqipe apo me historinë dhe kulturën tonë kombëtare? Çfarë mund të bëjmë ne që të jemi kaq atraktivë? Shpeshherë logjika e tregut në disa degë të caktuara nuk funksionon dhe gjithë këto probleme janë transmetuar poshtë, edhe në nivelin studentor.

Sigurisht, një problem tjetër i madh që u evidentua këtu ishte çështja e mosfunksionimit të këtij koordinimi me dy koka. Ju jeni deputetë dhe e dini mirë se ka ndarje pushtetesh, por ka edhe kontroll. Pra, duhet të ketë edhe një artificë ligjore që, në qoftë se bordi dhe senati apo rektori dhe administratori do të zihen përjetësisht, nëse kjo mund të ndodhë edhe pas emrave konkretë dhe të tjerët që mund të vijnë, atëherë ne duhet të gjejmë një mundësi që të bëjmë më të mundur vendimmarrjen, që universiteti të mos bllokohet.

Të nderuar deputetë,

Ne erdhëm këtu, unë të paktën erdha këtu, me idenë që të kemi mundësinë dhe ju duhet të keni edhe përgjegjësinë që të bashkëpunoni me njëri-tjetrin në raport me ligjin e arsimit të lartë, për ta riparë ose për ta ridiskutuar dhe për të bërë disa amendime.

Ne presim shumë prej jush, siç presim edhe nga vetja jonë, por këtë gjë e keni ju në dorë. Përpiquni të bashkëpunoni më shumë me njëri-tjetrin, në mënyrë që ta zgjidhim këtë problem, por, sigurisht, edhe shumë probleme të tjera që ka Shqipëria. Besoj se është momenti i duhur, pas gjithë asaj iniciative të madhe të studentëve, është koha e përshtatshme për të bërë të plotë reformën në universitet, e cila fillon tani, jo ato që janë bërë më parë, se kanë në qenë

të pjesshme, pa përfshirjen e studentëve, kurse tani i keni të gjitha kushtet për të ridiskutuar, për të bërë një ligj model. Nuk ka asnjë problem të ndryshosh ligjin.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Faleminderit edhe për ftesën për të bashkëpunuar! Jam shumë dakord. Ne i kemi bërë thirrje maxhorancës, jo një herë, po e përsëris, i kemi bërë një ftesë nga ana e deputetëve të opozitës për të hapur një debat, për të bërë një rishikim total të ligjit të arsimit të lartë. Ne jemi për rrëzimin total të ligjit, sepse ka shumë problematika. Është momenti që, nëse qeveria ulet dhe bie dakord për një rishikim tërësor të ligjit të arsimit të lartë, ne do të japim kontributin tonë, por kjo varet nga maxhoranca dhe unë shpresoj shumë që edhe pas këtyre dëgjësave, të reflektohet.

Urdhëroni, profesor!

Shezai Rrokaj - Të nderuar dhe të respektuar kolegë,

Ndihem mirë që jemi përballë njëri-tjetrit, por edhe dyfish më i përgjegjshëm për detyrimin që kemi marrë për të përfaqësuar spektrin tonë politik në këtë komision të nderuar, ku flitet për arsimin.

Ajo që dua të them është se, ndërsa ligji shpjegon shumë qartë në parimet e veta parimin e së drejtës për arsim, parimin e lirisë akademike, parimin e autonomisë financiare, parimin e paprekshmërisë së institucioneve, parimin e transparencës dhe parime të tjera të së mirës publike, këto parime janë cituar edhe më parë në ligjet e mëparshme, por çfarë ka ndodhur dhe çfarë ndodh, dhe për çfarë na shërbeu protesta e studentëve?

Për mendimin tim, protesta e studentëve na shërbeu për të reflektuar si shoqëri, për të reflektuar si grup interesi, për të reflektuar si grupime politike në atë që arsimi është një e mirë kombëtare dhe është më shumë se çdo e mirë partiake. Prandaj protesta e studentëve duhet të na bashkojë, grupet e interesit dhe grupimet politike, për të bërë një arsim të së mirës publike, sepse shoqëria shqiptare, që nga ky tranzicion nuk e ka ndarë ende raportin midis pushtetit ekzekutiv dhe institucioneve të arsimit të lartë, të cilat janë autonome. Ende vazhdohet me marrjen në patronazh. Unë e kam thënë edhe në Kuvend se institucionet e arsimit të lartë nuk merren në patronazh. Me to ndërtohet një marrëdhënie partneriteti mbi dobinë e ndërsjellë që kanë palët. Pra, ende pushteti i ardhur gjithë këta vjet nga një pushtet diktatorial, në reminishencën time, edhe si drejtues, është se gjithmonë i shikon si institucione të vartësisë. Nëse duam të bëjmë një arsim të lartë, duhet të heqim dorë nga koncepti i varësisë dhe t'i nënshtrohem konceptit të legjitimitetit të institucioneve të përcaktuara me ligj.

Ne e dimë fort mirë se truri nuk lidhet gjithmonë me xhepin. Nuk do të thotë se ai që ka pasuri, ka edhe tru më shumë, apo që një i varfër është medoemos i mençur. Që nga modeli i financimit, shoqëria shqiptare dhe qeveritë hoqën dorë nga financimi 4, 5 % – 5 % i arsimit. Kjo nuk është një kërkesë që doli sot. Ky është një model që e ndjekin vendet rrotull nesh, të përafrimit e të aspiratave që ne kemi. Pse? Sepse investimi në arsim është investimi më dobiprurës nga çdo lloj investimi tjetër, që nga ekonomia e kështu me radhë, sepse ka të bëjë me uljen e shpenzimeve, si rezultat i rritjes së shoqërisë së mençur.

Është një problem shumë i madh, që ne duhet ta zgjidhim. Dhe sinqerisht, të nderuar kolegë, nuk mjafton të themi: jemi dakord me protestën. Ne nuk mund të jemi më hipokritë. Ne duhet të themi: pse studentët e masterit nuk kanë përgjysmim të tarifës? Ne duhet të themi: pse studentët e *baçelor*-it, prej vitit që vjen, ata që janë me notë nën 6, nuk do të subvencionohen? Sepse, ne ende nuk e kemi kuptuar që, përpara se arsimi të jetë meritokraci, është një e drejtë. Duke qenë një e drejtë, është një e drejtë për të gjithë ata që e gëzojnë këtë të drejtë. Ende nuk kemi thënë “pse”.

Që kur isha dekan, me rektorin përkatës e kështu me radhë, gjithmonë bëhej politikë me shtresat në nevojë, katërmbëdhjetë kategoritë me ndihmë ekonomike e të tjera e të tjera, por qeveritë e radhës nuk u përgjigjën asnjëherë me subvencionim universitetit. Thoshin se duhet të përballohet, siç a thatë vetë këtu, nga të ardhurat e brendshme.

Ne nuk kemi marrë ende përgjigje, ndonëse asambleja e paska pushtetin të kufizuar. Por më thoni: cili organ kolegjal mund ta rregullojë jetën e një fakulteti, sepse këshillat e profesorëve dhe këshillat e fakulteteve ishin organe përfaqësimi? Bëhej debat, ishin të përzgjedhura.

Po pse ky ligj i hoqi këto? Nuk u reflektua.

Kemi probleme të tjera. Po më thoni: pse nuk funksionon sistemi i doktoratës? Ju e dini ç’do të thotë të hapet një doktoratë, një e drejtë studimi për doktoratë?! Ku duhet të shkosh, kush do ta miratojë, cilin projekt duhet të miratojë? Të mos i bëjmë karshillëk njëri-tjetrit.

Ne e dimë si funksionon kërkimi shkencor tek ne, sa parà ka një pedagog, për të ushtruar të drejtën e vet. Pra, ne e dimë se çfarë thonë VKM-të menjëherë. Po ku kemi parë ne, që për shkak se gjoja institucionet e varësisë ose të autonomisë, që janë universitetet, qenkan me një autonomi të zgjeruar, që është e kundërta, që nga bordet që kontrollojnë, u dashka që këto përgjegjësi t’i marrë ministria? Ministrinë dhe qeveritë e kanë të përcaktuar rolin e tyre. Dy role kanë: të bëjnë politikë dhe të auditojnë sipas neneve përkatëse. Ato nuk mund të rrëmbejnë kurrë të drejtën e lirisë akademike dhe të autonomisë, qoftë për të bërë transparencën

e profesoratis, qoftë për fusha që përcaktojnë, një institucion burokratik merr të drejtën dhe lirinë akademike të përcaktojë nëse projekti yt vlen.

Këto gjëra nuk bëhen kështu! Prandaj, dy gjëra kemi bashkë ne: të kërkojmë rritjen e buxhetit për arsimin që këtë vit me 1 %, dhe të fillojmë të ndryshojmë ligjin “Për arsimin e lartë” e, më shumë se kaq, filozofinë që ne duhet të kemi si shoqëri, si qeverisje.

Prandaj edhe dje, në një takim, u shpreha se ne ngatërrojmë shtetin me qeverinë, sepse qeveria kërkon gjithmonë të bëjë rolin e shtetit, ndërkohë që shtetin e përfaqësojnë, u kërkoj ndjesë kolegëve të juridikut, të gjitha ato institucione të shtetit, që nga institucionet e medieve, gjyqësorit e kështu me radhë, e një pjesë të autonomisë e kanë edhe institucionet e arsimit të lartë. Ato duhet të jenë autonome dhe të kenë liri, sepse po patën mbi kokë... siç ndodhi me cenimin e institucionit nëpërmjet policisë... Po ju e dini se kur duhet të ndërhyjë policia! Në tri raste ndërhyjnë policia në universitet: kur ka një vepër penale flagrante, në rastet e fatkeqësive natyrore, si dhe kur ka gjendje të jashtëzakonshme.

Ne vuajmë ende, se nuk zgjidhim dot kush është i pari. Këtu nuk po merret vesh se kush është i pari: rektori apo administratori, dekani apo administratori i fakultetit? Pa përmendur faktin se, sikur ne të zbatonim këtë ligj, vetëm Universiteti i Tiranës duhej të shtonte rreth 70 administratorë për njësitë bazë, që janë departamentet. Po, po, nëse zbatohet, rreth 70 departamente mund të jemi.

Pastaj flasim për burokraci! Sa më pak institucione e agjenci atje lart, jo pesë. Çfarë do të bëjnë pesë? Për dhjetë muaj rrogë? Çfarë do të ndajnë pesë agjenci? Çfarë buxheti ka për të ndarë? Pesë agjenci mbase duhen në Mbretërinë e Bashkuar!

Tani, kolegë të nderuar, unë këtë mesazh kam për të dhënë: që ne duhet të kërkojmë bashkë rritjen e buxhetit për arsimin. Studentët nuk kanë pse të kenë taksat më të shtrenjta në rajon. Duhet të kërkojmë ndryshimin e ligjit “Për arsimin e lartë”, për t’i dhënë Cezarit atë që i takon, që universitetet të kryejnë rolin e tyre.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Romeo.

Vetëm se do t’ju lutesha shumë që, përtej pjesës së opinioneve tona, që janë shumë të rëndësishme, të fokusohemi te pyetjet, sepse kemi dëgjesë me përfaqësuesit e asambleve.

Romeo Gurakuqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar profesorë, në fakt kemi dy ditë që dëgjojmë opionenca shumë të vlefshme për komisionin, në lidhje me korrigjimin e ligjit “Për arsimin e lartë”, por edhe korrigjimin e asaj çfarë mund të konsiderohet si një krizë reale në universitetet shqiptare.

Profesor Hoxha tha se arsimi i lartë nuk është aty ku duhet dhe sipas këndvështrimit tim kërkohet një drejtim tjetër, qoftë në aspektin e drejtimit të Ministrisë së Arsimit, qoftë në aspektin e drejtimit universitar.

Më vjen mirë që ka një thirrje për seriozitet nga akademikët, drejtuar kësaj salle dhe sallave të tjera të këtij institucioni, për një zgjidhje jo me koperturë dhe jo me arnime, një zgjidhje rrënjësore të problemit, por sipas asaj që unë kam vëzhguar gjatë këtyre ditëve, në këtë sallë, nga maxhoranca nuk ekziston disponibiliteti për zgjidhje reale të problemit.

Jemi para një kërkese nga një grup i strukturuar mjaft mirë intelektualisht, për një zgjidhje rrënjësore të problemit, si dhe një përpjekje nga ana e qeverisë sa për të kaluar radhën, nëpërmjet këtyre modelimeve dhe nëpërmjet të ashtuquajturit “Pakti për universitetin”, por që në fakt gjërat do të mbeten aty ku janë.

Unë mendoj se, para së gjithash, thirrja juaj drejtohet për vëmendjen, për rishkrimin, për zgjidhjen e problemeve, por, para së gjithash, për rritjen e buxhetit të arsimit të lartë, gjë që do të duhej të ishte bërë në muajin nëntor, kur kaloi buxheti në parlament. Kjo nuk u bë dhe nëse ju verifikoni se si është parashikuar financimi i arsimit të lartë, do të shihni se situata është aty ku ka qenë më përpara, pavarësisht përpjekjeve për rimodelim.

Pjesa tjetër ka të bëjë me faktin se studentët dhe profesori, pjesa e strukturuar intelektualisht, ata që kërkojnë ndryshimin e situatës, janë të bezdisur nga fakti se që prej pothuaj tre dekadash janë të njëjtët njerëz që menaxhojnë, duhet ta themi të vërtetën, sepse kemi ardhur për të thënë të vërtetën dhe jo gjysmë të vërtetës, të njëjtët njerëz që praktikisht janë në diskutim me qeveritë, për shkak të lidhjeve të shkurtra dhe kanë ndikuar në ndërhyrjet në legjislacion, një sërë ndërhyrjesh të realizuara edhe natën vonë në këtë sallë.

Për të gjitha këto arsye, unë kam nja tri pyetje për profesor Dhorin:

A ka ardhur momenti për ndryshimin dhe shfuqizimin e neneve që kanë mundësuar përcaktimin e vitit zero, vitit 2007, që në fakt i lë elitat drejtuese apo rrethet drejtuese universitare aty ku kanë qenë?

Së dyti, profesor, më korrigjoni nëse unë jam gabim, po për sa i përket pozitivitetit tuaj në lidhje me ndarjen e menaxhimit ekonomiko-financiar të universiteteve nga drejtimi akademik, kam përshtypjen se ngatërroi menaxhimin ekonomiko-financiar brenda universitetit, me menaxhimin si divizion paralel drejtues, gjë që në fakt ka krijuar atë dualitet që po e shohim herë pas here edhe në Universitetin e Tiranës.

Profesor, ju folët për një përpjekje për goditjen e Universitetit të Tiranës, me ndarjen që është realizuar në kohë të ndryshme. Mos keni parasysh një skemë tjetër të përcaktuar në ligj, në lidhje me ndërtimin e një sistemi konfederativ të drejtimit të Universitetit të Tiranës, i

cili përbëhet nga një kupolë drejtuese konfederatave, që është rektorati, ndarë në shkolla që kanë autonomi të përcaktuar krejtësisht qartë, që drejtohen në mënyrë autonome brenda kuadrit të autonomisë universitare, ku përfshihet Shkolla e Studimeve Humane, Shkolla Ekonomike, Shkolla e Ligjeve, Shkolla e Mjekësisë e kështu me radhë?

Këto janë, pak a shumë, pyetjet që kisha për ju.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Milva.

Milva Ekonomi – Të nderuar profesorë, që sot jeni këtu me ne!

Ne fakt, ne kemi bërë disa dëgjesa me trupa pedagogjike. Kemi thirrur këtu rektorë, dhe kishim përfaqësimin e trupës së pedagogëve, që vinte nga mbledhja e asamblesë së akademikëve. Ndërkohë, sot jemi me ju dhe dëgjoj lajmin e mirë se, më në fund, studimi ka filluar në të gjitha hapësirat universitare ose në fakultetet e Universitetit të Tiranës.

Kemi pasur këtu edhe rektorë, të cilët vinin nga universitete të ndryshme të Shqipërisë, qoftë nga Tirana, qoftë dhe nga rrethet. Kemi pasur këtu edhe rektorin Koni.

Ajo që unë kuptova nga ardhja e rektorëve të rretheve, është se nuk u prezantuan problemet e rektorateve të këtyre universiteteve të rretheve, jo të Tiranës, lidhur me menaxhimin financiar. Përkundrazi, kërkesa që patën rektorët e universiteteve të rretheve, ishte që për çështjet financiare të pyesnin administratorin, bordin e administrimit.

Unë shoh disa probleme, por problemi kryesor që shoh sot është momenti kur profesor Koni shpjegoi mënyrën se si funksiononte. Problemet që shtruat sot janë shumë të ndryshme nga paradëgjesa që ne kemi bërë me profesor Konin. Domethënë, ka një gjë që në Universitetin e Tiranës duket se është ndryshe nga universitetet e tjera të Republikës. Unë mendoj se kjo pyetje nuk gjen përgjigje sot, sepse duhet që edhe ne, që informojmë më shumë... Por është diçka që vumë re.

E dyta, besoj se ne që jemi këtu sot, kur ndodhi protesta e studentëve në vitet '90, kemi menduar që shkundi të gjithë vendin, solli pluralizmin politik, por bashkë me të solli edhe disa gjëra të tjera të rëndësishme.

E para, konkurrueshmëria duhet të jetë pjesë e mënyrës se si ne jetojmë. Për mua, e rëndësishme, gjithashtu, është që nuk janë ekzekutivët dhe qeveritë, ato që dinë të vërtetën e fundit. Këtë të vërtetë duhet ta shikojmë nga të tjerët, duhet ta dëgjojmë edhe nga grupet e ndryshme të interesit ose edhe nga masat që përfaqësojnë. Në këtë rast protesta e studentëve na solli në vëmendje që në arsimin e lartë ka disa probleme josipërfaqësore, që janë më të thella dhe menjëherë qeveria shqiptare reagoi nëpërmjet “Paktit për universitetin”. “Pakti për

universitetin” u shoqërua nga VKM-të dhe urdhrat e Kryeministrit, për të cilat ju thatë se keni bërë vëzhgimet dhe keni dhënë opinionet tuaja.

Megjithatë, unë mendoj se disa gjëra të rëndësishme të pakti lidhen me faktin që ju duhet më shumë financim dhe ky financim vjen pikërisht nga zbatimi i disa VKM-ve për tarifën. Mosfunksionimi i sekretarive në universitete apo në fakultete për të bërë listën për pagesën shtesë për fakultetet tuaja, që ta miratojë Bordi i Administrimit, është një nga veprimet që duhet të bëhet me shpejtësi, pavarësisht faktit që duhet të ketë një opozitë për këtë, sepse tarifën e shkollimit për shkollën e parë të studimeve u ulën me 50% për studentët e ekselencës, me mesatare 9-10. Kjo është një shtesë edhe për ju.

Para dy javësh ne miratim në parlamentin e Shqipërisë një akt normativ të buxhetit, ku pati tre komponentë të rëndësishëm, që lidheshin me arsimin: pakësi financiare për studentët, 2 miliardë lekë, që është shtesë për ju; Kampusi i Tiranës, 300 milionë lekë, që nuk lidhet me ju, por me jetën e studentëve dhe kampusi i Durrësit, 150 milionë lekë. Unë mbase besoj se duke operuar shpejt, mund t’i jepni një shans vetes, që të keni edhe buxhetin që ishte i rëndësishëm.

Tjetra që dua të shtoj, lidhet me konceptin që dha dikush nga ju për arsimimin pa tarifa që duhet të kemi në Republikën e Shqipërisë. Në fakt, ju vini nga bota akademike dhe këto natyrisht që i keni më shumë familjare. Objektivi 7 i Zhvillimit të Millenium-it thotë diçka që ka të bëjë me punën e denjë dhe arsimin e mirë të popullatës, që kërkon që GDP-ja e një vendi të jetë rreth 7%. Nëse kemi një informacion për sot, GDP-ja e Shqipërisë, aktualisht që flasim, është 4,2% e rritur, ndërkohë që në vitin 2013 ishte 1%. Domethënë, koha që ne duhet të mendojmë për një arsim falas, mund të jetë në momentin kur rritja vjetore e GDP-së të shkojë 7%. Unë besoj se ky është një presion që mund të bëhet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe, për këtë arsye, shikoj që në këtë moment është e parakohshme të diskutojmë për tarifa falas.

Ndërkohë, dua t’ju sjell në vëmendje edhe faktin që lidhet me kërkimet shkencore. Në buxhetin e vitit 2019 nuk u rritën shumë paratë për kërkimet shkencore, por vetëm 100 milionë lekë. Për kërkesat që keni, 100 milionë lekë janë të pamjaftueshme, por ka diçka të rëndësishme, që është projekti i kërkimit “Horizon 2020”, ku Shqipëria u bë pjesë nëpërmjet një *fee*-ja që paguan Ministria e Arsimit. A mund ta shtojmë përpjekjen për të qenë pjesë e “Horizon 2020”? Ndërkohë, nga lajmet që unë kam, mbase i kam të gabuara, deri tani, Fakulteti i Mjekësisë është përfituesi më i madh i këtyre fondeve, sepse arrin të bëjë projekte kërkimore, që të mund të jetë përfitues. Mbase duhet të ketë edhe një mënyrë tjetër, që duhet të shtojmë përpjekjen për të evidentuar brenda jush grupet që arrijnë të jenë kërkues të mirë dhe të kenë

hipoteza që mund t'i verifikojnë në kohë brenda trupës pedagogjike. Po e shtroj në formë pyetjeje: Është diskutuar në departamentet tuaja draftpakti? Jeni gati të jepni përgjigje? Disa përgjigje të draftpaktit gjenden në ligjin ekzistues. A janë përgjigje të mbështetura në nenet e ligjit ekzistues?

Tjetra, që është e rëndësishme, a mund të evidentojmë brenda jush ata që janë të aftë të merren me kërkim shkencor për të bërë projekte fituese?

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Në fakt, do të doja t'ju tërhiqja vëmendjen, jo juve, por në përgjithësi, që të mos merremi me probleme të brendshme institucionale. Nuk jemi këtu dhe nuk na takon, mendoj unë, që të ndërhyjmë, në ato që kanë vite tashmë që janë probleme të tyre të brendshme. Ne duhet të merremi me pjesën e legjislacionit. Ju lutem, të qëndrojmë jashtë dhe të mos bëhemi nxitës të problemeve që kanë me njëri-tjetrin! Nuk është vendi dhe as koha, mendoj. Nëse ka probleme institucionale, t'i zgjidhin jashtë kësaj salle, të mos përçojmë edhe këtu frymën e përçarjes që kërkon Kryeministri t'u fusë pedagogëve me njëri-tjetrin, studentëve me pedagogët. Të mbajmë një nivel respekti dhe etike për të ftuarit dhe të mos merremi me atë që nuk na takon, ju lutem!

Urdhëro, Valentina!

Valentina Duka – T'i mbledhim të gjitha deri në fund, sepse kështu ...

Albana Vokshi – T'i grumbullojmë?

Ka shumë pyetje që janë të ngjashme. T'i grupojmë, sepse ka edhe disa kolegë të tjerë dhe, më pas, do t'jua jap fjalën të gjithëve edhe një herë.

Valentina Duka – Të nderuar kolegë,

Ju falënderojmë që jemi bashkë këtu për të ndarë disa çështje shumë të rëndësishme, që shqetësojnë arsimin e lartë në përgjithësi!

Bashkohem me ju që sot në Shqipëri ka ardhur koha për një pakt konsensual për arsimin, në mënyrë që arsimin ta shikojmë si një të mirë publike, por edhe si një çështje shumë të rëndësishme të sigurisë kombëtare.

Në Shqipërinë e këtyre viteve, edhe në Shqipërinë e viteve '30, por edhe në botë, ka eksperiencë që kanë treguar shumë hapur disa gjëra të rëndësishme. Një vend i caktuar nuk mund të marrë një ligj, sado i mirë të jetë ai, siç është ligji anglo-sakson, që u trumbetua me shumicë se ligji që po përgatisim është anglo-sakson, që nuk ishte i tillë, por edhe sikur të ishte *copy-paste*, pa u mbështetur tek tradita e vendit, nuk funksionon. Më kujtohen debate të mëdha parlamentare në vitet '30 për dy kode të rëndësishme, Kodin Civil dhe Kodin Tregtar. Ata

njerëz të mençur, që morën disa ligje po shumë të mira nga Italia dhe Zvicra, kanë bërë debate shumë të mëdha, që pa iu përshtatur këto ligje mjedisit shqiptar, kurrë nuk funksionojnë. Në të ardhmen, i bëj thirrje edhe politikës shqiptare, sepse diskutojmë shpesh ligje këtu, vijnë ministra dhe paraqesin edhe vendin nga është marrë ligji, por ligje që nuk njohin eksperiencën shqiptare dhe kërkojnë implementimin e tyre jashtë kësaj eksperience, janë të destinuara të dështojnë. Kështu është edhe ligji për të cilin po flasim.

Kam një pyetje për dekanët, për anëtarët e stafeve. Ju keni kontaktuar shpesh me studentët, por edhe me pedagogët: cila ishte arsyeja kryesore e mbushjes së rrugëve të Shqipërisë me studentë? Ata nuk demonstrojnë para jush, por shkuan para Ministrisë së Arsimit. Dëgjova që dikush nga ju tha se fajin e ka universiteti. Mund ta ketë universiteti. Kjo është kthyer në ritual. Kryeministri, kudo që shkon, thotë se fajin e kishin universitetet dhe jo qeveria. Arsyeja kryesore ishte qeverisja e keqe, qeverisja e korruptuar, që i kishte varfëruar aq shumë familjet shqiptare, sa fëmijët e tyre nuk paguanin dot as 300 mijë lekë të vjetër për tarifat? Ishte ligji i arsimit të lartë që një pjesë e studentëve ndoshta nuk i kishin lexuar dispozitat, por familjeve shqiptare u erdhi në kurriz mënyra se si buxhetohen universitetet shqiptare apo ishit ju, drejtuesit e universiteteve, universitetet? Këto tri gjëra janë: qeveria, ligji, ju, ose të tria bashkë. Çfarë mendoni ju nga kontaktet që keni pasur me studentët, me stafet, ku duhet ndërhyrë, që të mos kemi më studentë në rrugë dhe të rregullohet mësimdhënia në universitetet shqiptare?

Jam dakord që universitetet shqiptare ka kohë që financohen pak, por nuk jam dakord me profesor Tanin për faktin që në ligjin e para 2013-ës, universitetet, dhe e di mirë profesor Dhori, përveç rrogave, që merrnin vërtet para për 8-9 rroga, ne gjeneronim shumë më shumë para për shkak të *part-time*-t, të shkollës doktorale, por qeveria sillte para edhe për investime. Në atë kohë u ndërtua fakulteti juaj, u rikonstruktua Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Sociale, fakulteti ynë, Fakulteti i Mjekësisë e të tjera. Keni marrë ju 1 qindarkë nga buxheti për investime me këtë ligj?

Tani dëgjova nga Milva se janë dhënë 100 milionë lekë për shkencën dhe ka i marrë kërkimi shkencor. Mbi ç'bazë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, është rritur dhe pjesën më të madhe e ka marrë fakulteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Atëherë, Agjencia për Mbështetjen e Kërkimit Shkencor nuk ka filluar të funksionojë. Ku do të gjejnë hapësira për të aplikuar pedagogët?

Zotërinj dekanë, të gjithë ju keni qenë të angazhuar për të fituar projekte, keni trokitur në fondacione të tjera të huaja për të siguruar të ardhura, por mund të jetoni ju me të ardhurat e fondacioneve? Paratë kryesore, me të cilat duhet të funksionojë një institucion i arsimit të lartë, vijnë nga buxheti i shtetit. Për sa kohë që ju tani keni 3 vjet që merrni vetëm grandin e mësimdhënies, thuajeni shqeto: që ju të mbijetoni ose duhet të rrisni tarifat, ose numrin e studentëve. Duke rritur numrin e studentëve, ju keni ulur cilësinë e mësimdhënies. Studentët, në të gjitha debatet televizive, thoshin që ishin 180 studentë në një auditor për 90 studentë. Pse e rritëm ne numrin e studentëve? Këtë kemi bërë të gjithë, në mënyrë që të fitonim pak më shumë para për të mbijetuar. Mendoni se ligji i arsimit të lartë, mënyra se si ai buxheton universitetet, është i keq në këtë drejtim? Ashtu sikundër unë bashkohem me dekanin e Shkencave të Natyrës, a mendoni se ligji i vitit 2007, që rektorin dhe dekanin i cilësonte si drejtuesit më të lartë të universiteteve, ishte më i mirë se ky, që rektorin dhe dekanin i cilëson si drejtuesit më të lartë akademikë të institucionit? Edhe atëherë anën financiare e drejtonte kancelari, por rektori dhe dekani ishin institucionet më të larta. Në Shqipëri nuk mund të drejtohet një institucion me tri koka. Mund të ndodhë në Angli, por eksperiencia shqiptare kërkon që institucionet duhet të drejtohen në mënyrë të centralizuar. Duam apo nuk duam ne, kjo është tradita shqiptare.

Këto janë pyetjet e mia dhe ju falënderoj që erdhët!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Urdhëroni, Floida!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Floida Kërpaçi – Mund të vazhdoj, e nderuar kryetare?

Albana Vokshi – Nuk janë të gjitha pyetjet për të gjithë. Domethënë, i janë adresuar personalisht profesor Dhorit, personalisht juve. Ky ka pyetje të tjera. Do të mundohemi t'i ndajmë edhe përgjigjet, por t'u japim kohën e mjaftueshme edhe kolegëve të tjerë.

Po, Floida, mund të vazhdosh.

Floida Kërpaçi – Përshëndetje, të nderuar profesorë!

Në fakt, bëtë një ekspozitë të qartë të disa problematikave, por të paqartë për gjëra të tjera. Unë dua të adresoj një problem në emër të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe të prindërve të tyre, të cilët na kanë shkruar disa mesazhe gjatë gjithë kësaj kohe. Pa diskutim, ia drejtoj këtë pyetje dekanit të Fakultetit të Drejtësisë.

Studentët e fakultetit tuaj ju kanë denoncuar publikisht, dhe të gjithë e kemi parë, që keni ushtruar presion ndaj tyre për të hapur godinën dhe për të filluar procesin mësimor. Pamjet filmike kanë qenë të qarta, ku ju si drejtues i institucionit, jeni shprehur konkretisht: “Ju,

studentë, keni vënë fytyrën tuaj në mbylljen e kësaj godine dhe emrin tuaj në gjithë këtë proces”. Çfarë është kjo deklaratë dhe si e shpjegoi ju këtë formë presioni të ushtruar ndaj studentëve të fakultetit tuaj? E para.

E dyta, zoti Hoxha, sipas pikës 2, të nenit 82, të ligjit “Për arsimin e lartë” shkruhet: “Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve të barasvlershme me to, mund të konkurrojnë për t’u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues, si dhe juristë në administratën shtetërore qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi.”. Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje? Ata që janë diplomuar dhe që punojnë sot në administratë, çfarë duhet të bëjnë? A duhet të shkarkohen? A do t’u njihet shkollimi i magjistraturës këtyre studentëve, që praktikisht nuk e kanë titullin “jurist” sipas ligjit? Si njohëse e mirë e reformës në drejtësi, a është vënë në rrezik reforma në drejtësi nga moszbatimi i nenit 82 nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Drejtësisë, që nuk e kanë organizuar këtë testim?

Për ta mbyllur fjalën time, këtë takim të sotëm e mendoja nga ana juaj si një takim reflektimi, jo vetëm për të falënderuar studentët, por edhe për t’u kërkuar falje atyre, që pa të drejtë, me të njëjtën gjuhë të Kryeministrit, i keni quajtur zaptues të godinës dhe mbajtës peng të godinës. Ata të gjithë kanë të drejtën e tyre për të protestuar dhe ju vetë keni qenë pjesë e asamblesë së pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë, ku unanimisht i keni mbështetur për formën e protestës që ata kanë zgjedhur. Prandaj, në emër të studentëve, do të doja që të kërkonit falje publike për deklaratat që keni bërë për ta, por edhe për të na shpjeguar këto deklarata, me të cilat u jeni drejtuar studentëve, sepse ju mbani përgjegjësi për të gjithë këtë proces.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Bujar Çela - Për të mos e marrë fjalën dy herë, se është shumë e vështirë...

Albana Vokshi – E ka Vilma fjalën.

Bujar Çela – Për procedurë e kam.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk kam guxim që t’u bëj pyetje profesorëve, sepse ishin shumë shterues në shpjegimet e tyre, por dua t’i falënderoj.

Unë kam frikë se në formatin e komisionit tonë të përhershëm ky nuk është rasti i parë, por sot jemi më të qetë për shkak të lodhjes së djeshme. Unë mendoj se nuk duhet t’i vendosim pedagogët në vështirësi. Ne nuk jemi këtu që t’i pyesim pedagogët se sa janë me

veten, sa janë me studentët, sa janë me ligjin, sa janë me PD-në apo sa me LSI-në, sepse do t'i vendosim në siklet.

Faleminderit!

Albana Vokshi- Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka koment, sepse profesorët nuk janë ndierë asnjëherë në vështirësi.

Vilma Bello – Së pari, i falënderoj të gjithë përfaqësuesit e asamblesë së fakulteteve të Universiteti të Tiranës, dekanët dhe pedagogët, titullarë ose jo, për të gjithë paraqitjen! Një vlerësim maksimal kam për të gjithë punën e tyre dhe për gjithë çfarë ka prodhuar ndër vite Universiteti i Tiranës. Një vlerësim të posaçëm e kam për historinë akademike të Fakultetit të Histori-Filologjisë, në të cilin kam ndjekur, prej 25 vjetësh, të gjithë formimin tim akademik, duke nisur nga viti 1994. Po ashtu, kam një vlerësim shumë legjitim, që i kalon pragjet e Universitetit të Tiranës, edhe për universitetet e rretheve. Gjithashtu, kam një vlerësim maksimal për universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë, i cili në 25 vjet të rrugëtimit të tij, sigurisht, ka prodhuar vlera të jashtëzakonshme jo vetëm për Vlorën, por për të gjithë shoqërinë. Nga ana tjetër, refuzoj të pranoj deklaratën për një gjuhë të padenjë ndaj trupës akademike, sepse të gjithë sa jemi këtu na bashkon një mendim i përbashkët: arsimi universitar ka një interes të jashtëzakonshëm jo vetëm ndaj nesh që jemi këtu, por më së shumti prej të gjithë shoqërisë. Ndaj, nuk do të doja që deklaratimet tona të shërbenin edhe pa dashje, duke vënë në funksion “bombën” për të gjithë sistemin arsimor universitar. Duke iu kthyer asaj që tha zoti Pinari, që të merrnim vëmendje nga zëri studentor, unë do të ndalesha pikërisht te kërkesat e studentëve gjatë protestës së tyre, të cilën, me thënë të drejtën, e vlerësoj si një shkundje të nevojshme dhe të domosdoshme për të gjithë sistemin universitar në të cilën ne këtu jemi pjesë të gjithë, flas edhe si pedagogë. Duke qenë se formimi im akademik ka qenë brenda Fakultetit të Histori-Filologjisë, është edhe më konkrete dhe më normale që pyetjen time t’ia drejtoj kolegut, zotit Agron: a jeni dakord me kërkesën e studentëve për verifikimin e titujve të pedagogëve, të plagjiaturave? Cili është propozimi juaj konkret për këtë? Unë personalisht mendoj se kjo është një kërkesë, që nuk mund të përmbushet nga qeveria, por më së shumti duhet të përmbushet nga institucionet që i kanë prodhuar, sepse plagjiaturat nuk i kanë prodhuar as studentët dhe as qeveritë. A ka ndërhyrë ndonjë qeveri në procedurat e promovimit akademik të pedagogëve? Në gjithë këtë histori të protestës dhe në gjithë këtë situatë të krijuar prej protestës së studentëve, çfarë përgjegjësie mban institucioni i arsimit të lartë?

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, zoti Ismet.

Më pas fjalën e ka zoti Fadil.

Ismet Beqiraj – Unë dua ta nis fjalën time me një shprehje: “Politikanët dhe qeveritarët harrohen shpejt, kurse profesorët nuk harrohen lehtë. Ata e kanë emrin të skalitur në mendjen dhe në shpirtin e atyre që dallojnë dhe promovojnë edhe në faqet e librave”.

Faleminderit profesorë, për qetësinë që i keni kthyer këtij komisioni shumë dinamik, si asnjëherë tjetër, të Kuvendit të Shqipërisë! Nga fillimi deri në fund një gjë më bëri përshtypje: audienca e kolegëve opozitarë nuk është e plotë, por media audiovizive është shtuar.

Në radhë të parë, ju falënderoj për mendimet e vyera, për mesazhet që na dhatë me qetësi dhe për përgjegjësinë që mbani, sepse ne, politikanët, që jemi këtu, edhe pse vijmë një pjesë nga universitetet, na keni ulur me këmbë në tokë, megjithëse me ju ka qenë një leksion i vyer dhe i munguar më parë në institucionet e larta të shtetit. Nga ana tjetër, nuk kam pse të mos ju falënderoj për qetësinë që keni pasur, për menaxhimin e të gjithë kësaj periudhe deri në normalitetin e jetës akademike në Universitetin e Tiranës! Për këtë gjë unë, si pjesë e juaja, ndihem shumë i lumtur.

Gjithashtu, gjëj rastin të falënderoj të gjithë drejtuesit e fakulteteve! Mos ma merrni si konflikt interesi, por dua të falënderoj fakultetin tim, Fakultetin e Shkencave, që, me qetësi dhe me durim, respektoi të drejtat e studentëve për mësim, duke respektuar edhe të drejtën e atyre që protestonin, si dhe ka menaxhuar situatat e intimidimit të studentëve dhe pedagogëve. Ne jemi pothuajse në një emërues të përbashkët dhe sinqerisht më është dukur vetja edhe si në minorancë, ku kam diskutuar edhe brenda grupit tim, pavarësisht egos që kam për t’i prezantuar gjërat pa dorashka, ashtu siç janë, për problemet e arsimit të lartë.

Është ligji i ri i miratuar nr. 80/2015 që na solli në këtë lëvizje të madhe studentore, e cila ishte një mësim edhe për pedagogët. Këtu u tha se janë bërë me mijëra faqe oponencë, por ama pedagogët kanë edhe mjete të tjera demokratike, sikurse këtë mësim që na dhanë studentët. Mund të ishte bërë edhe më pare, edhe në momentet kur është diskutuar po me këtë nerv, me këtë përgjegjësi dhe me këtë forcë. Asgjë nuk është absolute, është relative. Sigurisht, të gjitha këto probleme i nxori vetë implementimi i ligjit të arsimit të lartë. Patjetër, asnjëri nuk e mohon se ka nevojë për ndryshime dhe korrigjime për ta implemetuar më shpejt në kohë, në mënyrë që të jenë më të zbatueshme edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që do të dalin. Këtu u tha edhe nga profesor Kule se në gati 4 vjet përpjekje dhe statusi i Universiteti të Tiranës

doli në dhjetor të vitit 2018, mua kjo nuk më duket korrekte. Më lejoni në vijim të bëj disa pyetje.

Nga profesorët e nderuar ne dëgjuam mendimet, arsyet, problemet, shqetësimet për këtë dualizëm që është krijuar në Universitetin e Tiranës. Si mendoni të zgjidhet kjo gjë? Kjo është me interes edhe në funksion të shërbimit të studentëve, por edhe të mbarëvajtjes së punës, me të gjitha elementet e këtij universiteti të rëndësishëm të Shqipërisë. Në vijim, si konkluzion del: liria akademike, autonomia financiare, administrative dhe e përzgjedhjes së personelit, deri në caktimin e pagave, që jepet në nenin 3 të këtij ligji, a mos ndoshta e ka gjetur të papërgatitur qeverisjen universitare për ta implementuar dhe për të përthithur të gjithë këtë benefit që e jep ky ligj?

Lidhur edhe me disa kërkesa, që në fokus kanë problemet që nxorën studentët, unë dua të bëj disa pyetje, më shumë për të ditur mendimin tuaj, që kanë të bëjnë me cilësinë dhe standardin. Është folur dhe janë diskutuar gjerë e gjatë shumë mekanizma dhe mjete se si mund të bëhen, duke filluar që nga cilësia e studentëve e të tjerë. A është në opsionin tuaj, si një instrument tjetër, reduktimi i pranimeve në universitetet e larta në përputhje me standardet e certifikimit dhe akreditimit? Këtu kam parasysh Fakultetin e Shkencave, ku bëj pjesë edhe vetë, ku kapacitetet janë të pamundura për atë numër studentësh, pavarësisht nëse kuotat finale i miraton qeveria apo propozohen nga fakultetet. Gjithashtu, unë e kuptoj edhe faktin që dyert e fakulteteve hapen për të përballuar nevojat buxhetore, por ka rëndësi qëndrimi dhe vendimmarrja juaj lidhur me rritjen e pragut të pranimit. Madje, edhe në komisionin tonë një pjesë kanë qenë skeptikë nëse do të vinin të rekrutoheshin në degën e mësuesisë, kur u rrit mesatarja në 7 për të dyja ciklet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në ekonominë e tregut jemi dhe do të ketë edhe faliment.

Fenomeni i arsimimit në Shqipëri, pra i diplomave në degë të veçanta dhe nxitja e korrupsionit pasiv, a mund të jenë nxitës për uljen e cilësisë së mësimdhënies dhe të përgjegjësisë që kanë institucionet e arsimit të lartë? A ka ardhur koha që studentët të gjejnë akses në treg dhe diploma Bachelor të marrë statusin e profesioneve të rregulluara me ligj? Nëse mbaron Bachelor-in në Kiminë Industriale Mjedisore, aty ku jam unë dhe profesor Spiro, të gjejmë tregun e punës që t'ia imponojmë edhe tregut.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Të lutem, nuk kam mbaruar. Pyetja tjetër. Një nga shqetësimet e studentëve ka qenë edhe praktika mësimore profesionale. Si mendoni, a duhet ndërhyrë te kurikula për zgjerimin e periudhës mësimore nga 30 në 34 javë?

Albana Vokshi – Po, Fadil.

Fadil Nasufi – Duke pasur privilegjin që në komisionin tonë, në disa seanca, kemi pasur elitën e botës akademike dhe universitare, unë dua të shpreh mirënjohjen për të gjitha gjykimet e vlefshme dhe propozimet që kanë dhënë, duke bërë një debat shumë të vlefshëm dhe të shëndetshëm.

Së dyti, në lidhje me mesazhet që i jepni parlamentit dhe neve, si deputetë, për etikën që duhet të shfaqim në respekt të dijes, ne duhet të jemi gjithmonë me sy dhe me veshë nga ju, sepse ju jeni arkitektët tanë, pavarësisht se ne jemi në mosha të ndryshme, dikush te 60-tat dhe dikush më të rinj, por të gjithë jemi produkt i auditoreve universitare. Për këtë po them një shprehjeje: “Gjeneracioni për gjithçka buron nga dija”, pra faleminderit për emancipimin që i jepni politikës, për largimin e gjuhës që përdorim ne vend dhe pavend, duke u dominuar nga emocioni apo nga pasioni.

Së treti, vë re që një pjesë e nderuar e deputetëve pedagogë që janë këtu, duket sikur po i ngrenë problemet e universitetit tani që janë deputetë, ndërkohë që duhet të kishin qenë promotorë të jetës akademike universitare si pedagogë dhe si ish-pedagogë në ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të lutem, Fadil, të mos bëjmë replika, se nuk kemi kohë.

Fadil Nasufi – Për të dalë në problematikat e ligjit, unë shikoj që nuk janë problematika që kanë filluar në vitin 2015, kur ka filluar implementimi i ligjit të arsimit të lartë. I gjithë ky transformim që ka ndodhur gjatë tranzicionit, ka nevojë që me gjithë rekomandimet e kolegëve të bëhen operacionet e duhura që të jetë një ligj funksional dhe jeta universitare të jetë e konkurrueshme dhe në stadet që kërkon edukimi dhe arsimimi i brezit të ri.

Pyetja që kam është kjo: a marrin pjesë universitetet në programet që ka qeveria për problemet që lidhen me politikat kryesore, si me çështjet urbane, me çështjet e ujësjellësve, me çështjet e shërbimit publik dhe në bashkëpunimet me bashkitë?

Unë kam qenë kryetar bashkie dhe kam tentuar të lidhesha me fakultete për projekte, sepse mungojnë kapacitetet reale të administratës publike për të bërë projekte bashkëkohore dhe konkurruese, të cilat të ishin në funksion të përfitueshmërive financiare që rrjedhin nga të ardhurat që sigurojnë sipas ligjit të arsimit të lartë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Edhe unë kam disa pyetje, por po i reduktoj. Meqenëse kolegët e mi harruan, kam një pyetje të drejtpërdrejtë: “Pakti për universitetin” a i zgjidh problemet e studentëve? A i zgjidh problemet e universiteteve? A është antiligjor? A është antikushtetues?

VKM-të që ju përmendët, a janë antikushtetuese, sepse dje patëm edhe një oponencë nga një koleg juaji?

Dua ta pyes profesor Hoxhën: a i shikoni ju si antikushtetuese dhe antiligjore? Nëse janë, cili është hapi tjetër?

Pyetja tjetër: cili është qëndrimi i titullarëve të fakulteteve ndaj dhunës së policisë brenda ambienteve, sepse unë nuk kam dëgjuar një deklaratë nga ana juaj për këtë pjesë?

E fundit edhe për ata që e shohin gotën plot, por edhe për ata që e shohin gotën bosh, cila është zgjidhja?

Agron Gjekmarkaj – A mund të flas tani, sepse kam një angazhim dhe më duhet të iki?

Dua të falënderoj deputetin Nasufi, të cilit ia çmoj mendimin dhe jam pothuajse dakord me fjalët që tha, por edhe deputeten, e cila kishte dalë nga fakulteti ynë, për fjalët e mira që tha për Fakultetin e Histori-Filologjisë, sepse mendoj që i meritojmë. Duke lënë modestinë mënjanë, fakti që shumë deputetë vijnë nga ai fakultet, është një shenjë, një tregues.

Po u përgjigjem pyetjeve. Unë dënoj me forcë dhe me indinjatë çdo akt plagjiature dhe çdo titull akademik të marrë në mënyrë të paligjshme. Nëse do të na bënit një kërkesë zyrtare për të hapur një proces për modifikimin e ligjit të arsimit të lartë, ju siguroj që ekspertiza jonë nuk do të jetë zhgënjyese. Për plagjiaturat, do të doja që politika të jepte shembullin e saj, pra, kur keni deputetë me plagjiatura, të mbani të paktën qëndrim publik, mediatik, etik, gjë që nuk e keni bërë. Nuk dua të akuzoj asnjëri, por të paktën të verifikoni nëse janë të vërteta apo jo akuzat, përpara se ato t’ia adresoni botës akademike.

Jam kundër çdo forme të revolucionit kulturor kinez, që ato t’i gjykojë masa dhe zyrtarët politikë. Po e theksoj edhe një herë, nëse na kërkon zyrtarisht që të bëhemi pjesë e propozimit, ne do t’jua sjellim propozimin.

Për sa u përket VKM-ve, ata realisht e kundërshtojnë ligjin aktual, pra vetë qeveria e ka sulmuar ligjin me anë të këtyre VKM-ve, sepse cenojnë thelbin e ligjit, por edhe autonominë universitare. Senati i Universitetit të Tiranës ka bërë një ekspertizë perfekte dhe është shprehur qartë për këtë; përgjigja është me dy tituj “Zgjidhja e problemit” dhe “Rezoluta e senatit”.

E fundit, për pyetjen se cila do të ishte zgjidhja, unë bëj pjesë tek ata persona që nuk beson që njëra parti e do më shumë Shqipërinë dhe tjetra më pak. Ne jemi shqiptarë dhe kemi karakteristika të përbashkëta. E vërteta qëndron në mes dhe grupi i pedagogëve, përtej divergjencave që kanë, konvergojnë te progresi i universitetit, në rolin që duhet të ketë në shoqëri. Unë zgjidhjen nuk e shoh te propaganda. Në propozimin politik mendoj se mund të ketë edhe gjëra të dobishme, por nuk i zgjidhin problemet e universitetit. Mendoj që duhet një

pakt kombëtar mes partive dhe faktorëve, sepse ligji i arsimit të lartë nuk është një ligj për bletërritës, për bujq apo peshkatarë, por është një ligj për studentë dhe profesorë, të cilët po e kundërshtojnë masivisht.

Unë mendoj që të hapet një process, ku të bëhemi pjesë edhe ne, dhe besoj që do të kemi një ligj, i cili do të pranohet nga palët dhe do të gjendet zgjidhja e arsimit publik në Shqipëri.

Ju kërkoj ndjesë që duhet të largohem.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Dhori Kule – Ju falënderoj!

Unë do të përpiqem që të mos humbas shumë kohë. Fillimisht po bëj një komet duke mirëkuptuar qëndrimet, sepse këtu ka deputetë të krahëve të ndryshëm politikë. Në Fakultetin Ekonomik, ku përgatisim ekonomistët, po ju marr një rast me dy studentë me mesatare 10, bëjnë të njëjtin program, për shembull, për problemin e pagave. Kur mbarojnë studimet, njëri shkon ekonomist i qeverisë dhe tjetri i sindikatave, të njëjtin fenomen e kanë mësuar njësoj në auditor me kurikulat tona, por qëndrimet i mbajnë të ndryshme. Pra, e kuptoj situatën tuaj, nuk mund të ishte ndryshe, sepse është vetë qëndrimi, vizioni dhe vështrimi i situatave.

Duke u kthyer te përgjigjja e pyetjeve, e para lidhej me mandatet.

Të nderuar deputetë, për sa u përket mandateve, nga ju nuk kam dëgjuar të kërkonte kufizime mandatesh për deputetët dhe nuk ka asgjë të keqe, sepse në të gjitha fushat ku konkurohet dhe votohet, mandati i parë është mandati i premtimeve, i dyti është mandati i verifikimit, nëse janë realizuar premtimet apo jo, por, po e more të tretin, është akoma më mirë.

Në Amerike ka universitete që, pasi ke marrë dy mandate i zgjedhur si shef departamenti, dekan dhe rektor, të thonë rri i përjetshëm deri sa të dalësh në pension. Pra, verifikimi është cilësia.

Nëse ndonjëri ka merak për të verifikuar mandatin e ndonjërit në strukturat universitare dhe është i shqetësuar, le të verifikojë situatën nëse ka pasur sukses në drejtimin e tij apo jo. Pra, nëse e ke me mua, po të them që Dhori Kule ka qenë i suksesshëm në të gjitha pozicionet që ka drejtuar, si dekan, si rektor, si dekan përsëri dhe kështu do të jem deri sa të më votojnë ata që më besojnë, duke mirëkuptuar pyetjen që nuk e kishe për mua. E para.

E dyta, (*mungesë incizimi*)... administrator, nuk ka dualitet. Të nderuar deputetë, që ta kuptoni këtë, do t'ju sugjeroja të lexoni materialin 110 faqe të kontrollit që ka bërë Ministria e Arsimit dhe aty e gjeni menjëherë se ku është e keqja.

Po të bjerë një shkëmb në lumenjtë malorë apo në çdo lum dhe të pengojë rrjedhën e lumit, lumi do të dalë nga shtrati dhe do të përmytë fusha dhe ara. Kështu edhe ligji e ka të zgjidhur, në momentin që ka paligjshmëri, ka zgjidhje, dhe nuk bëhen zgjidhjet duke kërkuar dorëheqjen, sepse ligji i ka të gjitha zgjidhjet ligjore. Nëse diku është shkelur ligji, aty është e parashikuar se si zgjidhet problemi.

Në Universitetin e Tiranës nuk ka dualitet, por ka kompetenca të ndara. Ka pasur edhe më parë, siç thotë zonja Duka, kancelar dhe këshill administrimi, por eksperiencia e të gjitha vendeve të botës i ka eksplicite këto. Unë, kur kam qenë rektor, kisha kompetenca të firmosja tendera, por në mandatin e dytë nuk kam firmosur asgjë, sepse ia delegoja kancelarit, megjithëse ligji ma kërkonte ta firmosja unë. Nuk ka punë rektori dhe dekani në firmosje tenderash dhe nënshkrim kontratash, sikurse është verifikuar tani, kur ligji e ka penguar. E ka penguar ligji, por çfarë duhet të themi ne, të akuzojmë ligjin për paligjshmëri?! Po t'i shikojmë, aty janë katër kontrata të firmosura. Përse duhet t'i bëjmë presion ligjit, kur ai të thotë: "këtë duhet ta firmosë filani", pra nuk ka dualitet dhe secili duhet të kryejë kompetencat e veta.

Kompetenca më e rëndësishme është ajo akademike dhe kjo është e qartë, universiteti është institucion akademik dhe e gjithë pjesa administrative financiare është në shërbim të linjës akademike, por jo ta bëj unë, është më mirë të kërkosh llogari sesa të japësh. Në këtë pikë ligji është bërë perëndimor.

Unë kam qenë drejtues gjatë gjithë kohës dhe e di shumë mirë çdo qelizë të funksionimit të universitetit ku cenohet dhe ku jo. Këtë nuk e kanë universitetet e tjera. Pse? Sepse ka respektuar ligjin dhe secili ka bërë punën e vet. Pra, në momentin që ti e shkel ligjin dhe bën presion që fajin e ka ligji, kjo është e gabuar, sepse fajin nuk e ka ligji, por moszbatimi i tij. Pra, nuk ka dualitet.

Cila është zgjidhja? Zgjidhja është respektimi i ligjit, pra është e thjeshtë. Shikojeni materialin, se është shumë e qartë se çfarë duhet bërë. Aty janë edhe rekomandimet e Ministrisë së Arsimit, të cilat janë verifikuar nga pesë ekspertë, pra për të gjitha problematikat që janë ngërçe vetëm në Universitetin e Tiranës, të cilat vijnë nga mosrespektimi i ligjit dhe jo nga ligji.

Ligji ka një fenomen që është ndryshe nga Kushtetuta, statuti nuk ka përse të lihet në ligj, që ta miratojë Ministria e Arsimit. Jo, është kompetencë jona e drejtpërdrejtë.

Për problemet që u shfaqën, këtu, si doktoratura dhe titujt, nuk na e ka fajin ligji. Përpara një muaji është miratuar statute. Kush merr vesh nga këto punë të thotë çfarë na ka penguar ne për doktoraturën. Vetvetja. Nëse do të ishte miratuar statuti, do të kishin filluar procedurat e doktoraturave në çdo departament. Kujt t'ia hedhim fajin, vetes sonë? Që nga

janari i vitit 2017 është ngritur grupi i punës për të bërë statutin dhe ne e kemi pas dy vjetësh statutin e miratuar. Pra, të mos dish ta administrosh autonominë e brendshme, sepse shkel ligjin!

U bë një pyetje këtu nëse qeverisja universitare është e dobët. Të jeni të sigurtë se qeverisja në universitete është më e mirë se çdo lloj qeverisjeje, madje edhe ai më i dobëti, qeverisjen e ka absolutisht të mirë dhe nuk ka defekte. Universitetet kanë ekipe drejtuese elitare. Ne furnizojmë të gjitha strukturat, jo më të mos administrojmë veten tonë. Të jeni të qetë për këtë. Ligji vetë ka parashikuar si zgjidhen problematika e respektimit të tij, nëse shkelet ligji në një strukturë.

Kam dëgjuar këto ditë që vihet në diskutim masivizimi. Edhe një herë e përsëris, ky problem është parimor, nuk është vetëm problem i arsimit të lartë shqiptar, por ka dy-tri dekada që është problem europian; nuk e shpikëm ne, e shpiku vetë zhvillimi ekonomiko-shoqëror, i cili në kushtet e globalizmit kërkon masivizim, sepse faktori human ka dalë tani prioritet. Në historinë e vet shoqëria ka pasur momente të caktuara si prioritare çështjen e kapitalit ose pronën, por tani është faktori human. Masivizimi është domosdoshmëri. Masivizimin është më mirë ta përballojnë institucionet ku fabrika punon, sesa të hapësh universitete që japin diploma kot.

Unë e kam bërë një test në Fakultetin Ekonomik me *part-time*-n. E kemi hapur atëherë masivisht, 750 vetë u regjistruan dhe 34 e mbaruan. Ky është masivizim, por masivizim në hyrje dhe jo në dalje. Shikoni strukturat e tjera, hyjnë 100, dalin 150. Prandaj nuk është faji i masivizimit. Standardet e arsimit kërkojnë industri të saktë dhe këtu Universiteti i Tiranës duhet ruajtur, sepse është pasuri që nuk këmbëhet dot me askënd.

Po shikojmë një dukuri sot, ngrihen studentët e universiteteve publike të kundërshtojnë tarifat, që i kanë 10 herë më të ulta se universitet private. Thonë se në universitet private është qetësi. Atëherë, po iu them qytetarëve, t'i zhdukim universitetet shtetërore dhe të mbajmë privatet. Pra, kjo është një retorikë që e ka brenda çfarë po ndodh, prandaj të nderuar deputetë, masivizimi absolutisht nuk duhet penguar, duhet stimuluar, sidomos në degët që janë me cikël të mbyllur, duhen dhënë diploma, pra një çelës që hap shumë dyer. Diplomat tona duhet të jenë të tilla që ai studenti të bëjë shkollën, por të mos e gjejë derën mbyllur atje ku ka marrë diplomën, pra t'i hapen dyert.

Ka probleme mësuesia. Ne kemi ende në tregun e punës mësues të papunë, kur sot nuk ka një vend përëndimor me ekonomi tregu të stabilizuar, që ka mësues të papunë. Ditën që mbarojnë studimet në Itali, kanë vendin e punës të sigurtë.

Atëherë çfarë duhet të bëjmë? Duhet të bëjmë diploma më të integruara, që ai që bën mësuesinë, të ketë edhe një diplomë tjetër. Unë kam filluar me fakultete e ekonomisë të universiteteve publike një projekt për të ndihmuar njëri-tjetrin. Pra, ne kemi nevojë të mbështesim njëri-tjetrin. Nëse Elbasani në Fakultetin e Ekonomisë mund të hapë një degë bashkë me ne, është shumë më mirë dhe studentët të mos ikin nga Elbasani dhe të vijnë në Tiranë, por të qëndrojnë në Elbasan, studentët e mirë.

Pra, hapësira ka sa të duash, nuk të pengon ligji i arsimit të lartë për këtë punë. Po ju them me përgjegjësi, sepse e njoh mirë, dualiteti është moszbatim ligji. Do t'ju vë në dispozicion raportin e ministrisë, ku do të gjeni përgjigjen e pyetjes. Ky ligj ka një kapitull 12, nëse do të ishte bërë funksional, ne sot, lodhemi kot, nuk do të kishte universitete publike. Sikurse ka pasur një trend në ligjin e vjetër për të futur teorinë e kupolave, modeli kilian. Fatmirësisht u anulua. Ky është potencial, nuk është bërë i rrezikshëm ky kapitull. Po ju them me përgjegjësi, ditën kur të krijohen fondacione publike, universitete publike të pavarura, nuk do të ketë më universitete publike dhe e mira publike kthehet në të mirë private, dhe ky do të ishte fundi i arsimit publik, por kam bindjen se ne e kemi të qartë, ju do të na ndihmoni që universiteteve asnjëherë të mos iu cenohet ky mision që kanë ndaj shoqërisë.

Në lidhje me pyetjen e zonjës Vali, për rikonstruksionet në atë kohë dhe në këtë kohë, po ju them se kam qenë unë rektor dhe të gjitha rikonstruksionet e Universitetit të Tiranës janë bërë me të ardhurat tona, asgjë nga buxheti.

Valentina Duka – Kishit më shumë të ardhura, apo jo?

Dhori Kule – Po, por janë bërë me tarifat e studentëve, sepse buxhetimi ka qenë në këtë nivel dhe besoj se kjo situatë do të na shtojë buxhetin për periudhat e tjera. Po ju jap një shembull, universiteti i Lubjanës e ka 310 milionë euro.

Këto kisha unë, të nderuar kolegë.

Valentina Duka- Do të bëj një sqarim për çështjen e doktoratave.

Unë nuk besoj se çështja e doktoratave në Universitetin e Tiranës ka qenë çështje statuti, sepse, po të shohësh ligjin, një student doktorant që të vijë duhet të jetë student yni, së pari, pra duhet të jetë student i brendshëm i departamentit. Në fakt, ne nuk kemi kaq kapacitete sa për të pasur studentë të brendshëm, për ta pasur student doktorant.

Së dyti, pa filluar të funksionojë Agjencia e Financimit të Universiteteve, ku studenti duhet të marrë bursën e ta sjellë në fakultet, nuk mund të hapet shkolla e doktoraturës.

Albana Vokshi– Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – Unë, së pari, dua t'ju falënderoj për mënyrën e komunikimit dhe mirëkuptimit që tregojmë për mendimin e gjithsecilit.

Unë do të doja t'i jepja një përgjigje të drejtpërdrejtë pyetjes që bëri zoti Gurakuqi, nëse duhet rritur financimi nga buxheti i shtetit për institucionet e arsimit të lartë. Po, sipas mendimit tim patjetër duhet rritur. Nuk ka qenë asnjëherë i mjaftueshëm, nuk është as sot i mjaftueshëm. Ligji i vitit 2007, 2008 dhe ai që do të vijë nesër, u jep mundësi universiteteve t'i gjenerojnë të ardhurat vetë. Nëse ne nuk e kemi këtë kapacitet, vdesim. Ne shikojmë ose studentët, ose buxhetin e shtetit. Nuk është ky universiteti që zhvillon kërkimin shkencor. Kërkimi shkencor duhet të sjellë kontribute, të sjellë të ardhura, kështu veprojnë të gjitha institucionet e arsimit të lartë në botën e qytetëruar, nuk vegjetojnë. Nëse ajo që kërkon, nuk sjell produkt, është një kërkim që thjesht e lejon universitetin të funksionojë, por jo ashtu siç duhet. Një nga problemet që kanë pasur institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, është kërkimi shkencor. Ne kemi shumë doktorantë, kemi profesorë sa të duash, por kërkim shkencor të mirëfilltë nuk kemi në nivelin e titujve dhe gradave që kemi shpërndarë. Ky është realitet dhe një shqetësim që studenti e sheh në auditor, e sheh sa i aftë është profesori që ka përpara, çfarë komunikimi ka pedagogu me studentin, çfarë dijes i jep ose është një pedagog që hap librin dhe lexon atë që është shkruar, apo atë që kanë shkruar të tjerët. Kemi nga këta pedagogë, keni pasur edhe ju këtu një... Institucionet e arsimit të lartë duhet të kenë mundësi të gjenerojnë të ardhura vetë. Ky legjislacion ia lë këtë mundësi, madje ndryshe nga institucionet e pavarura, ligji për arsimin e lartë lejon që 90% e të ardhurave t'i administrojmë vetë, ndryshe nga legjislacionet e tjera që lidhen me buxhetin e shtetit. Në fakt, kur nuk realizohet në vitin buxhetor, nuk digjet, siç ju digjet edhe juve që jeni në Kuvend, ose qeverisë, ose gjykatave, vetëm institucioneve të arsimit të lartë iu shkojnë nga njëri vit në tjetrin. Ne, institucionet e arsimit të lartë i kemi paratë. Ne institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjenerimit që kemi pasur jo nga buxheti i shtetit. Buxheti i shtetit të jep fondin, të cilin ti e ndan. Pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe të gjitha të tjera ne i kemi bërë me të ardhurat dytësore. Ne si fakultet sot kemi disa milionë lekë ose euro, të cilat janë në arkën e Fakultetit të Drejtësisë. Ajo që ka ndodhur në vite edhe me investimet, edhe me funksionimet e tjera, edhe me kërkimin shkencor është se i kemi paguar. Mbrojtja e një doktore është kërkim shkencor, një search, që bën në një situatë të caktuar, është një kërkim shkencor, një *work chop* është një kërkim shkencor, konferencat kombëtare, ndërkombëtare janë pjesë e kërkimit shkencor, të gjitha këto janë të paguara në Universitetin e Tiranës, nuk janë zë që hyjnë te mësimdhënia, janë zë të kërkimit shkencor, pagesat e të cilëve kanë dalë nga buxheti i të ardhurave dytësore, ose financimeve të tjera që kemi marrë. Por, për shembull, Ekonomiku është më i avancuar këtu, gjen sponsor, gjen grupe interesi që shoqërojnë një aktivitet, pra e kanë pak më të lehtë në

raport me fakultetet e tjera. Por qeveria dhe shteti duhet të ketë më shumë vëmendje ndaj arsimit të lartë.

Kjo situatë na tregoi se ne i kemi nënvlerësuar studentët tanë, po e them hapur, ne nuk i kemi parë studentët tanë, të cilët janë me mendje të hapur, të drejtpërdrejtë, kanë akumuluar problematika, të cilat na i pasqyruan një ditë të caktuar në ballëpërballë. Janë këta studentë që treguan përgjegjshmëri maksimale për ta çuar më tej arsimin e lartë, në një nivel më të lartë se ky që ka deri sot.

Ka një problem të madh në Shqipëri me arsimin e lartë, por që është kudo. Unë kam eksperiencë në shumë fusha të së drejtës, ma tha këtë edhe zonja deputete, dhe nga eksperiencia ime është se ka ligje, por problemi më i madh është t'i kuptojmë ligjet dhe t'i zbatojmë ato. Ne nuk na rri mirë ligji, duket sikur na fusin në një këmishë force, sepse duam më shumë pushtet sesa na jep ligji. Ne jemi krenarë për atë që ofrojmë dhe që i dimë defektet tona, por ne nuk jemi mësuar të zbatojmë ligjin. Në fakt, gjëja e parë që themi është se ligji nuk bën, gjëja e dytë nuk e ndjekim, gjëja e tretë që bëjmë pastaj është që themi se fajin e ka ligji.

Ajo që ka ndodhur në Universitetin e Tiranës nuk është faji i ligjit, nuk është fare dualizëm, dhe nuk ka të bëjë fare me konceptin e ndarjes së funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, por ka të bëjë tipikisht me atë që ligji, as nuk është lexuar, as nuk është kuptuar dhe, në rastin më të keq, është shkelur me dashje. Nëse ligji thotë që ky është funksioni i tij, është funksioni i tij; nëse ligji thotë që funksioni është i këtij tjetrit, atëherë është i këtij tjetrit. Pse duhet t'i të marrësh funksionet e tjetërkujt?! Ky është problemi në Universitetin e Tiranës dhe këto janë konkluzionet, të cilat i kanë nxjerrë institucionet që janë jashtë nesh. Përpara se t'i nxirrnin institucionet jashtë nesh, ne i kemi konstatuar vetë; zysh Vali ka qenë pjesë e diskutimeve të forta që kemi pasur në rektorat. A e dini ju se sa herë është mbledhur rektorati i universitetit në këtë periudhë kaq të vështirë për universitetin? Një herë, ndërkohë që ne kishim marrë vendim që duhej të mbledheshim çdo javë. Sa mbledhje senati kemi bërë? Shumë pak. Pra, edhe pse situata e krijuar kishte shumë problematika, ne vetë u ndiem disi të papërgatitur.

Zysh Vali bëri një pyetje. Cila është arsyeja kryesore që studentët që dolën në protestë: ligji, korrupsioni apo veprimtaria drejtuese në institucionet e arsimit të lartë? Unë do t'ju thosha se studentët dolën në protestë, sepse kërkonin kushte më të mira të trajtimit financiar, ashtu edhe për mundësitë që ata duhet të marrin nga universiteti, standarde më të larta cilësie, një diplomë që t'u vlejë më shumë sesa u vlen sot dhe që nesër në tregun e punës të jenë më të aksesueshëm dhe të kenë mundësi që atë dije që kanë marrë nëpër universitete, ta realizojnë. Por, nëse është ligji, nëse është korrupsion, nëse jemi ne, të gjithë ne jemi nga pak, të tërë kemi

pjesë në gjithë këtë, edhe nëse dikush thotë që ne jemi të mirët dhe të tjerët janë të këqij, të tërë janë gabim.

Sipas mendimit tim, zysh Vali, të tërë nga pak kemi hakun dhe përgjegjësinë tonë për t'ia kthyer universitetit dhe studentëve, të cilët me këtë lëvizje na treguan se sa të përgjegjshëm janë dhe se sa garant do të jetë shoqëria shqiptare nesër me këtë brez që po rritet. Ne i kemi akuzuar shpesh se nuk do të jenë të aftë ta marrin Shqipërinë e nesërme. E keni gabim! Janë shumë të aftë ta marrin, i kam parë vetë ballë për ballë. Më parë i shihja nga auditorët, ndërsa tani i kam parë në planin personal.

Lidhur me ushtrimin e presionit ndaj studentëve nga dekani i Fakultetit të Drejtësisë, kisha një pyetje të drejtpërdrejtë. Në fakt, nuk më erdhi mirë edhe për frymën e diskutimit, por nuk prekem fare për të vetmen arsye se jo vetëm që nuk kam ushtruar asnjë presion ndaj studentëve të mi, por nëse studentët kanë qenë më komodë për t'i realizuar të gjitha të drejtat dhe kërkesat që ata kishin, kjo ka ndodhur me studentët e Fakultetit të Drejtësisë.

Ajo copë video që ka dalë, duhet të jetë më shumë se sa aq, për të treguar një situatë që nuk lidhet fare me momentin. Në fakt, nuk është një takim imi me studentët e ngujuar, por është takimi me studentët që donin të hynin në mësim. Po ju them edhe një fakt, e keni shumë të mundur ta verifikoni, se ka pasur edhe studentë të organizuar për ta verifikuar. Menjëherë pas daljes së asaj videoje, studentët e ngujuar më dërguan një përfaqësi dhe më thanë: “Profesor, ne ju kërkojmë ndjesë, por nuk është video jona, as nuk e kemi pasur dhe as nuk e kemi këtë presion nga ana juaj”.

Nëse më lejoni, po ju them edhe një batutë të vogël. Para se të dilnin, studentët më kerkuan një takim dhe më thanë: “Profesor, ne duam të vëmë disa kushte dhe duam të dalim”. Unë u thashë: “Po të më vini kushte për t'iu përmirësuar kushtet e qëndrimit, jua pranoj, por të më vini kushte për të dale, jini pak më të kujdesshëm”. Kjo ishte një lloj batute me ta, sepse ata jo vetëm që nuk u penguan, nuk u shantazhuan, por ne u kemi lejuar edhe paligjshmëri. Për këtë unë mbaj përgjegjësi, gjë që e kam ndarë edhe me senatin akademik. Në ambientet e senatit akademik nuk kanë qenë vetëm ata studentë që i përkasin Fakultetit të Drejtësisë, por kanë qenë studentë, të cilët nuk janë fare pjesë e këtij fakulteti, por të fakulteteve dhe universiteteve të tjera, si edhe persona që nuk kanë qenë fare studentë. Nga kjo pikëpamje, ne kemi qenë në fijen e rrezikut të një problematike shumë të madhe, që mund të ndodhte në Fakultetin e Drejtësisë, sepse kanë qenë të pranishëm persona të paditur, të panjohur dhe po e them këtu, përpara komisionit, pushtues të një institucioni të arsimit të lartë, të cilëve nuk u takonte të ishin në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Kjo ka qenë arsyeja që Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të fundit u ka kërkuar studentëve dhe jostudentëve, që mbanin të bllokuar auditoret e Fakultetit të Drejtësisë, t'i lironin ato në mënyrë të menjëhershme, duke e konsideruar këtë edhe si një nevojë për mbrojtjen e institucionit. Në katin e parë ne kishim gjithë dokumentacionin e Fakultetit të Drejtësisë, i cili nëse do të dëmtohej, do të sillte jo problematika për një protestë, por problematika reale më shumë sesa një protestë. Fati ynë i mirë, por edhe merita e studentëve tanë që arritën ta mbronin institucionin, duke realizuar edhe kërkesat që ata kishin.

Albana Vokshi – Ju lutem, pak më shkurt, se jeni në limitet kohore!

(Diskutime pa mikrofon)

Mua më duhet të iki dhe ju mund të vazhdoni, por në të njëjtën kohë dua të qëndroj deri në fund për respekt.

Artan Hoxha – Do t'i lë pa diskutuar çështjet e tjera, por dua t'ju jap vetëm një përgjigje për nenin 82 të ligjit “Për arsimin e lartë” dhe cili është qëndrimi i dekanit të Fakultetit të Drejtësisë.

Neni 82, paragrafët 2 dhe 3, nuk kanë qenë në projektin e propozuar nga Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë, por janë futur nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky nen bën fjalë për provimin e shtetit për studentët që përfundojnë Fakultetin e Drejtësisë. Janë bërë disa tavolina, njëra prej tyre në këtë sallë, ku është bërë edhe një diskutim parlamentar. Unë së bashku me përfaqësues të Fakultetit të Drejtësisë kemi ardhur dhe kemi shprehur qëndrimin tonë, duke qenë kundër këtij rregullimi ligjor. Ky është një rregullim ligjor, të cilin e ka Gjermania, por Gjermania e ka shumë më ndryshe sesa propozohet në korpusin tonë ligjor. Në Gjermani provimi i shtetit është fundi i arsimimit në atë fushë që kërkon provimi i shtetit. Kjo do të thotë se nëse ti i ke kaluar dy provimet e shtetit, të cilat janë me një diferencë 2-vjeçare, nuk bën më as shkollë avokatie, as shkollë noterie, as shkollë magjistrature, as administratë publike, por je i gatshëm për tregun e punës. Ky është modeli gjerman.

Ne morëm modelin gjerman dhe tani kemi edhe shkollë magjistrature, edhe shkollë noterie, pasi tani së fundmi keni kaluar edhe disa projektligje, por studentëve tanë u duhet më shumë punë, kohë dhe vite për të dalë në tregun e punës.

Sa i përket shqetësimit nëse quhen juristë apo jo ata që përfundojnë Fakultetin e Drejtësisë, absolutisht quhen juristë. Quhen juristë të gjitha ata që kanë një diplomë *bachelor*-i, të masterit të shkencave apo të masterit profesional. Po ta shohësh të gjithë korpusin ligjor, kudo ku kërkohet për t'u pranuar në punësim, thuhet se cilat janë kriteret, të ketë mbaruar së paku arsimimin *bachelor*, sipas vendit të punës; në qoftë se kërkon të shkojë në magjistraturë, duhet të jetë së paku me master shkencash, në administratë publike ishte me master shkencash,

por Fakulteti i Drejtësisë, për informimin tuaj, para një viti i ka kërkuar Këshillit të Ministrave që masteri profesional me 120 kredite të bëjë të mundur pranimin në administratën publike të këtyre studentëve që nuk kanë masterin e shkencave. Një nga vendimet e fundit të qeverisë ose vendimi i parë në kuadrin e mbështetjes së kërkesave të studentëve është që qeveria ka bërë një amendim në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për Administratën Publike, ku parashikon që ata që përfundojnë masterin profesional me 120 kredite, mund të konkurrojnë për administratën publike...

Albana Vokshi – Kjo është shkelje e ligjit “Për nëpunësin civil”...

Artan Hoxha – Unë e nuk di, por di vetëm një gjë që për nëpunësit civil kjo...

Albana Vokshi - ... sepse duhen kritere, eksperiencia e shumë gjëra të tjera...

Artan Hoxha – Jo, nuk ka të bëjë me atë, ka të bëjë vetëm me shkollimin dhe këtë nuk e përcakton ligji “Për nëpunësin civil”, por e përcakton edhe VKM-ja.

A doni t’ju jap përgjigje për pyetjet që më keni bërë?

Albana Vokshi – Keni 1 minutë në dispozicion, sepse kolegëve të tjerë, nuk ua kam dhënë ende fjalën..

Artan Hoxha – “Pakti për universitetin” a e zgjidh problematikën e universiteteve?

Jo, pakti për universitetin është një skelet, i cili mbushet nëpërmjet këtyre takimeve dhe nuk është më i qeverisë, është i shtetit, nëpërmjet mendimeve të universiteteve. Projektin që ne kemi si universitet, ia kemi shpërndarë çdo pedagogu në *e-mail*, në adresën personale dhe presim të marrim mendimet e tyre dhe t’u kthejmë përgjigje.

A janë VKM-të antikushtetuese? Ne kemi një qëndrim të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, i cili vlerëson kontributin e madh që ka dhënë Fakulteti i Drejtësisë. Ne i kemi vlerësuar të gjitha aktet që kanë dalë deri tani dhe kemi arritur në dy konkluzione. Konkluzioni i parë është që një pjesë e akteve prekin autonominë dhe lirinë akademike, dhe për këtë arsye kemi kërkuar rishikimin e tyre. Një pjesë tjetër e akteve është në përputhje me trendin e përmirësimit të situatës në institucionet e arsimit të lartë dhe në realizimin e kërkesave të studentëve. Është një qëndrim, i cili është lehtësisht i askesueshëm, ndaj dhunës policore në ambientet universitare. Ligji “Për arsimin e lartë”, statuti i Universitetit të Tiranës nuk lejojnë, në kuadrin e mbrojtjes së institucioneve të arsimit të lartë, përfshirjen ose hyrjen në këto institucione të Policisë së Shtetit, aq më tepër ushtrimin e dhunës në institucionet e arsimit të lartë.

Unë përgjigjem për fakultetin që drejtoj dhe me aq sa unë jam në dijeni në Fakultetin e Drejtësisë, nuk e kemi pasur një situatë të tillë. Pra, në qoftë se do të kishim pasur një situatë të tillë, ne do ta kishim dënuar jo vetëm si dekanat, por edhe si asamble e personelit akademik.

Ne i kemi bërë të gjitha mbledhjet me asamblenë dhe për një situatë që nuk e kemi pasur, nuk kemi arsye pse të mbajmë qëndrim për të. Parimisht, është shkelje e autonomisë dhe nuk lejohet të bëhet një gjë e tillë në institucione. Cila është zgjidhja? Këtu u dhanë përgjigje të ndryshme, sepse kjo është një veprimtari e përbashkët, por në qoftë se ne do ta shohim njëri-tjetrin si kundërshtarë apo sikur kemi interesa të ndryshme, dua t'ju them vetëm diçka, studentët në universitet vijnë të studiojnë dhe ne kemi detyrën, ne që jemi të pranishëm këtu në këtë komision, por kërkohet edhe ndihma juaj, t'u bëjmë të mundur realizimin e studimeve në universitet dhe brenda tyre ata kërkojnë të drejtat e tyre, dhe na mobilizojnë ne, ju, por arsimi është i shenjtë. Nëse shkollën do ta kthejmë në një vend konflikti dhe pengese, atëherë ky nuk është misioni i arsimit të lartë. Fakulteti i Drejtësisë e tregoi misionin në momentin që iu dha mundësia për të shprehur vullnet, ku studentët iu drejtuan masivisht bankave, dy vetë në një bankë dhe askush nuk iku nga mësimi.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Unë vetë e kam konsideruar këtë zgjidhje si antiligjore, sepse shkelte nenin 32 të ligjit “Për arsimin parauniversitar”.

Gjithsesi, kjo nuk është...

Nora Malaj – Ashtu siç nuk mund të themi thjesht vetëm për saktësim, që studentët ishin uzurpatorët e mjedisit, sepse ata janë...

Artan Hoxha - Ju lutem, kam të gjithë mirëkuptimin për çfarëdo gjëje që mund të thoni, por, nëse më vini në gojë atë që nuk është...unë u kam thënë studentëve, i keni studentët e mi atje dhe mund t'i pyesni kur të doni, nuk ka studentë të Fakultetit të Drejtësisë që të ketë marrë qoftë edhe një vërejtje verbale nga ana ime apo nga profesoriati për atë që kanë bërë. Ata janë në ambientin e tyre dhe kanë të drejtë të më përzhënë mua, jo vetveten. Ata që nuk kanë punë me ambientin...

Albana Vokshi – Bashkë me sigurimin e arsimit është edhe siguri i të drejtës për të protestuar për gjithsecilin, pa shantazhe, pa presione, duke ofruar zgjidhje ligjore, jo zgjidhje që shkelin ligjet, se ju vetë u ndalët gjatë mbi...

Nora Malaj – Profesor, në të gjitha paraqitjet që bëtë...

Albana Vokshi –Të lutem, Nora, se nuk i kemi dëgjuar ende të gjithë profesorët në raundin e dytë. Na morën shumë kohë...

Spiro Drushku - Do të diskutoj dy gjëra, meqenëse ishin pyetje nga kolegu im për aplikimin e VKM-së për mesataren 7 në sistemin arsimor. Unë kam qenë nga ata që kam mbështetur notën 6, por edhe notën 7, në rang republike. VKM-ja për mesataren 7 është aplikuar gabimisht nga QSHA-ja, hapeni dhe lexojeni, është një VKM që i takon sistemit të

ciklit të parë *bachelor* dhe studimeve të integruara. Fakulteti i Shkencave në tabelën “shtojca nr.1”... nuk ka lidhje, ai nuk ofron asnjë program studimi në *bachelor* në fushën e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për këtë unë kam çuar një shkresë zyrtare dhe nuk kam marrë qoftë edhe një përgjigje negative. QSHA-ja me padrejtësi e zbatoi këtë ligj, pra duke penalizuar mosardhjen në Fakultetin e Shkencave për studentët me mesatare nga 6 deri në 7, që çoi në një degë me 32 studentë dhe me 28 pedagogë. Vitin tjetër, ndoshta, do ta çojë 28 pedagogë me 12 studentë. E para.

E dyta, lidhur me praktikat profesionale, kemi një përvojë shumë të gjatë, e kam kërkuar vazhdimisht, ia kam kërkuar edhe ministrit të Mjedisit në një takim që kam pasur kohët e fundit, po jua them edhe juve si deputetë, se keni mundësi për të ndërhyrë. Po që se bizneset private nuk do ta kenë detyrim ligjor që të pranojnë praktikat profesionale, praktika profesionale nuk do të bëhet. Praktikant janë bërë nga 4 javë, tani po bëhen 3 javë, shkonim me 50-60 studentë pranë bizneseve private dhe largoheshim, pra nuk na pranonin. Praktika është realizuar vetëm në bazë të njohjeve personale dhe miqësore. Kjo gjë nuk mund të ecë.

Nuk e di si mund të zgjidhet qoftë nëpërmjet licencës apo detyrimit financiar, që ata ta kenë detyrim ligjor të pranojnë studentët, që të bëjnë praktikën atje. Këtë jua them me përgjegjësi, që studentët nuk i pranojnë për të bërë praktikë. Ndërkohë, lidhja apo gatishmëria e fakulteteve me institucionet, me bashkinë, ministrinë e të tjerë është e hapur. Ne sapo kemi komunikuar me Ministrinë e Mjedisit dhe me Bashkinë e Tiranës në sezonin e ri të mbjelljeve, të cilat janë ofruar për ndihmë dhe konsulencë teknike në sekondë. Ne tregojmë hapur bashkëpunimin tone, sigurisht, për atë sa janë kapacitetet dhe mundësitë. Pra, pjesa e bashkëpunimit nga universiteti asnjëherë nuk ka munguar dhe nuk do të mungojë.

Pjesa tjetër, lidhur me pyetjen e fundit të zonjës Vokshi, Fakulteti i Shkencave nuk ka pasur raste të sikletshme apo të paragjykuara në lidhje me... *(nuk kuptohet)* dhe është menaxhuar me kujdes ... *(nuk kuptohet)*, ka qenë mjaft ndikuese ... *(nuk kuptohet)* por brenda në mjedise të ... *(nuk kuptohet)* kështu që...

Albana Vokshi – Ka dikush gjë tjetër për të shtuar?

Jonila Godole - Duke marrë shkas nga ajo që tha deputeti i nderuar, që janë profesorët ata që mbeten në histori dhe jo politikanët, do të thosha se në rastin e një shteti të ri demokratik, siç është shteti shqiptar për 28 vjet, edhe politikanët kanë shansin që të hyjnë në histori në Shqipëri, mbase jo në vendet e tjera, ku funksionon gjithçka, sepse funksionon sistemi. Për fatin tuaj të mirë apo të keq, nuk e di si e vlerësoni ju, ju ka rënë rasti që gjatë kësaj legjislature ku jeni deputetë, të jenë miratuar ligje të rëndësishme për një pjesë të madhe të shoqërisë. Një

ndër këto ligje, që është edhe arsyeja pse ne jemi mbledhur sot, është ligji për arsimin e lartë, i cili ju vendos në një provë shumë të madhe. Keni ditë që po dëgjoni dhe i keni ndjekur debatet tona nëpër media. Kishim një pjesë të kolegëve, të cilët me ligjin që kemi deri tani dhe me situatën në përgjithësi, se nuk është vetëm ligji, ai është njëra pjesë e problemit, i gjithë problemi për mua ka të bëjë me sistemin, janë të kënaqur. Ligji mund të ketë ndonjë problem të vogël, por nëse ne do ta zbatonim atë, është mëse funksional. Kjo mua më duket si një ftesë për të ruajtur *status quo*-në në të cilën jemi sot. Dëgjuat edhe një pjesë tjetër, e cila që nga momenti që u hodh në diskutim ky ligj para disa vitesh, ka këmbëngulur për një shikim të tij me kujdes nga palët e interesuara, që janë grupet e interesit, ku futet edhe trupa akademike. Duke marrë parasysh protestën e studentëve dhe të pedagogëve, ishin me qindra që i mbështetën ata dhe që dolën e protestuan edhe me pikat e tyre. Ju keni shansin që të shihni edhe njëherë nëse ky ligj ia vlen apo jo dhe ta trajtoni me seriozitet, duke përfshirë të gjitha grupet e interesit në diskutimin e tij.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që të flasësh për arsimin e lartë dhe gjendjen në të cilën ndodhet sot, nuk është thjesht problem i një ligji, por ka të bëjë me vizionin tuaj, se cili do të jetë ky vizion për arsimin e lartë në Shqipëri për 20 apo 50 vjetët e ardhshëm. E keni shumë të lehtë që ta mbyllni këtë mision që keni brenda këtyre viteve, por me ligjet që ju aprovoni këtu, dashur pa dashur, krijoni të gjithë vizionin për të gjithë shoqërinë në këtë pikë për arsimin e lartë. Unë do t'ju lutesha ta shikoni atë me prioritet.

Lidhur me propozimin e zonjës Ekonomi, të cilën e vlerësoj shumë për mendimet e saj gjithmonë shumë konstruktive në debat, që fakultetet të marrin pjesë aktive në projekte dhe programe të caktuara, ndaj të cilave Universiteti i Tiranës është hapur, kjo është shumë e drejtë dhe ne po përpiqemi ta bëjmë këtë, por ajo që do të doja ta kthej në vëmendjen tuaj është që kërkimi shkencor është thelbi i elitave akademike. Kur fola më parë për elitat problematike akademike në Shqipëri, që ndonjë koleg e keqkuptoi ose ashtu donte ta dëgjonte, këtë doja të thosha. Për mua thelbi është kërkimi shkencor dhe Universiteti i Tiranës nuk mund të prodhojë dot elita të kërkuesve shkencorë dhe elita të vërteta akademike, sepse nuk ka investime për këtë. Është mirë që të ketë disa programe, ku ne të mund të marrim pjesë, por kjo duhet të jetë e garantuar te buxheti që ju jepni për pedagogët. Unë dhe të tjerë kolegë e kemi pasur këtë mundësi, por jo prej Universitetit të Tiranës, por prej shteteve të tjera, ku kemi studiuar dhe kemi marrëdhënie krejtësisht private. Që kjo të funksionojë, duhet të bëhet në mënyrë institucionale.

Nuk mund të flasim në mënyrë të përgjithshme që u shtuan fondet. Unë kam 13 vjet që jam pedagoge dhe nuk i kam parë këto fonde si mbështetje për kërkimet e mia shkencore, që nuk janë të pakta në këtë fushë. Asnjëherë nuk jam mbështetur nga Universiteti i Tiranës dhe as nuk i kam interesuar ndonjëherë. Kështu që, ju lutem, shikojeni me prioritet këtë gjë.

Faleminderit!

Zhaklina Peto – Marr shkas nga pyetja që ngriti pak më parë kolegja deputete për zotin Gjokmarkaj, pikëpyetja e madhe që u ngrit në protestën e studentëve në lidhje me plagjiaturat. Që kur përmendet emri “plagjiaturë” duket sikur është një gjë e tmerrshme, por ndërkohë e gjithë bota e njeh dhe e rregullon me akte ligjore. Për fatin tim të mirë, unë jam pedagoge e pronësisë intelektuale në fakultet dhe e njoh shumë mirë këtë problem. Do të doja t’ju sqaroja se studentët u ngritën për punën shkencore ose për vlerat reale të kërkimit shkencor të pedagogëve, jo për plagjiaturën, fjalë për fjalë.

Jam shumë dakord, e thashë edhe pak më parë, që ligji për pronësinë intelektuale duhet rishikuar shumë nga ju.

Ne tashmë po diskutojmë lidhur me Kodin e Etikës Kërkimore-Shkencore, një projektligj, i cili nisi shumë mire, duke marrë si model Kodin European “Për Pronësinë Intelektuale”, por që u përshtat shëmtuar në projektligjin që na erdhi për t’u parë. Do të thosha që askush nga universiteti nuk është pro plagjiaturës, sepse ajo të dëmton, por duhet të kuptojmë se për cilën plagjiaturë bëhet fjalë, cilat janë instrumentet që duhet ta analizojnë plagjiaturën dhe kush legjitimohet për ta parë plagjiaturën. Doktoraturat janë të mbrojtura me komisione të ngritura me VKM, me ligj, ka oponencë, ka komisione që marrin në analizë të gjithë punimin. A mundemi ne, pa pasur materiale *software*, të dalim në konkluzione nëse është apo jo plagjiaturë?

Ne sot përballemi me një problem shumë të madh, që janë temat e masterit të studentëve. Nëse do t’i referohem projektligjit që ju kishit sjellë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka rëndësi, ai erdhi dhe unë e konsideroj një nismë. Ju falënderoj për këtë nismë që po merrni për të rregulluar një problematikë shumë të madhe të punës shkencore në Shqipëri, që çalon vërtet, sepse në botë ti e di sa për qind është plagjiaturë, sa duhet ta kesh, sa ta lejojnë, a do të konsiderohen referencat në plagjiaturë, cilat janë rregullat, përshkrimi. Këtu në Shqipëri nuk ka asgjë dhe këto “elita”, që nuk na ekzistokan, ekzistojnë vërtet, sepse këto “elita” edhe pa këtë rregullin apo pa këtë projektligj, kanë bërë punë shkencore të mirëfilltë edhe jashtë. Ne nuk shkruajmë vetëm këtu, por edhe jashtë. Ne e kemi detyrim ta bëjmë këtë dhe ata na i verifikojnë, na i kthejnë dhe ne nuk kemi turp kur na i kthejnë dhe na thonë ta përmirësojmë.

Në kuadër të gjithë kësaj, VKM-të që dolën janë shumë të mira, sepse në një farë mënyre parandalojnë plagjiaturën, por nuk mund të dalë një VKM, që vë rregulla të reja në vitin 2019, kur unë jam një doktorante e vitit 2007 dhe të më thotë sot që doktoraturën që ti ke bërë në vitin 2007 do ta fus sot në një *software* të ri, që po e përgatis rishtas për ty dhe unë s'e di se cila është literatura aty brenda që ti po më merr. A do të ketë literaturë shqiptare, a do të ketë literaturë europiane, si do të jetë e përkthyer kjo gjë? Si do të jetë i përkthyer punimi im, në shqip apo në anglisht? A do të kesh kohë të mjaftueshme ti të përkthesh të gjitha këta libra dhe të më kontrollosh mua doktoraturën?

Ka shumë pikëpyetje dhe më e rëndësishmja në këtë histori është se pse duhet që Ministria e Arsimit të krijojë një komision *ad hoc*, i cili të hedhë baltë mbi mua apo mbi 1 mijë kolegët e mi pedagogë, me gjithë respektin për ta, dhe të thotë që merreni këtë doktoraturën e zonjës këtu, se unë dyshoj se më ka dalë me të kuqe te *software* im. Pra, së pari, *software*-n duhet ta ketë fakulteti, duke e pasur *software* pedagogu përgjegjës, atëherë do të mbajë përgjegjësi për gjobat për kontrollet.

Pra, në njëfarë mënyre, VKM-ja dhe kërkesa e studentëve duhet të plotësohet nga qeveria nëpërmjet një kuadri ligjor kushtetues, jo të bëjmë ligjshmëri me antiligjshmëri, sepse duke marrë një VKM, që është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Shqipërisë, pra, duke pretenduar ligjshmëri me antiligjshmëri, jemi në kundërshtim të plotë.

Prandaj, e përgëzojmë nismën dhe mezi presim të kemi një draft shumë të shpejtë për kodin e etikës së punës shkencore!

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zhaklin Peto – Të na e sugjerojnë, nuk ka problem. Ne japim kontributin tonë.

Albana Vokshi - Sqarojeni më vete këtë. Duhet ta konsideroj të mbyllur...

Kestrin Kastro – Mund të ndërhyj, si anëtare e grupit të punës që ka trajtuar aktet?

Vilma Bello – Sa ta sqarojë zonja.

Albana Vokshi - Vilma, sqarojeni ju të dyja.

Të lutem, Kestrina!

Kestrin Kastro – Ne kemi konstatuar në grupin e punës, mbas një konsultimi të gjerë, të gjitha shkeljet, si ato procedurale, edhe ato materiale.

Për sa i përket plagjiaturës, handikapi më i madh ishte pikërisht mungesa e një akti rregullator ligjor apo e akteve nënligjore, që të bënin përcaktimin se çfarë quhet plagjiaturë, format se si realizohet ajo dhe deri në sa është e lejueshme për të mos cenuar origjinalitetin e punimit. Duke munguar kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...që mund të bëhet shumë mirë në ligjin “Për të drejtat e autorit”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo ndërhyrja është ligjore. Në të gjitha vendet e zhvilluara rregullimi është ligjor dhe nuk u përket universiteteve. Vendosen kufijtë se deri në çfarë niveli konsiderohet ose jo plagjiaturë, si dhe format që realizohet kjo, që mund të bëhet në ligjin “Për të drejtën e autorit” apo në ligjin “Për pronësinë intelektuale” dhe mund të hapë rrugë me tej për kontrollin antiplagjiaturë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj – Më fal, për ta sqaruar pak...!

Një sekondë, Vilma!

Vilma Bello – Jemi në koherencë të plotë të mendimeve me njëra-tjetrën, duhet ta them.

Të falënderoj dhe të vlerësoj shumë! Për çështjet që ngrite, jemi në të njëjtin këndvështrim. Ajo që doja të diskutoja dhe ia adresova kolegut Gjekmarkaj, lidhet me atë që unë besoj se ky është një proces... Ju jeni doktorante e 2007-s. Unë jam doktorante e 2009-s, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, Universiteti i Tiranës. E vlerësoj shumë punën e kujt do që ka bërë një investim të tillë në rrugëtimin akademik. Në fund konkludova, për këtë iu drejtova kolegut Gjekmarkaj, që, nëse vëmendja e qeverisë u adresua me VKM-në nr. 777, pikërisht për ndjeshmërinë ndaj kërkesës së studentëve, personalisht, nuk mendoj që ky është realizimi i një kërkesë, që mund ta përmbushë qeveria. Përkundrazi, qeveria e vuri në vëmendje realizimin, por përmbushja e kërkesës patjetër që do të bëhet nga institucionet e arsimit të lartë. Në fushën time, në gjuhën shqipe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...patjetër që ka literatura shqipe, të cilat duhet të verifikohen, të jenë pjesë e *software*-eve, e verifikimeve. Patjetër që është ashtu, siç e diskutuat edhe ju. Unë nuk kam asnjë gjë kundër, por nëse qeveria e vuri në vëmendje nëpërmjet një VKM-je, pikërisht për ndjeshmërinë ndaj studentëve, mendoj se këtu duhet të jemi pak më të qartë. Nuk do ta bëjë qeveria këtë. Personalisht, mendoj që këtë duhet ta bëjnë institucionet e arsimit të lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zhaklin Peto – Kam vetëm diçka. Në momentin kur VKM-ja është në fuqi dhe ne sot na vijnë njoftime nga Ministria e Arsimit, të tipit “na sillni listën e doktoraturave, *hard copy* dhe *copy*...”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju lutem, a mund ta marrim fjalën me radhë? Zonja Vokshi e la komisionin për një detyrë. Ju lutem, kërkojeni fjalën me radhë!

Nora Malaj – Kam dy pyetje.

Deri tani thamë se ligji bëhet dhe nuk bëhet.

Si do të zgjidhet, që të mos krijojmë handikap në vazhdimin e procesit? Do të bëjmë VKM, amendime? Çfarë kërkon direkt nga ne, që të jemi realisht produktivë dhe të mos bëjmë thjeshtë histori fjalësh?

Të gjitha VKM-të zonjat i diskutuan me shumë profesionalizëm. Në momentin kur qeveria nuk tërhiqet, cili është hapi tjetër?

Çfarë duhet t'i kërkojmë ne, si komision, qeverisë, duke pasur parasysh që kjo është edhe antikushtetuese?

Dhori Kule – T'ju jap një sugjerim?

U zgjat shumë dhe u lodhëm, por në vlerësimin tim është shumë e thjeshtë. Edhe diskutimet që po bëhen për plagjiaturën... Kemi pasur një situatë me maturën shtetërore. Matura shtetërore atëherë kishte zëvendësuar policin me mësuesin. Kush e njeh shkollën në themelet e saj, e di se si funksionon.

Me sistemin e mëparshëm të maturës shtetërore, mësuesit e nderuar, që i kemi pasur ne dhe që janë ende, të vlerësonin në matematikë me notën 7 në 3 vjet dhe në provimin e maturës ti dilje me notën 10. Fusnin një kopje dhe... Kjo ndryshoi.

Problemi i plagjiaturave nuk zgjidhet me *software*-ët, të nderuar kolegë dhe deputetë. Plagjiatura dhe diskutimi shkencor zgjidhen në diskutimet që bëhen në departamente. Besoj se keni qenë nëpër departamentet e botës. Kam qenë në departamente ekonomike, si: në Britani, Gjermani... Kanë ditën e diskutimit të *paper*-ave. Pa analizuar punimet shkencore në departament, ku të flet ai... Nuk ka *software* me të mirë dhe më të madh se kur profesorët analizojnë punimin tënd. Nuk ka shtëpi botuese që nuk e boton punimin tënd pas kësaj. Ajo ditë është dita e përgjegjësisë së madhe.

Këtë po përpiqemi të fillojmë nëpër departamente. Nuk zgjidhet me polici apo me botime, që dikush mund t'i paguajë për t'i bërë dhe i çon në revistë. Do të përgjigjesh atje ku është... Baza shkencore dhe qeliza shkencore e diskutimit të problematikave është departamenti i profilizuar. Ne kërkojmë ta bëjë polici punën akademike dhe shkencore. Kjo është e thjeshtë. Prandaj, pa vajtur te logjika e *software*-ve, është logjika e përmbajtjes së diskutimit shkencor, që është në strukturat tona, si mision dhe detyrë themelore jona.

Desha të bëj edhe një sqarim. Kam marrë të gjitha materialet për projektligjin, sepse Universiteti i Tiranës ka pasur një përkujdesje maksimale ndaj qëndrimeve përkatëse. Dikush

tha se kanë ardhur 2000 faqe, dikush tha 5000 faqe. I kam të gjitha të shkruara. Në emër të Fakultetit të Histori-Filologjisë ka 1 faqe e gjysmë propozime për projektligjin, me 8 pika. Tani, duhet të jemi korrekt kur mbajmë qëndrime dhe bëjmë propozime. Është me firmën e profesor Shezai Rrokajt. Kam qenë në ndjekje maksimale të problemeve të ligjit për arsimin e lartë dhe po ju them me përgjegjësi se atë që ka bërë Universiteti i Tiranës, nuk e ka bërë asnjë universitet tjetër. E kemi kthyer ligjin në këtë format vetëm nga insistimi ynë profesional.

Disa diskutojnë pranimet. Pranimet atëherë i bënte qeveria, tani i bën universiteti. I ka universiteti totalisht, ka dy nene. Është autonomi. Po t'i shikoni të dy ligjet dhe t'i krahasoni, ka zbaritur autonomia në bazë. E kanë dhënë edhe me statistika. Departamenti ka pasur 7 nene, tani ka 32 nene, që e rregullojnë. Ka rënë kompetenca e drejtuesve, por se punohet me ligjin e vjetër dhe kanë dëshirë të punojnë me ligjin e vjetër, ky nuk është faji i ligjit të ri. Për komentet që “disa e duan ligjin dhe disa nuk e duan”, kush bën analiza të ligjit, të përballet dhe të më thotë se çfarë nuk shkon. Dualizmi... Nuk është dualizëm, por është mosrespektim i ligjit. Bëhet propagandë kot, sepse nganjëherë ne ngatërrojmë... Unë jam i fushës së menaxhimit dhe e di shumë mirë që komunikimi është instrumenti i menaxhimit, jo menaxhimi vetë. Këtë gjë mbase nuk e kuptojnë të tjerët. Ua kam thënë edhe të tjerëve. Ka dy gjëra: qeverisja dhe media, menaxhimi dhe komunikimi. Komunikimi është instrument, të mos i duket komunikimit sikur është qeverisje, sikur është menaxhim. Prandaj koordinohen situatat, që të sjellësh argumentet që duhen sjellë, për të thënë që kjo është kështu apo...

Për funksionimin ka probleme, siç edhe i diskutova, qoftë edhe për statutin, që na mori zvarrë për 2 vjet e ca, edhe për moszbatimin e ligjit nga strukturat shtetërore. Disa thonë: “Të japë dorëheqjen rektori, të japë dorëheqjen senati” e të tjera me radhë. Këto nuk i shkojnë universitetit. Ai është institucioni që mëson se si respektohet ligji, se si duhet të sillesh në mënyre institucionale, jo si duhet të bësh demagogji dhe propagandë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë!

Nora Malaj - Për VKM-të, si do të bëhet...?

Dhori Kule – Ne akoma nuk e dimë cila është autonomia jonë. Po të isha unë rektor... E di çfarë kam bërë me udhëzimet që çonte ministri i mëparshëm? Nuk ua thosha këtyre të tjerëve. Vinte udhëzimi i firmosur nga Myqerem Tafaj dhe e ktheja mbrapsht: “Ky udhëzim është i papajtueshëm me ligjin”.

Milva Ekonomi – Nuk ka rëndësi, zoti Dhori...

Dua t'ju vë në dijeni për dy gjëra shumë të rëndësishme.

Shumë faleminderit! Për ne ishte shumë e rëndësishme kjo dëgjese me ju, sepse u qartësua edhe vetë për shumë gjëra. Ne e njohim ligjin, jo se kemi punuar për ligjin, por e kemi shfletuar ose lexuar atë. Kemi krijuar opinionet tona, kemi ndjekur “Paktin për universitetin”, kemi ndjekur edhe protestën.

E kuptoj shqetësimin që ka VKM-ja për antiplagjiaturën, por Kryeministri, në takimin që u bë të “ArtTurbina”, u sqaroi pedagogëve që kjo VKM do të bëhet sikurse ata dëshironin. Ju ka bërë një thirrje të hapur për të qenë reformatore të kësaj VKM-je. Ju ka njohur edhe me disa statistika të çuditshme, që lidhen me marrjen e titujve. Kjo është të “Pakti për universitetin”.

Pavarësisht këtyre gjërave dhe diskutimeve të frytshme që ne bëjmë sot, ku secili kupton sipas mënyrës dhe qasjes që ka ndaj problemit, nëse e vutë re, diskutimi ynë u bë nëpërmjet mikrofonave. Kjo bën të mundur që kjo mbledhje të regjistrohet, edhe për arsye të antiplagjiaturës. Është e regjistruar dhe zbardhet. Diskutimet që ne kemi bërë në këtë mbledhje mund t’i gjeni në faqen *web* të parlamentit. Kjo është një praktikë e zakonshme në Kuvendin e Shqipërisë. Është për të mirën e të gjithëve ne, që herë pas here të kemi mundësi t’u kthehemi shënimeve dhe komenteve që kemi bërë në këtë mbledhje.

Kam edhe një gjë tjetër të rëndësishme. Nuk e di nëse jeni vënë në dijeni nga rektori i Universitetit të Tiranës, por në fund të vitit 2018, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Gramoz Ruçi, nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me universitetet e Shqipërisë, për një arsye shumë të thjeshtë, që sa herë të ketë nisma ligjore, për të cilat Kuvendi i Shqipërisë ka nevojë për mendime të profilizuara dhe të specializuara, të bëjmë një thirrje për bashkëpunim me universitetet e Shqipërisë, sidomos me ato që janë në Tiranë. Ekspertiza e grumbulluar mendohet që është më e hapur, sepse këto universitete kanë bashkëpunim më të madh me institucionet ndërkombëtare. Po ashtu, zoti Ruçi ka bërë thirrje që në këtë memorandum bashkëpunimi, nëse ju mendoni që kanë nevojë të rishikohen ligje të caktuara, që janë sot në proces zbatimi, të sillni mendimin tuaj. Për shembull, zonja Zhaklin tha se ligji “Për pronësinë intelektuale” ka nevojë për disa vlerësime.

Dua t’ju falënderoj për kohën e vënë në dispozicion! E di që këtë gjë do ta bënte edhe kolegja ime Vokshi, sepse ka pasur gjithmonë dëshirë t’i bënim këto dëgjesa, por për arsye të agjendës duhej të largohej. Ajo vuri në dispozicion kohën e domosdoshme për të pasur këtë dëgjese të frytshme.

Mbase, herë të tjera mund të kemi nevojë edhe për diskutime të gjëra në grup, për të hedhur dritë për shqetësimet që vijnë nga jeta akademike e përditshme. Ato që janë në nivelin makro, natyrisht që i ndjekim, por shqetësimet që vijnë nga jeta e përditshme, mbase nuk arrijnë

të vijjnë deri në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Kështu që do të keni edhe ftesa të tjera në vazhdim.

Faleminderit shumë!

MBYLLET MBLEDHJA